

UNIVERSITETI I EJL

ЈИЕ УНИВЕРЗИТЕТ

SEE UNIVERSITY



FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE BASHKËKOHORE

ФАКУЛТЕТ ЗА СОВРЕМЕНИ ОПШТЕСТВЕНИ НАУКИ

FACULTY OF CONTEMPORARY SOCIAL SCIENCES

STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

NATO në shërbim të paqes

KANDIDATI:

Veton Shemsedini

MENTORI:

Prof. dr. Etem Haziri

Tetovë, Qershor 2019

DEDIKIM. *Prindërve të mi, për përkushtimin dhe dashurinë e tyre pa kushte.*

Deklarata e ndershmërisë

Unë Veton Shemsedini student në studimet postdiplomike në Fakultetin e Shkencave Shoqërore dhe Bashkëkohore pranë Universitetit të Evropës Juglindore në Tetovë, me një përgjegjësi të plotë morale dhe ligjore deklaroj që ky punim magjistrature është rezultat i punës sime hulumtuese dhe asnjë pjesë e tij nuk është marrë nga autorë tjerë, në përjashtim të pjesëve që janë të regjistruara me referencat përkatëse.

Qershor, 2019

Veton Shemsedini

Tetovë

Mentor

Prof. Dr. Etem Aziri

Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë

Komisioni

Prof. Dr. Etem Aziri

Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë

Prof. Dr. Hasan Jashari

Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë

Prof. Dr. Agron Rustemi

Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë

Abstrakt

Ky punim ka si qëllim shqyrtimin e rolit të NATO-s dhe kontributin që ka dhënë dhe vazhdon të jep kjo organizatë ndërkombëtare në zhvillimin e demokracisë dhe ruajtjes së paqes globale.

Punimi “NATO në shërbim të paqes” do të përqendrohet në disa fusha të caktuara, duke filluar nga historiku i krijimit të Traktatit Veri Atlantik , operacionet ushtarake, bashkëpunimin në mbështetje të paqes dhe dialogut, si dhe në gatishmërinë në parandalimin e katastrofave humanitare.

Për sa i përket metodologjisë së përdorur për realizimin e punimit mund të theksoj që konceptimi i këtij studimi është bërë duke hulumtuar dhe referuar libra të ndryshëm bashkëkohorë, materiale nga interneti të marra nga adresa zyrtare, revista , artikuj si dhe raporte nga Organizata Veri Atlantike.

NATO është pjesë e rëndësishme e procesit të zhvillimit dhe demokratizimit të çdo vendi dhe prania e saj ndihet në çdo aspekt të jetës politike dhe shoqërore. Nga zhvillimi i punimit del në pah teza që kjo organizatë ndërkombëtare ka ndikuar në procesin e

zhvillimit dhe demokratizimit të vendeve anëtare nëpërmjet kontributit ekonomik, politik dhe asistencës së tyre pothuajse në çdo fushë.

Ky punim do të paraqet një kontribut modest teorik dhe shkencor për rolin dhe rëndësinë e NATO-s në ruajtjen e paqes globale.

Abstract

This paper aims at reviewing the role of NATO and the contribution it has given and continues to provide this international organization to the development of democracy and the maintenance of global peace.

The paper 'NATO in the service of peace' will focus on certain areas, ranging from the history of the creation of the North Atlantic Treaty, military operations, peace-support cooperation and dialogue, as well as readiness to prevent humanitarian catastrophes.

With regard to the methodology used for this paper, I can emphasize that the concept of this study has been done by researching and referring various contemporary books, material from the internet obtained from official addresses, magazines, articles and reports from the North Atlantic Organization.

NATO is an important part of the process of the development and democratization of each country and its presence is felt in every aspect of the political and social life. From this paper emerges the thesis that this international organization has influenced the

process of the development and democratization of its member countries through its economic, political and assistance contribution in almost every field.

Апстракт

Целта на овој труд е да се анализира улогата на НАТО и придонесот на ова меѓународна организација во развојот на демократијата и одржување на светскиот мир.

Трудот "НАТО во служба на мирот" ќе се фокусира на одредени теми, почнувајќи од историјата на создавањето на НАТО, воените операции на ова организација, нејзината соработка со други организации за развојот на мирот и дијалогот, како и подготвеноста за спречување на хуманитарните катастрофи.

Во врска со методологијата користена во овој труд, можам да истакнам дека сум истражувал различни современи книги, материјали од интернет добиени од официјални адреси, списанија, статии како и извештаи од самата Северноатлантската организација.

НАТО е важен дел од развојните и демократските процеси во светот. Преку овој труд, произлегува тезата дека оваа меѓународна организација игра важна улога во

процесот на развојот и демократизација на земјите-членки на економски,
политички и општествен план.

Përmbajtje e shkurtër

**KAPITULLI I : PËRFUNDIMI I LUFTËS SË DYTË BOTËRORE DHE KRIJIMI I
BLLOQEVE USHTARAKE**

**KAPITULLI II : PËRPLASJA E IDEOLOGJIVE DHE FUNKSIONIMI I BOTËS DERI NË
SHEMBJEN E MURIT TË BERLINIT**

**KAPITULLI III : ROLI I NATO-s PAS NDRYSHIMEVE NË EVROPËN QENDRORE DHE
JUGLINDORE**

HYRJE

Qëllimi kryesor i kësaj teme të titulluar “NATO në shërbim të paqes”, është vërtetimi i përfitimeve politike dhe të sigurisë nga kjo aleancë si dhe pasqyrimi i bashkëpunimit të saj në disa sfera kyçe si operacionet për mbështetjen e paqes, reformën e mbrojtjes, gatishmërinë ndaj katastrofave dhe bashkëpunimin në fushën e shkencës dhe të mjedisit, si dhe të marrim njohuri për funksionimin dhe rolin e NATO-s në parandalimin e krizave, menaxhimin e konflikteve dhe bashkëpunimin e ngushtë me partnerët ndërkombëtarë, OKB-në dhe BE-në.

Ky punim do të mbështetet në një hipotezë kryesore dhe dy hipoteza ndihmëse. Hipoteza kryesore: NATO prej shkatërrimit të paktit të Varshavës e deri më sot është dëshmuar si fuqi ushtarake, politike dhe diplomatike në mbrojtje të paqes.

Hipoteza ndihmëse :

- a) NATO - përmes misioneve paqeruajtëse shërben si preventivë për parandalimin e konflikteve

b) NATO - përmes misionëve të saja ndihmon në ndërtimin e perspektivave të popujve dhe shteteve të rrezikuara nga interesat e shteteve grabitqare.

Aleanca garanton të mbetet një komunitet i pashembullt i lirisë, paqes, sigurisë dhe vlerave të përbashkëta. Detyrat themelore dhe parimet e NATO-s nuk ndryshojnë. Ajo do të vijojë të ketë qëllim afatgjatë, mbrojtjen e lirisë dhe sigurisë të të gjithë anëtarëve të saj me mjete politike dhe ushtarake.

Shpresojmë se ky punim do të paraqet një kontribut modest teoriko-shkencor për rrolin dhe rëndësinë e NATO-s në rruajtjen e paqes globale. Edhe pse për këtë temë janë shkruar punime të shumta, mendoj se ky punim do të ketë rëndësi teorike por edhe rëndësi praktike.

Rëndësia teorike konsiston me faktin se ende një pjesë bukur e madhe e qytetarëve të Maqedonisë nuk kanë njohuri të mjaftueshme për zanafillën dhe veprimet e NATO-s ndër vite. Rëndësia praktike konsiston me faktin se punimi do t'ju shërbejë si një doracak të gjithë qytetarëve të Maqedonisë në prag të inkuadrimit të shtetit tonë në NATO.

PËRMBAJTJA

KAPITULLI I

PËRFUNDIMI I LUFTËS SË DYTË BOTËRORE DHE KRIJIMI I BLLOQEVE USHTARAKE

- a) Bota pas Luftës së Dytë Botërore dhe shenjat e para të Luftës së Ftohtë
- b) Formimi i NATO-s
- c) Formimi i Paktit të Varshavës
- d) Garat në armatim si rrezik permanent i paqes botërore.

KAPITULLI II

PËRPLASJA E IDEOLOGJIVE DHE FUNKSIONIMI I BOTËS DERI NË SHEMBJEN E MURIT TË BERLINIT

- a) Angazhimi i blloqeve për mbisundim
- b) Roli i vendeve të painkuadruara

- c) Kriza e shteteve komuniste në Evropë dhe zëvendësimi i sistemeve komuniste me ata pluraliste
- d) Shpërbërja e Paktit të Varshavës

KAPITULLI III

ROLI I NATO-s PAS NDRYSHIMEVE NË EVROPËN QENDRORE DHE JUGLINDORE

- a) NATO si fuqi e vetme dhe determinuese pas shkatërrimit të Paktit të Varshavës
- b) Struktura organizative e NATO-s
- c) Misionet paqeruajtëse të NATO-s
- d) Roli i NATO-s në mbrojtjen e stabilitetit dhe të paqes në Ballkan
- e) Inkuadrimi në NATO i vendeve të Ballkanit Perëndimor
- f) Perspektiva e mëtejshme e NATO-s si fuqi politiko-ushtarake dhe paqeruajtëse

Kapitulli I

PËRFUNDIMI I LUFTËS SË DYTË BOTËRORE DHE KRIJIMI I BLOQEVE USHTARAKE

Lufta e Dytë Botërore ishte rrjedhojë e një sërë rrethanash të ndërlikuara strategjike, politike, ekonomike dhe sociale me përmasa globale. Përfundimi i Luftës së Parë Botërore dhe padrejtësitë e traktateve që u firmosën si ndëshkim i palëve që humbën luftën (para së gjithash ndëshkimi i Gjermanisë me Traktatin e Versajës); krijimi i Lidhjes së Kombeve dhe paaftësia e kësaj organizate për të adresuar dhe menaxhuar konfliktet politike dhe ushtarake në planin global (si p.sh. pushtimi i Etiopisë nga Italia e drejtuar nga Benito Musolini), rimilitarizimi i Gjermanisë, ardhja në pushtet e nazistëve në vitin 1933, politika e jashtme agresive e Berlinit ndaj vendeve fqinje, revidimi i Traktatit të

Versajës, paraqitja e fashizmit në Itali, triumfi i forcave nacionaliste në Luftën Civile Spanjolle (1936-1939) me ndihmën e Gjermanisë Naziste dhe Italisë Fashiste, kontradiktat midis shteteve të ndryshme por edhe luftërat me karakter çlirimtar; kriza e thellë e përgjithshme ekonomike, por sidomos papunësia e madhe në vitet 1931-'35, mund të konsiderohen disa nga shkaqet e shpërthimit të saj.

Nazizmi gjerman, fashizmi italian dhe militarizmi japonez krijuan aleancë politiko-ushtarake, që në histori njihet me emrin “Boshti Berlin-Romë-Tokio”. Në të u bashkuan shtete të tjera, që luajtën rol relativisht të vogël, ndoshta edhe të papërfillshëm. Këtij blloku iu kundërvu fuqia e bashkuar ushtarake e Koalicionit Antifashist Botëror, bërthamën e të cilit e përbënin ShBA-ja, Bashkimi Sovjetik dhe Britania e Madhe.

Lufta e Dytë Botërore filloi më 1 shtator 1939 me sulmin gjerman ndaj Polonisë. Pas kësaj, Franca dhe Britania e Madhe i shpallën luftën Gjermanisë. Prej vitit 1939 e deri në vitin 1941, ushtria hitleriane, në një sërë fushatash ushtarake, pushtoi pjesën më të madhe të kontinentit evropian.

Me nënshkrimin e traktati për mos-sulmim ndërmjet Berlinit dhe Moskës në gusht të vitit 1939, Gjermania dhe Bashkimi Sovjetik ndanë dhe aneksuan territore të vendeve me të cilat kufizoheshin: Poloninë, Finlandën, Rumanisë dhe shtetet baltike.

Më 22 qershor 1941, Gjermania sulmoi Bashkimin Sovjetik, ndërsa Japonia sulmoi Shtetet e Bashkuara të Amerikës me sulmin e papritur në bazën ushtarake amerikane në ishullin Pearl Harbor në Pacifik. Pasi ShBA-të i shpallën luftë Japonisë, në shenjë solidarizimi me aleatin japonez, edhe Gjermania dhe Italia i shpallën luftë ShBA-së.

Pas një sërë disfatash të Gjermanisë në Afrikën Veriore, Frontin Lindor dhe Frontin Perëndimor, në Evropë, Lufta e Dytë Botërore mori fund me invadimin e Gjermanisë nga Aleatët perëndimorë dhe nga Bashkimi Sovjetik, e cila kulminoi me pushtimin e Berlinit nga trupat sovjetike, vetëvrasjen e Adolf Hitlerit dhe me kapitullimin e pakusht të Gjermanisë më 8 maj 1945. Pas Deklaratës së Potsdamit nga Aleatët më 26 korrik 1945 dhe pas refuzimit të Japonisë për t’u dorëzuar, Shtetet e Bashkuara të Amerikës me urdhër të presidentit amerikan Hari Truman hodhën bombat atomike në Hiroshima dhe Nagasaki më 6, përkatësisht 9 gusht.

Pasojat e Luftës së Dytë Botërore

Pasi u përball me disfatat shkatërruese në Bashkimin Sovjetik dhe ato të fushatës së bombardimeve të Aleatëve, Gjermania, në maj të vitit 1945 ishte shndërruar në rrënoja. Fitorja e Aleatëve ndaj Fuqive të Boshtit e rishpërndau fuqinë dhe i rirregulloi kufijtë duke krijuar një terren të ri gjeopolitik. Bashkimi Sovjetik përvetësoi rreth 600.000 kilometra katrorë nga shtetet baltike të Estonisë, Letonisë, Lituanisë dhe nga Finlanda, Çekosllovakia, Polonia dhe Rumania, duke rimarrë atë që Rusia kishte humbur në traktatin e 1918 të Brest Litovskut të imponuar nga Gjermania gjatë Luftës së Parë Botërore. Polonia, një viktimë e ekspansionizmit sovjetik, u kompensua me toka të marra nga Gjermania.

Në vetvete, Gjermania u nda në zona të pushtuara që krijuan kushtet edhe për ndarjen e saj përfundimtare në Gjermaninë Lindore dhe në Gjermaninë Perëndimore. Në Lindjen e Largët, Bashkimi Sovjetik i mori Japonisë katër ishujt Kurile, ndërsa Koreja u nda në zona të sunduara nga sovjetikët dhe në zona të sunduara në amerikanët në paralelen 38. Me disfatën e Boshtit, mori fund një sistem global, ndërsa karakteristikat e sistemit të ri nuk ishin akoma të qarta.

Megjithëse u krijuan Kombet e Bashkuara për të zëvendësuar Lidhjen e Kombeve që ishte diskredituar, menaxhimi i çështjeve botërore ngelej akoma në duart e fituesve. Tre liderët e mëdhenj, Uinston Çërçill, Frank Ruzvelt dhe Josif Stalin u mbledhën në Konferencën e Jaltës në shkurt të vitit 1945 për të ravijëzuar një rend të ri botëror. Por kompromisi që ata arritën, fshihte problemet e vërteta që gjendeshin poshtë kësaj sipërfaqeje të dukshme. Pas kapitullimit pa kushte të Gjermanisë në maj, Tre të Mëdhenjtë, (me ShBA-në të përfaqësuar tashmë nga presidenti i ri Hari Truman) u takuan sërish në korrik të vitit 1945 në Postdam. Takimi përfundoi me një marrëveshje ndërkohë që fasada e unitetit të Aleatëve filloi të tharëmohej. Pas luftës, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Sovjetik mbetën si dy fuqi të mëdha akoma të forta dhe të afta për të imponuar dëshirën e tyre. Të mundurit Gjermania dhe Japonia ranë nga renditja e fuqive të mëdha.

Fuqitë e tjera të mëdha fituese, sidomos Britania e Madhe e kishin harxhuar vetveten dhe gjithashtu kishin zbritur ndjeshëm nga kulmi i hierarkisë së Fuqive të Mëdha.

Bota pas Luftës së Dytë Botërore dhe shenjat e para të Luftës së Ftohtë

Lufta e Dytë Botërore ishte konflikti i armatosur midis Aleatëve të përbërë nga SHBA-ja, Bashkimi Sovjetik dhe Britania e Madhe në njërin anë si dhe Fuqitë e Boshtit të përbërë nga Gjermania, Italia dhe Japonia..

Ajo shkaktoi pasoja të shumta humanitare dhe materiale. Rreth 62 milion njerëz ,përafërsisht 2.5% e popullsisë së planetit humbën jetën.

Lufta përfundoi me fitoren e aleatëve. Gjermania kapitulloi në maj të vitit 1945 ndërsa Japonia nënshkroi kapitullim më 2 shtator 1945 pasi amerikanët përdorën bombat bërthamore.

Lufta e Dytë Botërore do të mbetet në histori si ngjarja që shënoi fundin e Europës Perëndimore si qendra e fuqisë globale dhe, bashkë me të, fundin e një sistemi global shumëpolar, duke mundësuar krijimin, fillimisht, të një sistemi dypolar dhe, më pas, të një sistemi njëpolar, në të cilin Amerika do të bëhej dhe vazhdon të mbetet e vetmja fuqi hegjemone e globit.¹

Pas përfundimit të këtij konflikti, u ndryshua rendi politik dhe struktura sociale e globit. U themelua Organizata e Kombeve të Bashkuara që kishte si qëllim kryesor nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar si dhe për të parandaluar konfliktet ushtarake në të ardhmen. Shtetet fitimtare – ShBA-ja, Bashkimi Sovjetik, Britania e Madhe, Kina dhe Franca u bënë anëtare të përhershme të Këshillit të Sigurimit.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik dolën si superfuqitë e vetme politike dhe ushtarake. Si pasojë e rrënimëve që pësuan fuqitë e mëdha kolonialiste të Evropës, para së gjithash Britania e Madhe dhe Franca, filloi edhe procesi i dekolonizimit të Afrikës dhe Azisë.

Pas kapitullimit të Gjermanisë Naziste, shtetet fitimtare de facto e ndanë atë në dy shtete të pavarura, Republikën Federale Gjermane (e ndarë në zona të ndikimit ndërmjet

¹ Donald Shena, *Lidershipi global i Shteteve të Bashkuara (në shekujt XX dhe XXI)*, Tiranë, 2014, f. 96

ShBA-së, Britanisë së Madhe dhe Francës) si dhe Republikën Demokratike Gjermane (nën ndikimin e Bashkimit Sovjetik).

Pjesa tjetër e Evropës u nda në zonën perëndimore të ndikimit si dhe në zonën sovjetike të ndikimit. Pjesa më e madhe e vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore ranë nën sferën sovjetike të ndikimit dhe interesit, gjë që çoi në krijimin e regjimeve komuniste në këto vende me mbështetjen e plotë apo të pjesshme të autoriteteve sovjetike. Si pasojë, Gjermania Lindore (Republika Demokratike e Gjermanisë), Polonia, Hungaria, Çekosllovakia, Rumania, Bullgaria dhe Shqipëria u bënë shtete satelite të Bashkimit Sovjetik. Jugosllavia komuniste ndërkaq Çonte politikë të pavarur, gjë që ndikoi që marrëdhëniet politike ndërmjet të dyja vendeve të jenë të tensionuara.

Ndarja e zonave të ndikimit dhe e sferave të interesit ndërmjet Uashingtonit dhe Moskës u formalizua me krijimin e dy blloqeve ushtarake: NATO e udhëhequr nga ShBA-të si dhe Pakti i Varshavës apo Traktati i Varshavës i udhëhequr nga Bashkimi Sovjetik. Periudha e gjatë e tensioneve politike ndërmjet këtyre dy shteteve u pasua nga një garë e paprecedentë armatimi.

Secili nga këto ndryshime kontribuoi në konfliktin e ri ndërkombëtar, i quajtur dhe i njohur ndryshe si Lufta e Ftohtë.

Lufta e Ftohtë paraqet periudhën e tensioneve gjeopolitike ndërmjet Bashkimit Sovjetik bashkë me vendet satelite të saj (Bllokun Lindor) dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës me aleates e saj (Bllokun Perëndimor). Si pasojë e dallimeve të mëdha ideologjike dhe politike, menjëherë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, aleanca ndërmjet Uashingtonit dhe Moskës kundër Gjermanisë Naziste pushoi së ekzistuari.

Përpara fillimit të Luftës së Ftohtë mbizotëroi një periudhë e shkurtër në të cilën fuqia e Shteteve të Bashkuara gëzonte një supremaci të pakontestueshme pasi ishte e vetmja që kishte mundësinë që të shkatërronte Çdo kundërshtar me anë të bombës atomike. Kjo ishte një periudhë kalimtare unipolare ku Uashingtoni ishte qartësisht dominues. Në këtë pozicion, si pasojë e fuqisë ushtarake, Shtetet e Bashkuara ishin në gjendje që të eksperimentonin bashkëpunimin me sovjetikët ashtu siç edhe filloi të vepronte për të menaxhuar Çështjet globale.

Marrëdhëniet bilaterale ndërmjet SHBA-së dhe Bashkimit Sovjetik u përkeqësuan menjëherë. Interesat jetike të të dy superfuqive ndesheshin jashtë asaj që ato i kishin përcaktuar qartësisht si sfera të tyre të influencës. Në këto rrethana kritike, Xhorxh F. Kenan që në atë kohë ishte diplomat i ambasadës amerikane në Moskë, i dërgoi Uashingtonit telegramin e tij të famshëm duke vlerësuar burimet e sjelljes sovjetike. Ideja e tij u reklamua gjerësisht më 1947 kur gazeta me më shumë ndikim Foreign Affairs botoi këndvështrimin e tij në një artikull të nënshkruar me X për të fshehur identitetin e autorit. Në këtë artikull, Kenan argumentonte që liderët sovjetikë do të ndjeheshin gjithmonë të pasigurt rreth aftësive të tyre politike për të mbajtur pushtetin si kundër forcave kundërshtuese brenda shoqërisë sovjetike, ashtu edhe jashtë saj. Pasiguria e tyre do t'i orientonte drejt një politike të jashtme aktive dhe ndoshta agresive.

Megjithatë, Shtetet e Bashkuara e kishin fuqinë që të rrisin shtrëngesat nën të cilat duhej të vepronte lidhshipi sovjetik e cila do t'i çonte drejt një zbutjeje graduale ose drejt fundit të pushtetit sovjetik. Kenan dilte në përfundim që: në këto rrethana ishte e qartë që linja kryesore e çdo politike të SHBA-ve kundrejt Bashkimit Sovjetik duhet të ishte ajo e një politike në terma afatgjatë të durueshme por e ngurtë dhe vigjilente ndaj tendencave ekspansioniste të Rusisë. Shpejt pas kësaj, analiza e Kenanit në lidhje me sjelljen e sovjetikëve, u bë gurthemel i politikës së jashtme amerikane të pas luftës.

Kjo strategji e quajtur “politika e frenimit” kërkonte që të parandalonte ekspansionin e ndikimit sovjetik duke e rrethuar Bashkimin Sovjetik dhe duke e frikësuar atë me kërcënimin e një sulmi të armatosur.

Gjatë Luftës së Ftohtë, përveç dy grupeve kundërshtare – atij të SHBA-së së bashku me vendet perëndimore e demokratike nga njëra anë dhe Bashkimit Sovjetik me vendet lindore e komuniste nga ana tjetër – ekzistonte edhe një grup i tretë. Ky grup ishte i përbërë nga vendet që nuk dëshironin të ishin aleatë të njërës apo tjetrës palë në luftë që njëri prej si vendet e painkuadruara.

Sovjetikët besonin se sigurimi i fqinjëve miqësorë në kufijtë e saj perëndimorë ishte jetik për interesat kombëtare sovjetike. Nga ana tjetër në SHBA, politikanët amerikanë argumentonin se interesat amerikane konsistojnë në frenimin e Bashkimit Sovjetik.

Harry Truman ishte presidenti i Shteteve të Bashkuara kur filloi Lufta e Ftohtë. Strategjia e tij për luftën përfshiu edhe të ashtuquajturën “Doktrina Truman”, e cila ishte një plan për t’u dhënë fonde vendeve të kërcënuara nga komunizmi. Ky plan funksionoi mjaft mirë në rastin e Turqisë dhe Greqisë, të cilat nuk arritën të zotëroheshin nga sovjetikët falë fondeve amerikane.

Presidenti Amerikan duke justifikuar mbështetjen materiale për Greqinë kundër komunistëve deklaroi: Unë besoj se duhet të jetë politikë e SHBA-së mbështetja e popujve të lirë që po u rezistojnë përpjekjeve për nënshtrim nga ana e grupeve të armatosura apo nga presioni i jashtëm.

*“Unë besoj se duhet të ndihmojmë popujt e lirë që të ndërtojnë të ardhme sipas mënyrës së tyre”.*²

Më vonë SHBA u tërhoqën nga politika e frenimit (containment policy) ,duke e pakësuar numrin e forcave të armatosura me shpresë për kthim në një botë më paqësore.

Pas Luftës së Dytë Botërore vendet fituese të luftës vendosën të ndanin Gjermaninë në dy pjesë dhe Berlini ishte në pjesën lindore të vendit që zotërohej nga komunistët. Por megjithatë pjesa perëndimore e qytetit iu la në dorëzim Shteteve të Bashkuara dhe aleatëve të tyre.

Një nga momentet më të tensionuara të Luftës së Ftohtë ishte bllokimi nga ana e Bashkimit Sovjetik i rrugëve dhe hekurudhave që çonin në pjesën perëndimore të Berlinit. Presidenti Truman vendosi të përgjigjej duke dërguar furnizime me ushqime, qymyr, dhe ilaçe me anë të aeroplanëve. Në këtë veprim, që zgjati më tepër se një vit, Shtetet e Bashkuara u mbështetën dhe u ndihmuan nga Britania e Madhe dhe Franca.

Kështu frenimi, i bazuar në interesat gjeostrategjike amerikane, u bë doktrina e politikës së jashtme të SHBA-së përgjatë gjithë Luftës së Ftohtë.

Lufta e Ftohtë (1945-1989) karakterizohet përgjithësisht si 45 vjet tensioni dhe konkurrencë në nivel të lartë ndërmjet dy superfuqive të kohës, por pa konflikt të drejtpërdrejt ushtarak.

² International HUMAN Right nga Jack Donnelly dhe David P.Forsythe, Human Rights në International Realtion(Cambridge,Ang.;Cambridge University Press,200)

Gjatë kësaj periudhe kishte konfrontime shumë pranë luftës ,dhe secila palë vepronte me kujdes, me qëllim për të mos rrezikuar një përplasje bërthamore,ose sepse vendosmëria ideologjike zbehej nën dritën e realitetit ushtarak.

Lufta e Ftohtë përfshinte jo vetëm konfrontime mes superfuqive por edhe ndërmjet dy blloqeve shtetesh: nga njëra anë SHBA, Kanadanë dhe disa shtete të Evropës Perëndimore (NATO) dhe nga ana tjetër Bashkimi Sovjetik me aleatët e Traktatit të Varshavës në Evropën Lindore.

Formimi i NATO-s

NATO (*North Atlantic Treaty Organisation, Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior*, Akronym: *OTAV*) është blloku perëndimor ushtarak.

Kjo organizatë u themelua me firmosjen e Traktatit Atlantiko-Verior më 4 prill 1949 nga dymbëdhjetë vende themeluese: Belgjika, Danimarka, Franca, Britania e Madhe, Islanda, Italia, Luksemburgu, Holanda, Norvegjia, Portugalia si dhe Kanadaja dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës me qendër në Bruksel, si përgjigje ndaj kërcënimit të ekspansionit komunist të pas luftës, ndërkohë që Bashkimi Sovjetik po shtrinte influencën e tij në Evropën Qendrore dhe Lindore.

Qëllimi kryesor i saj është "të jetë ruajtëse e lirisë, civilizimit dhe trashëgimisë së përbashkët të anëtareve duke promovuar stabilitet dhe mirëqenie në zonën e Atlantikut të Veriut". Anëtarët e NATO-s kane rënë dakord që një sulm i armatosur ndaj njërit duhet konsideruar si sulm ndaj të gjithëve dhe se të gjithë duhet të mbështesin njëri-tjetrin. Në fillimet e saj aleanca përfshinte 12 vende. Në vitin 1952, NATO u zgjerua për të pranuar Greqinë dhe Turqinë dhe me pas në vitin 1955 Gjermaninë Perëndimore, si dhe Spanjën në vitin 1982.

Pas Luftës së Ftohtë procesi i zgjerimit i bazuar në nenin 10 të traktatit të Uashingtonit vijoi me anëtarësimin e shteteve të reja si Polonia, Republika Çeke, Hungaria në vitin 1999.

Në samitin e Pragës në nëntor të vitit 2002 aleanca ftoi edhe shtatë vende të tjera: Bullgaria, Estonia, Letonia, Lituania, Rumania, Sllovakia dhe Sllovenia, që të fillonin bisedimet për anëtarësim. Ato u bënë zyrtarisht anëtare të aleancës në fund të marsit 2004.

Në samitin e Bukureshtit në prill të 2008 Aleanca ftoi për anëtarësim Shqipërinë dhe Kroacinë, të cilat zyrtarisht u anëtarësuan në Aleancë në prill të 2009.

Më 5 qershor, të vitit 2017 Aleancës iu bashkua edhe Mali i Zi, ndërsa në 6 shkurt të viti 2019 Aleatët e NATO-s do firmosën protokollin e anëtarësimit të me Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Megjithatë, atëherë si dhe sot, aleanca dominohej nga SHBA. Kjo dominancë e kombinuar me përfshirjen në NATO të Gjermanisë Perëndimore, u pa nga Bashkimi Sovjetik si një kërcënim i drejtpërdrejtë ndaj saj.

Si kundërpërgjigje ndaj NATO-s, në vitin 1955 Bashkimi Sovjetik krijoi *Paktin e miqësisë, bashkëpunimit dhe i ndihmës së përbashkët* që ndryshe njihet me emërtimin “Traktati i Varshavës”.

Edhe pse Traktati i Varshavës u themelua si kundërpeshë ose si kundërbalancë ndaj NATO-s, megjithatë nuk ka pasur asnjëherë konfrontim të drejtpërdrejtë ushtarak ndërmjet dy blloqeve.

Shtetet anëtare të Traktatit të Varshavës ishin: Shqipëria, Bullgaria, Çekosllovakia, Gjermania Lindore, Hungaria, Polonia, Rumania dhe Bashkimi Sovjetik.

Interesi strategjik i Bashkimit Sovjetik ishte dominimi politik dhe ushtarak i Evropës Qendrore dhe Lindore. Qëllimi i sovjetikëve ishte që këto vende t’i mbante nën kontrollin e saj për të mos ua lëshuar amerikanëve. Kjo lloj politike bazohej në synime ideologjike dhe gjeostrategjike. Nga pikëpamja ideologjike, Bashkimi Sovjetik ia jepte

vetes të drejtën për ta definuar socializmin dhe komunizmin si dhe të veprojë si lidere e lëvizjes botërore socialiste. Nga pikëpamja gjeostrategjike, qëllimi i Bashkimit Sovjetik ishte që të krijojë *buffer zone* (tampon zonë) ndërmjet saj dhe NATO-s për të parandaluar ndonjë sulm të mundshëm ushtarak apo invazion të territorit të saj nga fuqitë e perëndimit.

Pas kolapsit të Bashkimit Sovjetik në vitin 1991, NATO ndërmori një sërë hapash drejt ndërtimit të marrëdhënieve të reja, me ish vendet e Paktit të Varshavës dhe ne veçanti me Rusinë, e cila i shihte me shume dyshim planet e Aleancës për t'u shtrirë në drejtim të lindjes. Në vitin 1994, NATO u ofroi ish anëtarëve të Paktit të Varshavës asociacione të kufizuara në formën e programeve të Partneritetit për Paqe, duke i lejuar të merrnin pjesë në ndarjen e informacioneve, stërvitjeve ushtarake të përbashkëta dhe operacioneve paqeruajtëse. Megjithatë të gjitha këto u duk se nuk bënë gjë tjetër veçse konfirmuan frikën e Rusisë, që e shikonte NATO-n, si një kërcënim për sigurinë e saj.



Asambleja Parlamentare e NATO-s (Foto)

Këshilli i Përbashkët dhe i Përhershëm NATO-Rusi u krijua në maj të vitit 1997 për t'i dhënë Rusisë një rol konsultativ në çështje të interesit të përbashkët. Dyshimet dhe frika e Rusisë u intensifikuan më tej, kur në vitin 1999, Republika Çeke, Hungaria dhe Polonia u bënë vendet e para të ish bllokut sovjetik, që u anëtarësuan në NATO, duke i sjellë dhe më afër Rusisë kufijtë e Aleancës.

ETAPA HISTORIKE NË PARTNERITET

- ❖ 1991 Takimi i parë i Këshillit të Kooperimit të Atlantikut të Veriut
- ❖ 1994 Fillimi i Partneritetit për Paqe (PfP); krijohen misionet e partnerëve për NATO-n; krijohet një Njësi e Koordinimit për Partneritetin në Selinë Qendrore të Fuqive Aleate për Europën (SHAPE)
- ❖ 1995 Krijohet një Qendër Ndërkombëtare Koordinuese në SHAPE
- ❖ 1996 Vendet partnere marrin pjesë në një forcë të udhëhequr prej NATO-s të krijuar për zbatimin e marrëveshjes boshnjake për paqe
- ❖ 1997 Takimi i parë i Këshillit të Partneritetit Euro-Atlantik (EAPC) në Sintra, Portugali; Në takimet e vazhdueshme të nivelit të lartë të NATO-s dhe të EAPC në Madrid, Spanjë, roli operativ i PfP është përmirësuar
- ❖ 1998 Krijimi i Qendrës Euro-Atlantike të Koordinimit të Reagimit ndaj Katastrofave dhe Njësia e Reagimit ndaj Katastrofave
- ❖ 1999 Tre partnerë – Republika Çeke, Hungaria dhe Polonia – bashkohen me NATO-n; Dialogu dhe bashkëpunimi përfshihet në Konceptin Strategjik të Aleancës si pjesë e detyrave themelore të tij për sigurinë; Në takimin e nivelit të lartë të Uashingtonit u ra dakord që të përmirësohej më tej PfP dhe të forcohet roli operativ i tij; Vendet partnere dislokojnë trupa si pjesë e Forcës në Kosovë të udhëhequr nga NATO
- ❖ 2001 12 shtator, EAPC mblidhet për të dënuar sulmet terroriste në Shtetet e Bashkuara dhe premtën të luftojë plagën e terrorizmit
- ❖ 2002 Vlerësimi i përgjithshëm çon në forcimin e EAPC dhe PfP në takimin e nivelit të lartë në Pragë; Fillon Plani i Veprimit të Partneritetit

kundër Terrorizmit

- ❖ 2003 Vendet partnere kontribuojnë me trupa për Forcën Ndërkombëtare të Asistencës për Sigurinë të udhëhequr nga NATO në Afganistan
- ❖ 2004 Shtatë partnerë – Bullgaria, Estonia, Letonia, Lituania, Rumania, Sllovakia dhe Sllovenia – bashkohen me NATO-n; Bëhen hapa të mëtejshëm për të forcuar Partneritetin në takimin e nivelit të lartë në Stamboll; Fillon Plani i Veprimit të Partneritetit për Ngritjen e Institucioneve të Mbrojtjes

NATO konsultohet rregullisht me partnerët e saj nëpërmjet Këshillit të Partneritetit Euro-Atlantik (EAPC), i cili siguron kuadrin e përgjithshëm politik për marrëdhënie me partnerët. Secili partner është gjithashtu në gjendje të ndërtojë një marrëdhënie individuale me Aleancën nëpërmjet Partneriteti për Paqe (PFP),³ një program veprimtarish brenda të cilit partnerët mund të zgjedhin përparësitë e tyre për bashkëpunim.

Këto bashkëpunime thelbësore janë tipare të përhershme të arkitekturës së sigurisë Euro-Atlantike.

FORMIMI I PAKTIT TË VARSHAVËS

Pakti i Varshavës ndryshe i njohur si Pakti i miqësisë, bashkëpunimit dhe i ndihmës së përbashkët u krijua më 14 maj 1955 në Varshavë, si mjet kundërshtimi i NATO-s me afat 20 vjeçar dhe është rinënskruar disa herë dhe ka ekzistuar deri në rënien e komunizmit dhe sistemeve totalitare.

³ Nato.int/docu/pub-form.htm

Palët nënshkruese të Paktit të Varshavës ranë dakord të abstenojnë nga dhuna ose nga kërcënimi i dhunës në marrëdhëniet ndërkombëtare. Traktati përcaktoi qëllimet e anëtarëve, që përfshinin paqen dhe sigurinë botërore dhe çarmatimin global.

Sidoqoftë, Bashkimi Sovjetik gjithashtu donte të përdorte Paktin e Varshavës si një mjet negociues me vendet europiane jo-komuniste. Kjo dëshmohet nga neni përmbyllës i paktit, i cili përcaktonte se marrëveshja do të mungonte në rast të një pakti kolektiv të sigurisë në Lindje-Perëndim. Gjithashtu pakti i obligonte anëtarët e saj për konsultime mbi çështjet e interesit të përbashkët dhe për ndihmë të menjëhershme ushtarake në rast të ndonjë sulmi në Evropë mbi një apo më shumë anëtarë të paktit.

Organet kryesore të paktit ishin me qendër në Moskë si: Byroja e Këshillit Politik (Politbyroja) dhe Kryekomanda e Bashkuar.

Organizata ushtarake e Paktit të Varshavës nuk ka pasur rol të veçantë, sepse në rast lufte palët nënshkruese të traktatit kanë kaluar nën komandimin sovjetik. Në fakt, Pakti ka qenë një instrument politik i Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike (BRSS-së) si fuqi udhëheqëse e Bllokut Lindor.

Pakti i Varshavës u nënshkrua vetëm 6 vjet pas themelimit të aleancës së NATO-s. Arsyeja për këtë është sepse NATO lejoi Gjermaninë Perëndimore të bashkohet me aleancën, dhe kjo nga ana e Bashkimit Sovjetik u pa si kërcënim ndaj Bllokut Lindor dhe i interesave të saja gjeopolitike.

Udhëheqësit sovjetikë ishin shumë të shqetësuar në lidhje me anëtarësimin e Gjermanisë Perëndimore, veçanërisht me kujtimet ende të freskëta të luftës së parë (kur Perandoria Ruse dhe më vonë Rusia Sovjetike ishin në luftë me Perandorinë Gjermane) dhe të dytë botërore (kur Bashkimi Sovjetik më 22 qershor 1941 u sulmua nga Gjermania Naziste). Andaj vendosën të marrin masa sigurie në vend, në formën e një aleance politike dhe ushtarake.

Pakti shërbente pra si një garanci sovjetike për të mbështetur vazhdimin e regjimeve komuniste dhe ekzistuese të kufijve në Evropën Lindore.

Gjithashtu pakti nuk ka garantuar as “jo ndërhyrjen e premtuar në punët e brendshme dhe respektimin e sovranitetit shtetëror të palëve nënshkruese”. Trupat sovjetike kanë vepruar dy herë për stopimin e rebelimeve kundër regjimeve totalitare në Hungari (në vitin 1956) dhe në Çekosllovakë (në vitin 1968).

Gjithashtu, paraqitja e lëvizjes sindikaliste *Solidarnost* tronditi themelet e partisë komuniste polake dhe me këtë edhe kontrollin sovjetik të Polonisë, gjë që nga Moska u pa si kërcënim kritik ndaj sigurisë së saj. Për shkak të pozitës qendrore gjeografike të Polonisë, këto zhvillime politike në këtë vend kërcënonin ta izolonin Gjermaninë Lindore, t’i pritnin vijat e komunikimit të forcave ushtarake sovjetike të rreshtuara kundër NATO-s, si dhe të pengonin kontrollin sovjetik ndaj pjesës tjetër të Evropës Lindore.

Ndërsa në vitin 1968 trupat sovjetike kanë marshuar në Çekosllovakë kundër reformave demokratike të qeverisë çekosllovake e udhëhequr nga Aleksandër Dubček. Në këtë vit pas pushtimit të Çekosllovakisë Shqipëria ka deklaruar daljen e saj nga Pakti i Varshavës. Për çekët dhe sllovakët me “vdekjen” e Paktit të Varshavës ata siguruan lirinë e tyre. Shpërbërja e tij është shpallur gjatë muajit korrik të vitit 1991 pikërisht në Pragë ku ishin mbledhur liderët e rinj demokratikë në krye me presidentin çek Vaclav Havel.

Garat në armatim si rrezik permanent për paqen botërore

Shkatërrimi i qyteteve japoneze Hiroshima dhe Nagasaki nga armët atomike të hedhura nga forcat ajrore amerikane në gusht të vitit 1945 nxiti nisjen e garës së armatimit ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik. Kjo garë zgjati deri në nëntor të vitit 1990 kur në Paris u nënshkrua Traktati i Forcave Konvencionale në Evropë ndërmjet dy vendeve.

Një gjeneratë e tërë u rrit nën hijen e një katastrofe globale. Do të mjaftonte vetëm një lider irracional, një gabim apo një keqkuptim që të shkaktojë zhdukjen e njerëzimit.

Kapitullimi i menjëhershëm i Japonisë në vitin 1945 sugjeroi se ShBA-të ishin në posedim të armëve me fuqinë më shkatërrimtare. Madje disa analistë janë të mendimit se qëllimi i vërtetë i përdorimit të armëve atomike kundër Japonisë, nuk ishte gjithaq që

Japonia të dorëzohet sesa që ishte intenca e Uashingtonit për ta frikësuar Bashkimin Sovjetik të udhëhequr nga diktatori Josef Stalin dhe për ta detyruar atë që të lëshojë pe ndaj dëshirës së SHBA-ve në rindërtimin e rendit të ri botëror bazuar në interesat e Uashingtonit. Kështu që, mund të thuhet se posedimi i armëve atomike për amerikanët paraqiste në të njëjtën kohë edhe një instrument shtesë të diplomacisë apo politikës së saj të jashtme.

Megjithatë, në vitin 1949, Bashkimi Sovjetik ia doli që me sukses ta testojë bombën e parë atomike, shumë më herët se sa që Uashingtoni kishte pritur. Kjo gjë shkaktoi shok në Shtetet e Bashkuara të Amerikës duke bërë që presidenti i atëhershëm amerikanë – Harry Truman të autorizojë zhvillimin e bombave termonukleare apo bombave hidrogjenike e cila kishte potencial shkatërrues disa mijëra herë më të madh sesa bombat e përdorura në dy qytetet japoneze – Hiroshima dhe Nagasaki.

Sovjetikët do t’ia arrinin testimin e bombave hidrogjenike në vitin 1953. Ndërkohë, Uashingtoni filloi ndërtimin e raketave me rreze të gjatë: raketat *Atlas* dhe *Titan* (Raketa Balistike Interkontinentale), raketat *Jupiter* dhe *Thor* (Raketa Balistike me rreze të mesme) dhe raketa *Polaris* (Raketa Balistike të Lëshuara nga Nëndetëset). Në këtë mënyrë, amerikanët e ruanin përparësinë teknologjike kundrejt sovjetikëve. Por, në vitin 1957, sovjetikët lansuan rreth orbitës së Tokës, satelitin e parë artificial *Sputnik 1*. Kjo shkaktoi frikë tek publiku amerikan për arsye se kjo nënkuptonte se tani i gjithë territori i ShBA-ve ndodhej brenda rrezeve të raketave sovjetike. Shtetet e Bashkuara lansuan satelitin e tyre të parë – Explorer 1 pas një viti, pra më 1958.

Lufta e Ftohtë do ta arrijë kulminacionin në vitin 1962 kur shërbimet sekrete amerikane do t’i zbulojnë raketat balistike të Bashkimit Sovjetik në ishullin e Kubës, shumë pranë territorit të ShBA-ve (vetëm 140 km larg Floridës). Ky konfrontim konsiderohet si momenti kur Lufta e Ftohtë ishte shumë pranë eskalimit në një luftë totale nukleare.

Si përgjigje ndaj invazionit amerikan të dështuar kundër regjimit të Fidel Kastos në vitin 1961 si dhe në përgjigje të pranisë së raketave balistike amerikane Jupiter në Itali dhe në Turqi, lideri sovjetik Nikita Hrushev e pranoi kërkesën e udhëheqjes së Kubës për

të vendosur raketa nukleare në ishull me qëllim që të shmanget një tjetër invazion i mundshëm nga ana e amerikanëve.

Pas disa ditë negociatash të tensionuara, më në fund u arrit një marrëveshje ndërmjet presidentit amerikan Xhon Kenedi dhe liderit sovjetik Nikita Hrushev. Sovjetikët, publikisht do t'i demontnin raketat e tyre drejtuar ShBA-ve për t'i kthyer prapa në Bashkimin Sovjetik dhe do të lejonin hyrjen e një misioni verifikues nga OKB-ja, ndërsa nga ana e tyre, amerikanët do të zotohen publikisht se më nuk do të tentojnë ta rrëzojnë regjimin e Kastros në Kubë.

Fshehurazi nga publiku amerikan, Uashingtoni u pajtua t'i tërheqë të gjitha raketat balistike Jupiter të vendosura në Turqi kundër Bashkimit Sovjetik.

Për shkak të rrezikut të luftës termonukleare, Hrushevi propozoi relaksimin e marrëdhënieve të tensionuara me Shtetet e Bashkuara. Në një letër dërguar presidentit amerikan Xhon Kenedi më 30 tetor 1962, Hrushevi propozoi ndërmarrjen e një sërë nismash që do ta parandalonin rrezikun e një krize të re nukleare, duke përfshirë edhe një traktat për mos-sulmim ndërmjet NATO-s dhe Paktit të Varshavës. Ai madje propozoi edhe shpërbërjen e blloqeve ushtarake respektive, nënshkrimin e një marrëveshjeje me të cilën do ta ndalohej testimi i armëve bërthamore e deri në eliminimin e vetë këtyre armëve. Këtyre propozimeve, Kenedi iu përgjigj negativisht. Megjithatë, pas një kohe, të dyja vendet u pajtuan që t'i ndalin testimet e armëve bërthamore në atmosferë, duke nënshkruar edhe marrëveshje të njohur si Traktati i Ndalimit të Pjesës së Testimeve Nukleare.

Pas kësaj krize, të dyja vendet themeluan linjën komunikuese Moskë-Uashington që kishte për qëllim komunikimin e drejtpërdrejtë dhe më efektiv të udhëheqësve të të dyja vendeve rivalizuese në zgjidhjen e krizave eventuale të kësaj natyre.

Lufta e Ftohtë ndërmjet Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara kurrë nuk degjeneroi në luftë të hapur. Një nga arsyt ishin seria e më shumë se 25 marrëveshjeve të kontrollit të armëve që Moska dhe Uashingtoni negociuan pas zgjidhjes së krizës së raketave kubane. Liderët sovjetikë dhe amerikanë arritën një sërë marrëveshjes modeste të cilët kishin qëllim të stabilizonin balancat ushtarake dhe të reduktonin rrezikun e luftës.

Secila ng këto traktate dypalëshe ulte tensionet dhe ndihmonte në ndërtimin e një klime të besimit që inkurajonin përpjekjet për të negociuar marrëveshje të mëtejshme.

Në fund të viteve '60, në përpjekjet për t'i relaksuar marrëdhëniet me Moskën, presidenti amerikan Riçard Nikson promovoi dialog më të gjerë me qeverinë sovjetike, duke përfshi mbajtjen e samiteve bilaterale, fillimin e negociatave për kontrollin e armëve si dhe marrëveshje të tjera bilaterale. Kjo periudhë e karakterizua me nënshkrimin e marrëveshjes të njohur si *SALT I* (Strategic Arms Limitation Treaty) me të cilën të dyja vendet u zotuan se nuk do ta shtojnë numrin e lansuesve të raketave balistike strategjike dhe numrin e raketave balistike ndërkontinentale (ICBM – Intercontinental Ballistic Missiles), kapsulave bërthamore të pozicionuara kundër njëri-tjetrit, mjeteve të shumta të lëvizshme të pavarura që mund të bëhen objektiv sulmi (MIRV – Multiple Independent Reentry Vehicles) dhe kufizoi numrin e bazave të raketave antibalistike që do të mund të mbante secila superfuqi. Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Sovjetik u pajtuan në parim që të mos përzihen në punët e brendshme të njëri-tjetrit dhe njëherazi premtuan rritjen e shkëmbimit dhe bashkëpunimit ekonomik, shkencor dhe kulturor me interes të përbashkët.

Traktatet shumëpalëshe më të mëdha të kontrollit të armëve nga 1945			
Data	Marrëveshja	Numri i vendeve nënshkruese	Objektivat kryesore
1959	Traktati i Antarktikut	45	Parandalimi i përdorimit të armëve në Antarktik përfshi testimin e armëve nukleare
1963	Traktati i pjesshëm i ndalimit të testimeve	136	Ndalimi i armëve nukleare në atmosferë, hapësirën e jashtme dhe nën ujë
1967	Traktati i hapësirës së jashtme	134	Nxjerr jashtë ligjit përdorimin e hapësirës së jashtme për testimin dhe stacionimin e armëve si dhe

			për manovra ushtarake
1967	Traktati i Tlatelolco-s	33	Krijimi i zonës së lirë nukleare latinoamerikane duke ndaluar testimin dhe zotërimin e mjeteve nukleare për qëllime ushtarake
1968	Traktati i mos shtimit nuklear	189	Parandalon përhapjen e armëve nukleare dhe teknologjive të prodhimit të arëve nukleare në shtete jonukleare
1971	Traktati i Shtratit të Detit	115	Ndalon zhvillimin e armëve të shkatërrimit në masë dhe armëve nukleare në shtratin e detit përtej kufirit bregdetar prej 12 milje
1972	Konventa e Armëve Biologjike dhe Toksike	171	Ndalon prodhimin dhe magazinimin e toksinave biologjike, bën thirrje për shkatërrimin e rezervave të armëve biologjike
1977	Konventa e modifikimit të mjedisit (Konventa Enmod)	87	Ndalon përdorimin e teknologjive që mund të ndryshojnë sistemet e motit, rrymat e oqeanëve, shtresën e ozonit, apo ekologjinë
1980	Konventa e mbrojtjes të materialit nuklear	132	Detyron mbrojtjen e materialit paqësor nuklear gjatë transportit detar apo ajror
1981	Konventa e armëve të	108	Ndalon përdorimin e armëve

	panjerëzishme		të tilla si bomba të fragmentuara, zjarrvënëse, kurthe dhe mina ndaj të cilave njerëzit janë të ekspozuar
1985	Traktati i zonës së lirë nukleare të paqësorit jugor (Roratonga)	19	Ndalon testimin, përvetësimin apo shpërndarjen e armëve nukleare në paqësorin jugor
1987	Regjimi i kontrollit të teknologjisë së raketave (MTCR)	34	Kufizon eksportin e raketave balistike dhe prodhimin e pajisjeve të tyre
1990	Forcat konvencionale në Evropë (CFE)	30	Kufizon eksportin e raketave balistike dhe prodhimin e pajisjeve të tyre

Megjithatë, periudha e relaksimit të marrëdhënieve ndërmjet Uashingtonit dhe Moskës që ndryshe njihet edhe si *detant* mori fund me intervenimin sovjetik në Afganistan në vitin 1979. Uashingtoni u përgjigj me bojkotimin e Lojërave Olimpikë të vitit 1980 që mbaheshin në Moskë. Fitorja në zgjedhjet elektorale në ShBA të Ronald Reganit shënoi kthimin e tensioneve të Luftës së Ftohtë. Administrata e Reganit kishte një qasje më agresive dhe më të fortë kundërt komunizmit në përgjithësi dhe Bashkimit Sovjetik në veçanti. Në një fjalim të mbajtur në vitin 1983, Regani do t'i referohet Bashkimit Sovjetik si “*perandoria e se keqes*” (evil empire).

Në anën tjetër, retorika e sovjetikëve tentonte t'i portretizonte Shtetet e Bashkuara si një superfuqi imperialiste që synon ta dominojë të gjithë globin duke shtuar se Bashkimi Sovjetik po luftonte pikërisht kundër kësaj dhe në emër të humanizmit. Sipas tyre, referimi i Reganit për Bashkimin Sovjetik si një “perandori e së keqes” demonstronte se administrata e tij “mendon vetëm në terma të konfrontimit dhe një lufte lunatike (të çmendur) antikomuniste.

PËRPLASJA E IDEOLOGJIVE DHE FUNKSIONIMI I BOTËS DERI NË SHEMBJEN E MURIT TË BERLINIT

Dallimet ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike (BRSS) në planin ideologjik dhe në sistemit politik ishin shumë të mëdha. Në Rusi, komunistët erdhën në pushtet në vitin 1917. Shtetet e Bashkuara dhe Britania e Madhe ishin të shqetësuara se ideologjia komuniste mund të shtrihej edhe në vendet e tyre. Për këtë arsye, në luftën civile në rusi ndërmjet komunistëve dhe forcave antikomuniste, ata vendosën t'i mbështesin këta të fundit. Në fakt, Uashingtoni nuk e njohu Bashkimin Sovjetik deri në vitin 1933. Gjërat ndryshuan përkohësisht gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur të dyja vendet u bënë aleate në luftën e tyre kundër Gjermanisë.

Dallimet ndërmjet SHBA-së dhe Bashkimit Sovjetik buronin që nga ideologjitë e tyre. Komunizmi ishte ideologjia që ndiqej nga Bashkimi Sovjetik. Përpos se Bashkimi Sovjetik ishte vend komunist, ai ishte njëherazi edhe një shtet totalitar, që do të thotë se i gjithë pushteti ishte i koncentruar në duart e një grupi njerëzish apo në duart e liderit, ndalim i partive të tjera politike, kontroll i lartë i partisë në pushtet mbi jetën publike dhe private. Regjimet totalitare konsiderohen si forma më ekstreme e autoritarizmit.

Si një shtet totalitar, Bashkimi Sovjetik karakterizohej me represion apo shtypje të lartë politike, kult të personalitetit, kontroll mbi ekonominë e vendit, kufizim të fjalës së lirë, survejimit (mbikëqyrjes) masive nga ana e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetike ndaj shtetasve të saj, dhe përdorim të gjerë të terrorit shtetëror. Të gjitha mjetet e komunikimit publik (gazetat, radioja, televizioni) ishin nën kontrollin total të partisë. Feja, institucionet fetare dhe kleri fetar ishin të persekutuar. Në Bashkimin Sovjetik, për religjionet flitej si ishin “opium për njerëzimin”.

Në periudhën ndërmjet viteve 1927-1953, në krye të Bashkimi Sovjetik ishte Josef Stalini i cili ishte Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe

kryeministër i vendit nga viti 1941 e deri në vdekjen e tij në vitin 1953. Gjatë kohës së regjimit stalinist, me miliona njerëz u deportuan, burgosën, persekutuan dhe u ekzekutuan në një shkallë të paprecedentë në histori. Në fund të viteve '20 të shekullit të kaluar, Stalini planifikoi ta transformojë Bashkimin Sovjetik, nga një vend agrar në një vend industrial. Plani i tij zhvillimor bazohej në kontrollin qeveritar mbi ekonominë duke përfshi edhe kolektivizimin e dhunshëm të agrokulturës së vendit, me ç'rast qeveria mori kontrollin e tokave bujqësore. Miliona bujq refuzuan këtë plan të iniciuar nga Stalini dhe shumë prej tyre ose u deportuan ose u ekzekutuan nga policia sekrete.



Lenini dhe Stalini

Kolektivizimi i dhunshëm shkaktoi zinë e urisë, duke pasur për pasojë vdekjen nga uria të miliona njerëzve.

Stalini qeverisi me anë të terrorit dhe dorës së hekurt me qëllim eliminimin e secilit që mendonte ndryshe. Ai e zgjeroi fuqinë e policisë sekrete, i nxiti qytetarët të spiunojnë njëri-tjetrin dhe miliona njerëz i dërgoi në kampet e punës së detyrueshme në të gjithë Bashkimin Sovjetik, përfshi edhe në Siberi.

Përveç kësaj, Stalini ndërtoi rreth vetes edhe kultin e personalitetit. Qytete të tëra u emëruan me emrin e tij (si p.sh. qyteti Volgograd i cili e mori emrin Stalingrad). Tekstet e historisë u rishkruan me qëllim që atij t'i japin një rol më të rëndësishëm në revolucionin bolshevik, duke mitizuar shumë aspekte të jetës së tij. Ai ishte personazh

kryesor në shumë vepra të artit, të letërsisë, muzikës dhe emri i tij u bë pjesë e himnit kombëtar të Bashkimit Sovjetik.

Në anën tjetër, Shtetet e Bashkuara të Amerikës karakterizoheshin me plularizmin politik, mbajtjen e zgjedhjeve të lira, ndarjen e pushteteve, sundimin e ligjit, ekonominë e tregut, mbrojtjen e pronës private dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, liritë dhe të drejtat qytetare dhe me liritë politike për të gjithë qytetarët.

Angazhimi i blloqeve për mbisundim

Përfundimi i Luftës së Dytë Botërore u pasua nga rënia e perandorive kolonialiste evropiane dhe njëkohësisht ngritja në skenën ndërkombëtare të dy superfuqive: Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik. Vendet e Evropës Perëndimore u rindërtuan me ndihëm e Uashingtonit të njohur si *Plani Marshall*, ndërsa vendet e Evropës Lindore dhe Qendrore ranë nën sferën sovjetike të ndikimit. Kontinenti evropian u nda në Bllokun Perëndimore nën drejtimin e ShBA-ve dhe në Bllokun Lindor nën drejtimin e Bashkimit Sovjetik. Disa vende të Evropës (si p.sh. Jugosllavia) u përpoqën të qëndrojnë jashtë Luftës së Ftohtë përmes Lëvizjes së të Pajkuadruarve.

Programi i ndihmës për rindërtim (ERP), njohur gjerësisht si një koncept ekonomiko-politiko-historik tashmë me emrin plani "Marshall", ishte programi më i rëndësishëm amerikan për ringjalljen ekonomike të kontinentit evropian (në fakt arriti të përfitonte vetëm pjesa perëndimore e tij) pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Programi në fjalë u iniciua nga ish-sekretari amerikan i Shtetit për Punët e Jashtme (mandati i të cilit në këtë post zgjati nga 1947-1949) dhe më pas, mbajtës i çmimit "Nobel" për paqe në vitin 1953, George C. Marshall. Plani që u pagëzua me emrin e tij u përpunua më pas nga ekspertët e Departamentit të Shtetit, William L. Clayton dhe George F. Kennan. Për nisjen e vënien në jetë të këtij plani pati tri arsye bazë: ndihma për popujt evropianë në nevojë e pjesërisht të kërcënuar seriozisht nga uria, si pasojë e një lufte, më shkatërrimtarja që njerëzimi kishte përjetuar ndonjëherë, pengimi i zgjerimit të ideve,

praktikave e ndikimit sovjetik në kontinent, si dhe arritja e një tregu funksional që do të bënte të mundur shitjen e produkteve të ndërmarrjeve amerikane me mbiprodhim.⁴

Plani në fjalë nisi udhën zyrtarisht pas një takimi të datës 5 qershor 1947 në Paris, ku morën pjesë 16 shtete evropiane. Bashkimi Sovjetik dhe vendet e Evropës Lindore, që asokohe sapo kishin nisur të binin nën diktatin sovjetik, gjithsesi morën të gjithë ftesë për pjesëmarrje në këtë program, por Stalini e cilësoi planin si "rrezik për interesat sovjetike në Evropën Lindore", vargun e vendeve të të cilit ai e trajtonte si një "rrip sigurie" përballë ekspansionit amerikan. Ai ndaloi kështu shtetet nën ndikimin e BS-së të merrnin pjesë e të përfitonin nga ky program bujar. BRSS-ja hedh poshtë më 12 korrik ofertën amerikane nga frika e vendosjes së një kontrolli mbi ekonominë e vendeve që ajo dominonte dhe që do të vinte në dyshim strategjinë e saj në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore.

Programi zgjati katër vjet. Shuma e ndihmave ekonomike të lëvruara si pasojë e këtij programi nga SHBA-ja arriti shifrën e rreth 12,4 miliardë dollarëve - ose 85 miliardë euro me normat e sotme të këmbimit - në kredi, lëndë të para, mallra ushqimore e ato të konsumit.

Për ta qartësuar pozicionin amerikan, Sekretari amerikan i shtetit, Xhorxh Marshall, para studentëve të diplomimit në Universitetin e Harvardit mbajti një fjalim ku në vija të përgjithshme prezantoi planin e tij. Mes tjerash, ai u shpreh:

“Është e logjikshme që Shtetet e Bashkuara duhet të bëjnë atë çfarë është e nevojshme për të ndihmuar rikuperimin ekonomik të botës, pa të cilën nuk mund të ketë stabilitet politik dhe as paqe të sigurt. Politika jonë nuk është e drejtuar kundër asnjë vendi, por kundër urisë, varfërisë, mjerimit dhe kaosit. Çdo qeveri që ka vullnet për të ndihmuar në rimëkëmbjen ekonomike, do të gjejë bashkëpunim të plotë tek Shtetet e Bashkuara”.

Pjesa më e madhe e ndihmave financiare iu dha fuqive më të mëdha industrial meqë ekzistonte bindja se rimëkëmbja e tyre ekonomike ishte esenciale për rimëkëmbjen e përgjithshme të Europës. Venet që ishin aleat me Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjatë luftës morën më shumë ndihmë financiare në krahasim me vendet që ishin në anën e Fuqive të Boshtit apo vendet neutral. Prandaj më e madhe e ndihmave të Planit Marshall

⁴ Behrman, Greg (2007). *The Most Noble Adventure: The Marshall Plan and the Time When America Helped Save Europe*. Simon & Schuster

ishite Mbretëria e Bashkuar (duke marrë rreth 26% nga totali), e pasuar nga Franca (18%) dhe Gjermania Perëndimore (11%).

Programe të ngjashme ndihmëse, Uashingtoni siguroi edhe për vendet në Azi, por këto nuk ishin të përfshira në Planin Marshall.

Ndonëse Lufta e Ftohtë nuk eskaloi në një konfrontim të drejtpërdrejtë ushtarak ndërmjet dy superfuqive, megjithatë prej fillimit e deri në përfundimin e saj (1947-1991), në shumë rajone të globit, pati një sërë konfliktesh që kishin të bëjnë me Luftën e Ftohtë.

Lufta Civile Greke (1946-1949) u zhvillua ndërmjet qeverisë greke të mbështetur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Mbretëria e Bashkuar dhe krahut ushtarak të Partisë Komuniste Greke të mbështetur nga regjimet komuniste të Jugosllavisë, Shqipërisë dhe Bullgarisë. Lufta civile ishte rezultat i polarizimit ideologjik të skajshëm të shoqërisë greke ndërmjet të majtëve dhe të djathtëve që filloi më 1943. Lufta civile greke ishte një nga konfliktet e para të Luftës së Ftohtë dhe paraqet shembullin e parë të përfshirjes ushtarake në çështjet e brendshme të një vendi menjëherë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Pas përfundimit të luftës, Uashingtoni, nën Doktrinën Truman, në vitin 1952 e përfshiu Greqinë në NATO. Qëllimi i kësaj politike të jashtme ishte kundërshtimi i ekspansionit gjeopolitik të Bashkimit Sovjetik.

Lufta e Koreve (1950-1953) ishte konflikti ushtarak ndërmjet Koresë së Veriut (e mbështetur nga Bashkimi Sovjetik dhe Republika Popullore e Kinës) dhe Koresë së Jugut (e mbështetur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe aleatët e saj). Lufta filloi më 25 qershor 1950 kur forcat koreano-veriore e invaduan Korenë e Jugut.

Si një produkt e Luftës së Ftohtë ndërmjet Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara, më 1948, Koreja u nda në dy shtete sovraane duke e vendosur kufirin ndërmjet të dyja shteteve në paralele 38. Në pjesën veriore të gadishullit korean, u vendos një sistem socialist, ndërsa në pjesën jugore u vendos një sistem kapitalist. Të dyja qeveritë e shteteve koreane pretendonin se ishin përfaqësues të vetëm legjitim të të gjithë Koresë dhe asnjëra palë nuk e pranoi si të përhershëm kufirin e vendosur. Konflikti eskaloi në luftë kur Koreja e Veriut, me mbështetjen e aleatëve të saj, sulmoi Korenë e Jugut. Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara autorizoi themelimin e Komandës së

Kombeve të Bashkuara dhe dërgimin e forcave ushtarake në Kore për të zmbarsur invazionin koreano-verior. 21 vende të Kombeve të Bashkuara kontribuan me trupa ushtarakë, ndërsa vetëm Shtetet e Bashkuara përbënin 90% të personelit ushtarak.

Revolucioni kuban (1953-1959) paraqet kryengritjen e armatosur të drejtuar nga lëvizja revolucionare e udhëhequr nga Fidel Kastroja kundër qeverisë autoritare të presidentit kuban Fulgencio Batista. Revolucioni filloi në korrik të vitit 1953 dhe vazhdoi deri në fitoren e kryengritësve në dhjetor të vitit 1958.

Revolucioni kuban ishte një pikë kthese në marrëdhëniet SHBA-Kubë. Menjëherë pas konsolidimit të regjimit të Kastros, qeveria e tij filloi me nacionalizimin e pronave të Shteteve të Bashkuara në vend, ndërsa presidenti amerikan Eisenhower u përgjigj me ngrirjen e aseteve kubane, ndërprerjen e marrëdhënieve diplomatike dhe shtrëngimin e embargos tregtare, ekonomike dhe financiare ndaj Kubës.

Gjatë Luftës së Ftohtë, Kuba u përfshi në mënyrë aktive në mbështetjen e lëvizjeve komuniste në shumë vende të botës, duke dërguar ndihmë ushtarake në Ganë, Nikaragua, Jemen, Angolë etj. Intevrimenti i Kastros në Luftën Civile në Angolë në vitet '70 dhe '80 ishte veçanërisht domethënës, duke përfshirë plot 60 mijë ushtarë.

Pas embargos së ShBA-ve kundër regjimit të Kastros, Bashkimi Sovjetik u bë aleati kryesor i Kubës. Të dyja vendet zhvilluan marrëdhënia të ngushta diplomatike dhe ushtarake, e cila marrëdhënie kulminoi me dislokimin e armëve bërthamore sovjetike në Kubë në vitin 1962, e cila ngjarje shkaktoi atë që njihet si Kriza e raketave në Kubë. Kuba pati marrëdhënie të ngushta me BRSS-në (Bashkimin Sovjetik) deri në shpërbërjen e saj në vitin 1991. Ndërprerja e ndihmës ekonomike sovjetike pati për pasojë një krizë të thellë ekonomike në vend.

Lufta në Vietnam (1955-1975) u zhvillua ndërmjet Vietnamit të Veriut (të mbështetur nga Bashkimi Sovjetik dhe Republikës Popullore të Kinës) dhe Vietnamit të Jugut (të mbështetur nga SHBA-të dhe aleatët e saj). Synimi i Uashingtonit ishte që ta parandalojë fitoren e komunistëve vietnamezë e cila do të rezultonte në dominimin e tërë rajonit të Indokinës nga vende komuniste - armiqësore ndaj Shteteve të Bashkuara. Kjo do të kishte për pasojë ndryshimin e *balancës së fuqive* në pjesën e Azisë Juglindore.

Në anën tjetër, Bashkimi Sovjetik i furnizonte forcat e Vietnamit të Veriut me pajisje ushtarake (tanke, avionë, helikopterë, artileri, raketa anti-ajrore si dhe me mjete të tjera ushtarake). Pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, zyrtarë rusë pranuan se gjatë luftës në Vietnam, sovjetikët kanë stacionuar rreth 3000 trupa në Vietnam. Lufta përfundoi me fitoren e komunistëve dhe me bashkimin e Vietnamit.

Lindja e Mesme - Për ShBA-në dhe Bashkimin Sovjetik rajoni i Lindjes së Mesme ishte me rëndësi jetike, për shkak të burimeve të tij natyrore (që përfshin rreth 1/3 e naftës në botë, ose përafërsisht gjysmën e rezervave), pozitës së saj strategjike ndërmjet Azisë dhe Evropës si dhe rëndësisë së saj kulturore si djepi i tre feve kryesore të botës. Nuk është çudi që pas krijimit të Izraelit më 1948, të njohur diplomatikisht së pari nga ShBA, rajoni u bë skenë e konfrontimit të superfuqive përmes satelitëve të tyre: ndërmjet Izraelit të mbështetur politikisht nga Shtetet e Bashkuara dhe shteteve arabe të Sirisë, Irakut dhe Egjiptit, të mbështetur nga Bashkimi Sovjetik.

Gjashtë luftës së Gjashtë Ditëve (1967), Izraeli arriti të dominojë ndaj shteteve arabe (të pajisur me armatime nga sovjetikët) brenda gjashtë ditëve, duke pushtuar territore strategjike, si Lartësia e Golanit (të cilën Izraeli ia mori Sirisë), rripin e Gazës, Bregun Perëndimor, duke përfshirë edhe Jerusalemin lindor (që para konfliktit i takonte Jordanisë) dhe Gadishullin e Sinait (të cilën Izraeli ia mori Egjiptit). Në vitin 1973, gjatë luftës Jom Kipur (ang. Yom Kippur), fitorja e Izraelit nuk ishte aq e madhe, ndërsa amerikanët dhe sovjetikë negociuan një armëpushim para se të shkaktohej një dëm më i madh. Për sa kohë ruhej ekuilibri i forcës mes Izraelit (dhe SHBA) nga njëra anë dhe vendeve arabe (dhe Bashkimit Sovjetik) në anën tjetër, rajoni lihej i qetë. Por kur ky ekuilibër vihej në dyshim, superfuqitë vepronin përmes satelitëve të tyre për të ruajtur balancën.



Lufta gjashtë ditore e 1967-ës:

Afrikë – Rivaliteti amerikano-sovjetik, gjatë Luftës së Ftohtë, u reflektua edhe në kontinentin afrikan.

Një prej konflikteve më të njohura në këtë periudhë ishte konflikti në Angolë dhe në Kepin e Afrikës (Etiopi dhe Somali). Në këto konflikte, pjesëmarrësit në luftërat civile, mbështeteshin dhe furnizoheshin me pajisje ushtarak dhe ekspertizë teknike nga njëra prej dy superfuqive. Kjo luftë ndërmjet shteteve satelite i shërbeu para së gjithash interesave të superfuqive (ShBA-së dhe Bashkimit Sovjetik), duke u lejuar atyre të projektonin fuqi dhe të mbronin interesat e tyre gjeostrategjike (si p.sh. nafta në Angolë, rrugët e transportit përreth Kepit të Afrikës etj.) dhe ideologjitë pa u konfrontuar drejtpërdrejtë me njëra-tjetrën.

Armët bërthamore e rrezikuan seriozisht paqen botërore gjatë dekadës së parë të Luftës së Ftohtë, nga fundi i viteve 1940, kur Shtetet e Bashkuara kishin superioritet bërthamor.

Nëse i rikthehemi Krizës Kubane të Raketave, edhe pse armët bërthamore ishin një pjesë themelore e arsyes se pse ndodhën ato ngjarje, raketat luajtën gjithashtu një rol të rëndësishëm në mbylljen e krizës në mënyrë paqësore. Mendimi i një lufte botërore bërthamore, i bëri të dy udhëheqësit të tërhiqen nga gremina, dhe të arrijnë një zgjidhje të negociuar.

Një pikëpamje e caktuar mbi përhapjen e armëve, thotë se paqja arrihet më së miri, përmes një barazie në armatime – me fjalë të tjera, mënyra më e mirë për të siguruar paqen, ka qenë që të dyja palët e një konflikti të kishin aftësi bërthamore.

Roli i vendeve të painkuadruara

Krijimi dhe fuqizimi i bllokut socialist pas disfatës së regjimeve fashiste në Luftën e Dytë Botërore, kolapsi i perandorive kolonialiste, paraqitja e një bote bipolare dhe formimi i blloqeve ushtarake (NATO-s dhe Paktit të Varshavës), të gjitha këto paraqisnin një kontekst të ri ndërkombëtar që Çoi në nevojën e një koordinimi dhe bashkëpunimi multilateral ndërmjet shteteve që nuk ishin apo nuk donin të ishin palë në asnjërin bllok.

Në këtë kontekst, shtetet e pazhvilluara, shumica e tyre në Afrikë dhe në Azi, ndjenë nevojën për bashkimin e përpjekjeve për mbrojtje të përbashkët të interesave të tyre dhe forcimin e pavarësisë dhe sovranitetit të tyre.

Konferenca Azi-Afrikë e mbajtur më 18-24 prill 1955 në Bandung të Indonezisë nga 29 krerë shtetesh merret si momenti më i rëndësishëm pas së cilës do të lindte Lëvizja e Vendeve të Painkuadruara.

Në këtë konferencë u bë shpallja e parimeve mbi të cilat do të mbështeteshin marrëdhëniet ndërmjet shteteve të njohura si “Dhjetë parimet e Bangungut”. Përmbushja e këtyre parimeve u bë kriteri themelor për anëtarësim në Lëvizjes e Vendeve të Painkuadruara.

Në vitin 1960, në Organizatën e Kombeve të Bashkuara do të anëtarësohen plot 17 shtete të reja të Afrikës dhe Azisë. Në këtë proces, rol kyç kanë luajtur krerët e shteteve dhe qeverisë si Gamal Abdel Nasser i Egjiptit, Kwame Nkrumah i Ganës, Jawaharlal Nehru i Indisë, Ahmed Sukarno i Indonezisë dhe Josip Broj Titoja i Jugosllavisë të cilët më vonë do të bëhen “etërit themelues” të Lëvizjes së Vendeve të Painkuadruara dhe figurat më emblematike të saj.

Gjashtë vjet pas Konferencës së mbajtur në Bandung, Lëvizja e Vendeve të Painkuadruara u themelua në samitin e parë të konferencës të mbajtur në Beograd, që u mbajt prej 1 deri më 6 shtator 1961. Në konferencë morën pjesë 25 vende: Afganistani, Algjeria, Jemeni, Mianmari, Kamboxhia, Sri Lanka, Kongoja, Kuba, Qiproja, Egjipti, Etiopia, Gana, Guneja, India, Indonezia, Iraku, Libani, Mali, Marokoja, Nepali, Arabia Saudite, Somalia, Sudani, Siria, Tunizia, Jugosllavia.

Objektivat kryesorë të vendeve të painkuadruara u fokusuan në mbështetjen e parimit të vetëvendosjes, pavarësisë kombëtare, sovranitetit dhe integritetit territorial të shteteve; kundërshtimin e aparteidit, mos anëtarësimin në asnjë pakt ushtarak multilateral, luftën kundër imperializmit në të gjitha format dhe manifestimet e saj, luftën kundër kolonializmit, neokolonializmit, racizmit, okupimeve dhe dominimeve të huaja, çarmatosjen, mosndërhyrjen në punët e brendshme të shteteve, përjashtimin e përdorimit të forcës apo kërcënimit të përdorimit të forcës në marrëdhëniet ndërkombëtare, forcimin e Kombeve të Bashkuara, demokratizimin e marrëdhënieve ndërkombëtare, zhvillimin socioekonomik dhe ristrukturimin e sistemeve ekonomike ndërkombëtare etj.

Gjatë ekzistencës së Lëvizjes së Vendeve të Painkuadrura, numri i vendeve anëtare është rritur gjithnjë e më tepër. Pavarësisht dallimeve ideologjike, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore, gjitha vendet anëtare të lëvizjes i kanë pranuar parimet themelore dhe objektivat kryesorë duke shfaqur gatishmërinë për t'i implementuar të njëjtat.

Dhjetë parimet e Bandungut

1. Respektimi i të drejtave themelore të njeriut dhe objektivave dhe parimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara;
2. Respektimi i sovranitetit dhe integritetit territorial të të gjitha shteteve;
3. Njohja e barazisë ndërmjet të gjitha racave dhe barazisë ndërmjet të gjitha shteteve, pavarësisht nga madhësia
4. Mos intervenim dhe mosndërhyrje në punët e brendshme të shteteve tjera;
5. Respektimi i të drejtës së çdo vendi për vetëmbrojtje, qoftë individualisht, qoftë në mënyrë kolektive, në pajtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara;
6. A. Mos shfrytëzimi i pakteve të mbrojtjes kolektive, për interesat specifike të ndonjë fuqie të madhe.
B. Eliminimi i trysnisë nga çfarëdo shteti ndaj një shteti tjetër;
7. Përmbajtja nga agresioni apo nga kërcënimimi për të përdorur forcë kundër integritetit territorial ose pavarësisë politike të cilitdo vendi.
8. Zgjidhje paqësore të të gjitha konflikteve ndërkombëtare në pajtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara;
9. Promovimi i interesave të përbashkëta dhe bashkëpunimi ndërkombëtar;
10. Respektimi i drejtësisë dhe i detyrimeve ndërkombëtare.

Edhe pse shumë nga vendet anëtare të Lëvizjes së Vendeve të Painkuadruara ishin shumë të afërta me ndonjërin nga superfuqitë, megjithatë lëvizja ruajti kohezionin e saj gjatë Luftës së Ftohtë, madje edhe përkundër disa konflikteve ndërmjet disa shteteve anëtare.

Me intensifikimin e Luftës së Ftohtë ndërmjet dy superfuqive, Lëvizja e Vendeve të Painkuadruara u bë një lloj forumi për koordinim, duke u dhënë vendeve në zhvillim një hapësirë përmes së cilës ato do të mund të kërkonin respektimin e të drejtave të tyre ekonomike dhe politike.

Në vitet pas Luftës së Ftohtë, Lëvizja e Vendeve të Painkuadruara është përqendruar në zhvillimin dhe thellimin e lidhjeve multilaterale si dhe unitetit ndërmjet vendeve në zhvillim, veçanërisht vendeve që ndodhen në hemisferën jugore.

Fundi i rivalitetit amerikano-sovjetik dhe fundi i antagonizmit të dy blloqeve ushtarake (NATO-s dhe Traktatit të Varshavës), që ishte përgjegjëse për vetë ekzistimin e Lëvizjes së Vendeve të Painkuadruara, për emrin dhe për rolin e saj, është parë nga shumë analistë si fillimi i fundit të saj. Madje, në pikëpyetje është vënë edhe vetë anëtarësimi i disa vendeve si: Irani, Venezuela, Afganistani, Zimbabve apo Sudani, të cilat vende, nga shumë organizata ndërkombëtare janë konsideruar si shtete që kërcënojnë paqen dhe sigurinë në botë.

Edhe sot, roli i Lëvizjes së Vendeve të Painkuadruara në promovimin e multilateralizmit është jetik sa u takon përpjekjeve koordinuese të vendeve anëtare në trajtimin e sfidave globale si p.sh. uria, varfëria, çështja e refugjatëve, dhuna e armatosur etj. Lëvizja e Vendeve të Painkuadruara simbolizon vlerën e bashkëpunimit ndërkombëtar që nxit paqen, përfshirjen dhe bashkëpunimin në vend të përjashtimit.

Kriza permanente e shteteve komuniste në Evropë

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, pjesa më e madhe e vendeve të Evropës Lindore ishte e okupuar nga Ushtria e Kuqe sovjetike. Interesi strategjik i Bashkimit Sovjetik ishte që në të gjitha këto vende, në pushtet të vijnë forcat komuniste të cilat do të ishin nën kontrollin e drejtpërdrejtë të Partisë Komuniste sovjetike.

Me ndihmën e shërbimit sekret sovjetik KGB, partitë komuniste në vendet tjera të Evropës Lindore të kontrolluara nga sovjetikët menjëherë morën kontrollin e administratës, organeve policore, organizatave sociale dhe strukturave ekonomike për të siguruar se asnjë opozitë efektive të mos paraqitej si dhe për të kontrolluar jetën socioekonomike dhe politike. Për të kontrolluar dhe monitoruar qytetarët, u krijuan organizata policore sekrete sipas modelit të shërbimit sekret të Bashkimit Sovjetik.

Në pajtim me direktivat sovjetike, “ndërtimi i komunizmit” në vendet e Evropës Lindore përfshiu likuidimin e “armiqve klasorë” dhe monitorimin konstant të “kundërrevolucionarëve”, sidomos brenda partive komuniste.

Njëjtë si në Bashkimin Sovjetike, edhe në vendet e tjera komuniste të Evropës Lindore, kultura iu nënshtrua nevojave politike dhe ideologjike. Sistemi juridik dhe arsimi u ridizejnuan sipas vijave sovjetike. Në këto vende nuk u lejua paraqitja e një shoqërie civile jashtë kontrollit të partive komuniste.

Regjimet komuniste në vendet e Evropës Lindore, jokonformizmin politik dhe disidencën apo kundërshtimin intelektual më të vogël e shikuan si kërcënim për pushtetin e tyre. Kështu, shtypja e disidencës dhe opozitës u pa si një parakusht qendror për sigurinë e regjimeve komuniste. Shkalla e shtypjes së opozitës dhe disidencës varionte nga një vend në vendin tjetër. Pas vdekjes së diktatorit sovjetike Josef Stalin, dalëngadalë u zbut edhe terrori shtetëror i një shkalle të gjerë, duke kaluar në një represion selektiv. Kjo ndikoi edhe në ndryshimin e strategjive për legjitimimin ideologjik dhe sociopolitik nga ana e partive komuniste në pushtet në vendet e Evropës Lindore.

Në vendet komuniste evropianolindore u themeluan edhe organizata policore sekrete, të cilat u bënë “shpata dhe mburoja” e partive komuniste në pushtet. Përmes policisë sekrete, e cila ishte vetë thelbi i sistemit, luftohej çdo lloj kundërshtimi ndaj direktivave partiake. Një numër i madh qytetarësh u rekrutuan, shpeshherë edhe përmes shantazheve, për t’u bërë informatorë apo spiunë të policisë sekrete. Rrjete të sofistikuara të policisë sekrete mbikëqyrnin të gjitha shtresat e shoqërisë duke i persekutuar ata që në mënyrë të hapur shfaqnin pakënaqësi ose mospajtim me regjimin.

Në vitin 1953 vdes lideri i Bashkimit Sovjetike – Josif Stalin. Pasardhësi i tij Nikita Hrushov, në kongresin e XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetike, në një fjalim sekret do ta denoncojë periudhën e kultit të personalitetit të ndërtuar rreth Stalinit gjatë qeverisjes së tij të vendit me dorë të hekurt.

Në dhjetor të vitit 1955, Hrushovi propozoi formimin e një komisioni që do të kishte për detyrë hetimin e abuzimeve dhe keqpërdorimin e pushtetit nga ana e Stalinit. Rezultatet e hetimit dëshmuan se prej 1.920.635 personave të arrestuar për “aktivitet antisovjetik” të cilët janë arrestuar mbi prova të falsifikuara dhe të detyruar ta pranojnë

fajësinë me anë të torturës të autorizuar nga vetë Stalini – 688.503 prej tyre janë ekzekutuar. Në fjalimin e tij në Kongresin e XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetike, Hrushovi i befasoi të pranishmit duke e denoncuar regjimin diktatorial të Stalinit dhe kultin e tij të personalitetit si diçka të papërputhshme me ideologjinë komuniste dhe partiake. Përveç kësaj, Hrushovi dënoi edhe mënyrën se si janë trajtuar “bolshevikët e vjetër”, shumë prej të cilëve Stalini i pat ekzekutuar si tradhtarë. Gjithashtu Hrushovi do t’i dënojë edhe krimet e kryera nga kreu i policisë sekrete – Lavrenti Beria të cilin më pas do ta ekzekutojë.

Gjatë qeverisjes së Nikita Hrushovit, shumë emra qytetesh, vendesh apo objektesh të cilët e mbanin emrin e Stalinit, do të ndryshonin. Emri i Stalinit u hoq edhe në vetë Himnin Shtetëror të Bashkimit Sovjetik. Shumë monumente kushtuar Stalinit u hoqën, jo vetëm brenda Bashkimit Sovjetike por edhe në shumë vende komuniste evropianolindore si p.sh. në Gjermaninë Lindore, në Hungari, në Çekosllovakia etj.

Mund të thuhet se procesi i “De-Stalinizimit” arriti kulmin kur trupi i pajetë i diktatorit u hoq nga Mauzoleumi i Leninit në Sheshin e Kuq për t’u zhvendosur në një vend tjetër pranë murit të Kremlinit. Më 11 nëntor 1961, emri i qytetit Stalingrad u ndryshuar në emrin e tij të mëparshëm Volgograd.

Edhe pse që nga vitet ’50, shumë shtete komuniste evropianolindore kanë tentuar të ndërmarrin reforma të kufizuara ekonomike dhe politike, ardhja në pushtet e Gorbaçovit në krye të Bashkimit Sovjetik në vitin 1985 shënoi një trend të rëndësishëm drejt liberalizimit. Në mesin e viteve ’80, qeveria e Gorbaçovit ndërmori hapa fundamentalë për të zbutur efektet negative në ekonomi, sidomos gjatë periudhës së Brezhnjevitet.

Hungaria

Revolucioni Hungarez i vitit 1956 ose siç njihet ndryshe kryengritja hungareze, ishte një revolucion kombëtar kundër regjimit komunist të Republikës Popullore të Hungarisë dhe kundër politikave të imponuara nga Bashkimi Sovjetik. Ky revolucion zgjati nga 23 tetori deri më 10 nëntor 1956. Këto protesta paraqitën kërcënimin më të

madh ndaj ndikimit dhe kontrollit sovjetik mbi Hungarinë që kur Ushtria e Kuqe sovjetike e dëboi ushtrinë naziste nga territori i saj në fund të Luftës së Dytë Botërore në Evropë.



Revolucioni Hungarez në vitin 1956

Revolta filloi si një protestë studentore, e cila tërhoqi mijëra njerëz të cilët marshuan në Budapest drejt ndërtesës së Parlamentit hungarez.

Revolta përhapet shpejt nëpër Hungari dhe qeveria u rrëzua. Këshillat e punonjësve radikalë morën kontrollin komunal nga partia komuniste hungareze dhe kërkuan ndryshime politike. Qeveri e re deklaroi synimin e saj për t'u tërhequr nga Pakti i Varshavës dhe u zotua të organizojë zgjedhje të lira. Deri në fund të tetorit, trazirat pothuajse pushuan dhe në vend u rikthye normaliteti.

Më 4 nëntor, ushtria sovjetike intervenoi ushtarakisht në kryeqytetin e vendit në Budapest por edhe në rajonet e tjera të Hungarisë për ta shuar kryengritjen. Rezistenca hungareze vazhdoi deri në 10 nëntor. Mbi 2,500 hungarez dhe 700 trupa sovjetike u vranë në këtë konflikt dhe 200,000 hungarezë e lëshuan vendin si refugjatë. Pas kësaj, arrestimet masive dhe denoncimet vazhduan për muaj të tërë. Deri në janar të vitit 1957 qeveria e re sovjetike arriti të shuajë çfarëdolloj kundërshtimi apo rezistence. Kjo politikë e Moskës, bëri që kontrolli sovjetik mbi Hungarinë të forcohej akoma më shumë, por kjo

gjë, njëherazi kontribuoi në dëmtimin dhe rënien e prestigjit të Bashkimit Sovjetik, duke bërë që mijëra anëtarë të partive komuniste në vendet kapitaliste, të distancohen nga ideologjia marksiste.⁵

Në Hungari, për më shumë se 30 vjet, u ndalua të flitej publikisht për këtë ngjarje.

Çekosllovakia

Pranvera e Pragës paraqet periudhën e një liberalizimi politik si dhe të protestave masive në Çekosllovakia. Kjo periudhë liberalizmi dhe reformimi filloi më 5 janar 1968, kur reformatori Alexander Dubček u zgjodh Sekretar i Parë i Partisë Komuniste të Çekosllovakisë dhe vazhdoi deri më 21 gusht 1968, kur Bashkimi Sovjetik dhe anëtarët e tjerë të Paktit të Varshavës pushtuan vendin për të shtypur reformat.⁶

Reformat e ndërmarra nga Dubček parashikonin më shumë të drejta për qytetarët e Çekosllovakisë, decentralizim të pjesshëm të ekonomisë dhe demokratizimim e vendit. Reformat parashikon zbutjen e kufizimeve në media, fjalës së lirë dhe udhëtimit. Pas një diskutimit kombëtar për ndarjen e vendit në tri njësi federale, në Bohemi, Moravi-Silesi dhe Sllovakia, Dubček mbikëqyri vendimin vendi të ndahet në dy njësi federale: në Republikën Socialiste Çeke dhe në Republikën Socialiste Sllovake. Ky ndryshim ishte i vetmi ndryshim juridiko-politik që i mbijetoi invazionit sovjetik.

Reformat nuk u pritën mirë nga sovjetikët, të cilët pas një sërë negociatash të dështuara, dërguan rreth gjysmë milioni trupa ushtarake të Paktit të Varshavës për të pushtuar vendin. Një valë e madhe e emigrimit përfshiu vendin. Ndërsa ushtria sovjetike kishte parashikuar se do të duhej katër ditë për të nënshtruar vendin, rezistenca vazhdoi për tetë muaj. Çekosllovakia mbeti e kontrolluar nga Bashkimi Sovjetik deri në vitin 1989, kur Revolucioni Velvet përfundoi në mënyrë paqësore regjimin komunist; trupat e fundit sovjetike u larguan nga vendi në vitin 1991.

⁵ Györkei, J.; Kirov, A.; Horvath, M. (1999). *Soviet Military Intervention in Hungary, 1956*. New York: Central European University Press. p. 370

⁶ Rootes, Christopher. "1968 and the Environmental Movement in Europe."

Nga vendet anëtare të Paktit të Varshavës, vetëm Shqipëria dhe Rumania e dënuan invazionin e Çekosllovakisë. Shqipëria e quajti pushtimin e vendit si një akt “social-imperialist” dhe pas kësaj ngjarjeje, ajo do të del nga Pakti i Varshavës.

Sovjetikët e justifikuan invazionin përmes “Doktrinës Brezhnjev” që mbronte idenë se Bashkimi Sovjetik ia rezervonte vetes të drejtën për të intervenuar në çdo shtet të Blloku Lindor që dukej se rrëshqiste drejt kapitalizmit.

Polonia

Në gusht të vitit 1980, punëtorët në “Kantierin Lenin” të qytetit Gdansk filluan një greve të padëgjuar dhe të pashembullt deri atëherë, për botën komuniste. Greva që zgjati dy javë, çoi në nënshkrimin e një marrëveshjeje me qeverinë komuniste polake, e cila më në fund i pranoi kërkesat e punëtorëve. Në fillim, kërkesat e punëtorëve të kantierit në Gdansk ishin të karakterit lokal, por ndërkah, grevat u përhapën edhe nëpër fabrika anë e mbanë Polonisë duke e ngritur numrin e kërkesave në atë që u njoh si lista me “21 pikë”, e cila përfshinte të drejtat e punëtorëve në përgjithësi, çështje shoqërore, siç ishin lehtësimi i censurës, të drejta të reja për Kishën Katolike, lirimin e të burgosurve politikë, përmirësimin e shërbimit shëndetësor dhe legalizimin e sindikatave të punëtorëve. Si rrjedhim, pranimi i këtyre kërkesave nga regjimi polak, përfundoi në krijimin e sindikatës së parë të lirë, jo komuniste polake-Solidarnoshq, e cila nëntë vite më vonë solli në pushtet Leh Valesën, kryetarin e Solidarnoshqit, duke rrëzuar kështu regjimin komunist të Varshavës, vendi i parë nga satelitët sovjetik, në Evropën Lindore, që bëri një gjë të tillë.⁷

Suksesi i lëvizjes *Solidarnoshq* në Poloni, sipas shumë ekspertëve, përgatiti rrugën për politikën e ashpër anti-komuniste që ndoqi presidenti amerikan, Ronald Regan gjatë viteve ‘80. Sipas tyre, afërsia e pikëpamjeve të Presidentit Regan dhe Papës Gjon Palit të Dytë në lidhje me politikën çnjerëzore të komunizmit, përshpejtoi procesin e çmontimit të komunizmit në Evropë.

⁷ Györkei, J.; Kirov, A.; Horvath, M. (1999). *Soviet Military Intervention in Hungary, 1956*. New York: Central European University Press. p. 370

Solidariteti u themelua më 17 shtator 1980 në kantierin e Leninit në Gdańsk nën udhëheqjen e Lech Wałęsa. Ishte sindikata e parë në një vend të Paktit të Varshavës që nuk kontrollohej nga një parti komuniste. Anëtarësia e tij arriti kulmin në 10 milionë anëtarë në Kongresin e saj të Shtatorit 1981, i cili përbënte një të tretën e popullsisë së përgjithshme në moshë pune të Polonisë.

Në vitet 1980, Solidariteti ishte një lëvizje e gjerë anti-burokratike shoqërore, duke përdorur metodat e rezistencës civile për të avancuar shkaqet e të drejtave të punëtorëve dhe ndryshimeve shoqërore. Qeveria u përpoq ta shkatërronte bashkimin duke imponuar ligjin ushtarak në Poloni, i cili zgjaste nga dhjetori 1981 deri në korrik 1983 dhe u pasua nga disa vjet represioni politik që nga 8 tetori 1982, por në fund u detyrua të negociojë me Solidaritetin. Në vitet klandestine të bashkimit, Papa Gjon Pali II dhe Shtetet e Bashkuara ofruan një mbështetje të konsiderueshme financiare, që llogaritet të jetë rreth 50 milionë dollarë amerikanë.

Bisedimet e tryezës në mes të qeverisë dhe opozitës së udhëhequr nga Solidariteti çuan në zgjedhje gjysmë të lira më 1989. Deri në fund të gushtit u formua një qeveri koalicioni e udhëhequr nga Solidarnazia. Në dhjetor të vitit 1990 Valesa u zgjodh president i Polonisë. Që atëherë, Solidariteti është bërë një sindikatë më tradicionale liberale.

Jugosllavia

Pas demonstratave të vitit 1968 dhe pas miratimit të kushtetutës federative të vitit 1974, shqiptarët e Kosovës u orientuan të ngrinin e të konsolidonin institucionet autonome politike, ekonomike e kulturore të Kosovës. Në rrafshin politik, duke shfrytëzuar legjislacionin e ri, shqiptarët synonin të arrinin një përfaqësim proporcional ose të barabartë në organet politike dhe administrative të Kosovës. Në Prishtinë u hap universiteti tashmë i pavarur nga Universiteti i Beogradit e ku mesmi zhvillohej në të dyja gjuhët, në shqip dhe në serbo-kroatisht. Në pak vite, u hapën shumë shkolla të reja dhe u rrit numri i nxënësve, i studentëve e për rrjedhojë i mësuesve shqiptarë. U zhvillua një

valë veprimtarish shkencore dhe u forcuan lidhjet me institucionet analoge arsimore, kulturore, shkencore të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.⁸

Të gjithë këta hapa ndikuan në rigjallërimin e në forcimin ndaj ndjenjës kombëtare të shqiptarëve të Kosovës. Por, me gjithë këto zhvillime, statusi politik, shoqëror, ekonomik i shqiptarëve në Kosovë, krahasuar me republikat tjera të Jugosllavisë ishte përsëri i ulët. Kjo linte të pambyllur hendekun midis Kosovës dhe njërive të tjera federative. Shqetësimi dhe përpjekjet e shqiptarëve të Kosovës për prosperitet, dora dorës po fokusoheshin në një pikë. Si të pavarësoheshin nga Serbia e të arrinin statusin e Republikës. Pavarësisht nga propaganda se Kushtetuta federative e vitit 1974, nëpërmjet disa neneve të saj, i siguronte Kosovës statusin e republikës. E vërteta ishte ndryshe. Kosova nuk ishte republikë. Me këtë të vërtetë shqiptarët përballeshin çdo ditë, për më tepër ata shqiptarë që kërkonin statusin e Republikës së Kosovës e punonin për realizimin e këtij synimi, arrestoheshin e burgoseshin.

Për rrjedhojë, aspirata e shqiptarëve të Kosovës për jetë të pavarur bëhej gjithnjë e më imponuese. Pakënaqësia ndaj pushtetit nacionalist serb përfshiu të gjithë shtresat e popullsisë së Kosovës që nga punëtorët e fshatarët e deri te studentët e intelektualët. Kjo pakënaqësi u shpreh me kërkesa dhe me kritika të hapura ndaj pushtetit si dhe me organizime ilegale. Kosova kishte numrin më të madh të të burgosurve politikë të Jugosllavisë.

Në mars të vitit 1981, studentët shqiptarë të Universitetit të Prishtinës, të cilëve iu bashkua edhe popullata shqiptare, të pakënaqur nga padrejtësitë historike dhe kushtet jetësore, vërshuan rrugën e Prishtinës dhe të qyteteve tjera të Kosovës duke kërkuar realizimin e të drejtave të tyre sociale dhe kombëtare. Kërkesat e studentëve vunë në spikamë mungesën e zhvillimit ekonomik, papunësinë e madhe, duke i gërshetuar edhe me mungesën e lirive kombëtare. Me ta u bashkuan nxënësit e shkollave të mesme, punëtorë e madje edhe fshatarë, që krahas parullave ekonomike, hodhën edhe parulla politike si p.sh. “Jemi shqiptarë e jo jugosllav”, “Mjaft më me shfrytëzimin e Trepçës e të Obiliqit”, “Trepça punon, Beogradi ndërton”, si dhe parulla më kryesore “Kosova Republikë”.

⁸ Fatmir Toçi, *Historia e popullit shqiptar IV gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj 1939-1990*, Botimet Toena, Tiranë, f. 365



Demonstratat e vitit 1981 në Prishtinë

Gjendja në Kosovë u bë përherë e më e rëndë. Rrethanat politike u keqësuan deri në atë shkallë sa disa herë u shpall gjendje e jashtëzakonshme.⁹

Trazirat u shtypën nga ushtria dhe policia. Mirëpo ky qe një problem që nuk mund të fshihej nën qilim e të mbulohej vetëm duke përdorur dhunë.

Pas përkrahjes publike që udhëheqja politike e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë u dha demonstratave të Kosovës, Jugosllavia fajësoi Enver Hoxhën se kishte nxitur demonstratat irredentiste kundër Jugosllavisë.

Problemi politik i Kosovës përkoi me thellimin e problemeve ekonomike të vendit në tërësi. Sllovenia dhe Kroacia i rifilluan kritikën ndaj sistemit në një kohë kur një pjesë mjaft e madhe e fitimeve të tyre në valutë shkonte në Beograd.

Menjëherë pas vdekjes së Titos, shovinizmi dhe hegjemonizmi serb u shfaq në mënyrë shumë agresive dhe në mënyrë të planifikuar. Serbët synonin ngushtimin e autonomisë së Kosovës si dhe për të krijuar kushte institucionale dhe ligjore për kontrollimin e Kosovës. Serbia nuk ndalej vetëm me kaq. Kërkesat e saj u shkallëzuan

⁹ Lory, Bernard. *Evropa ballkanike nga viti 1945 deri në ditët tona*. Tiranë, 200, fq. 150-151

sidomos pas demonstratave të studentëve të Universitetit të Prishtinës në vitin 1981. Me këmbënguljen e Serbisë, organet partiake shtetërore të federatës, demonstratat i karakterizuan si kundër-revolucionare. Ky përkufizim i miratuar edhe në organet më të larta shtetërore dhe partiake të Jugosllavisë kishte hapur rrugën për veprime represive duke përdorur të gjitha mjetet që kishte shteti jugosllav i asaj kohe.

Më 24 shtator 1986, një gazetë e Beogradit botoi një dokument të hartuar nga një ekip anonim i Akademisë Serbe së Shkencave dhe Arteve (SANU). Memorandumi sikundër u quajt ishte një manifest i flaktë i nacionalizmit serb. Në pikën kryesore të tij thuhej se serbët e Kosovës ndodheshin para shfarosjes nga ana e shqiptarëve agresivë. Aty gjithashtu theksohej se “me përjashtim të periudhës së Shtetit të Pavarur të Kroacisë, serbët në Kroaci kurrë nuk kishin qenë më të rrezikuar sesa sot”. Zgjidhja e statusit të tyre kombëtar duhet të jetë prioriteti më madhor¹⁰.

Autoritetet komuniste e dënuan këtë memorandum me ashpërsi.

Slobodan Millosheviq në maj të vitit 1986 ishte zgjedhur kryetar i Lidhjes së Komunistëve të Serbisë. Në të vërtetë Lidhja Komuniste e Serbisë për të ishte vetëm një urë kaluese për t’i marrë më lehtë mekanizmat e pushtetit dhe të shtetit. Millosheviqi kishte fituar popullaritet të madh në sytë e serbëve me çështjen e Kosovës. Prandaj ai dhe ndjekësit e kësaj ideologjie nacionaliste, në shumicën e qyteteve në Kosovë ku kishte edhe popullatë serbe organizuan një numër mitingjesh në të cilat përveç të tjerash kërkohej edhe shfarosja e shqiptarëve.

Më 28 qershor 1989, në 600 vjetorin e betejës së Kosovës arrihet kulmi i kësaj ideologjie urrejtëse. Millosheviqi duke e hetuar këtë mbështetje të fuqishme të masave popullore kishte krijuar sigurinë dhe bindjen se kishte ardhur koha të përballej me kundërshtarët e tij në federatën jugosllave.

Çdo përpjekje për ta ndryshuar pozitën e pabarabartë të Kosovës nëpërmjet statusit të republikës, përcillej me arrestime dhe burgosje të shumë shqiptarëve.

Demonstratat e studentëve dhe të popullatës shqiptare në muajt mars – prill, pra në pranverën shqiptare të vitit 1981 kishin vënë në sprovë edhe Evropën veçmas lidhur me

¹⁰ Histori e Ballkanit 1804-1999, Misha Glenny, Botimet Toena, Tiranë, f. 626

respektimin e parimeve të së drejtës për vetëvendosje të barazisë ndërmjet popujve si dhe respektimin e parimeve të drejtësisë. Në pranverë të vitit 1981, dihet mirëfilli se mjetet e informimit ndërkombëtar u angazhuan shumë për ngjarjet në Kosovë. Një pjesë e madhe i trajtuan me objektivitet ngjarjet. Duke e konsideruar Serbinë si faktor stabiliteti e si partner kryesor, Perëndimi bëri të mundur që agresiviteti i nacionalizmit serb në Kosovë të merrte përmasa të skajshme gjer në gjenocid. Pas ngjarjeve të vitit '81, dhuna që ushtrohej ndaj popullatës shqiptare të Kosovës nuk mund të zgjidhej duke mbyllur sytë siç bënte politika edhe në nivel të Kosovës, edhe në nivel të Jugosllavisë, por as duke mbajtur qëndrim të heshtur siç vepronte Evropa.¹¹

Gjatë viteve '90, në zgjedhjet e para pluraliste, socialistët (ish komunistët) e humbën pushtetin në të gjitha republikat federative përveç në Serbi dhe Mal të Zi, ku në zgjedhje fitoi Millosheviqi dhe aleatët e tij. Ndërmjet periudhës qershor 1991 dhe prill 1992, katër republika shpallën pavarësinë. Pas një sërë incidentesh ndëretnike, filluan luftimet, fillimisht në Kroaci dhe më pas edhe në Bosnjë dhe Hercegovinë. Ngjarjet që pasuan, shkaktuan shpërbërjen definitive të Jugosllavisë.

Shqipëria

Shqipëria deri në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, kishte qenë në periferi të politikës së Bashkimit Sovjetikë në Ballkan. Rezultatet e lutës, sollën një rritje të ndjeshme të ndikimit sovjetik në rajon, veçanërisht në ato vende që u çliruan nga ushtria sovjetike si Rumania, Bullgaria, Jugosllavia.

Pas ardhjes në pushtet të forcave komuniste në Shqipëri dhe pas konsolidimit të pushtetit, Enver Hoxha, në korrik të vitit 1947 arriti të realizojë vizitën e parë në Moskë ku u takua me Stalinin dhe me udhëheqësit e tjerë të Bashkimit Sovjetik. Pas kësaj vizite, marrëdhëniet ndërmjet të dyja vendeve njohën zhvillim të ri në të gjitha fushat ekonomike e ushtarake. Në këtë kuadër, ushtria shqiptare filloi të pajiset falas me armatim sovjetik.

Marrëdhëniet ndërmjet Tiranës dhe Moskës, veçanërisht pas gjysmës së dytë të viteve '50, ishin të diktuara plotësisht nga sovjetikët. Varësia nga Bashkimi Sovjetik kushtëzohej dhe nga gjendja e rëndë ekonomike dhe nga nevojat e mëdha që kishte vendi për ndihma e mbështetje ekonomike. Stalini u kujdes që vendeve socialiste, përfshi edhe

¹¹ Nusret Pllana, *Intervenimi i NATO-s në Kosovë*, Radio Kosova e Lirë, 2010, f. 70

Shqipërinë, t'u impononte modelin sovjetik të zhvillimit të ekonomisë dhe mbi to të vendosëj kontrolli i Moskës.

Stalini dhe Enver Hoxha

Ndihma sovjetike për Shqipërinë nuk ishte pa interes. Shqipëria përbënte një pikë mbështetje strategjike për synimet sovjetike në Ballkan e në rajonin e Mesdheut. Për këtë qëllim, Moska i kushtoi një vëmendje të veçantë forcimit të aftësisë mbrojtëse të Shqipërisë, përgatitjes dhe pajisjes së ushtrisë shqiptare në bazë të standardeve sovjetike, krijimit të bazave ushtarake sovjetike në vend etj. Në ushtrinë shqiptare shërbenin një numër ushtarakësh dhe ekspertësh sovjetikë kurse shumë kuadro shqiptare ishin shkolluar në shkollat ushtarako-sovjetike. Sipas burimeve sovjetike, shuma e përdorur për pajisjen e ushtrisë shqiptare me armatime tekniko-luftarake, gjatë viteve 1947-1960, arritën në mbi 1 miliard rubla.

Në vitin 1955, me iniciativën e udhëheqjes sovjetike u krijua Traktati i Varshavës si një organizatë mbrojtëse e vendeve të bllokut komunist në Evropë në të cilin hyri edhe Shqipëria. Pavarësisht nga synimet e shpallura, ky traktat u kthye në të vërtetë në një



instrument kontrolli dhe shantazhi ushtarak sovjetik ndaj vendeve të tjera anëtare.¹²

Pas pushtimit të Çekosllovakisë më 1968 nga ushtria sovjetike dhe forcat e vendeve tjera të Traktatit të Varshavës, Kuvendi Popullor i Shqipërisë, më 13 shtator 1968 mori vendimin për të dalë zyrtarisht nga kjo organizatë politiko-ushtarake, e cila ishte nën kontrollin e plotë të sovjetikëve. Ky qëndrim i Shqipërisë gjeti jehonë të gjerë në arenën ndërkombëtare. Pushtimi i Çekosllovakisë u shoqërua me kërcënime dhe në adresë të Jugosllavisë, të Rumanisë e të Shqipërisë. Kërcënimet sovjetike ishin më tepër një taktikë për të ulur tonet e politikës dhe të qëndrimeve antisovjetike që mbanin në këtë kohë Shqipëria, Jugosllavia e Rumania.

Më 12 dhjetor 1990, një komision nismëtar i përbërë nga studentë e pedagogë të shkollave të larta, shpallën krijimin e Partisë Demokratike Shqiptare, partisë së parë opozitare në vend. Në programin e kësaj partie të miratuar në mbledhjen themeluese, parashikohej pluralizmi politik, thellimi i reformave drejt ekonomisë së tregut të lirë, pavarësia e pushteteve dhe garantimi i lirive dhe i të drejtave themelore të qytetarëve sipas standardeve ndërkombëtare. Në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, programi parashikonte vendosjen e bashkëpunimit të ngushtë me vendet e Evropës Perëndimore dhe me ShBA-në si dhe aderimin e vendit në organizatat ndërkombëtare si në BE, në Këshillin e Evropës dhe në NATO.

Më pas u krijuan edhe partitë tjera politike, si Partia Republikane, Partia Ekologjike, Partia Socialdemokrate etj. Në qershor të vitit 1991, PPSH zhvilloi kongresin e saj të dhjetë dhe të fundit. Kongresi vendosi t'i japë fund veprimtarisë së PPSH dhe të themelojë Partinë Socialiste të Shqipërisë, një parti e re me program dhe me status të ri, që u përshtateshin ndryshimeve të bëra në vend me kalimin nga diktatura në demokraci. Në këtë mënyrë, pas 45 vjet qeverisje të vendit, sistemi njëpartiak komunist u përmbys për t'i lënë vendin, rendit pluralist demokratik.

SHPËRBËRJA E PAKTIT TË VARSHAVËS

¹² Fatmir Toçi, *Historia e popullit shqiptar IV gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj 1939-1990*, Botimet Toena, Tiranë, f. 247

Themeluar në maj 1955, si kundërpërgjigje e NATO-s, nënshkruesit origjinalë të Paktit ishin BRSS, Republika Demokratike Gjermane, Polonia, Hungaria, Çekosllovakia, Rumania, Bullgaria dhe Shqipëria (Shqipëria u tërhoq në 1968). Forcat e Paktit të Varshavës përfundimisht do të kombinojnë aftësi të jashtëzakonshme ofensive dhe mbrojtëse të mishëruara më fuqishëm nga formacionet masive të tankeve dhe artilerisë. Megjithatë, me ironi, pushtimet e vetme të nisura ndonjëherë nga Pakti i Varshavës ishin drejtuar kundër anëtarëve të vet, Hungarisë në vitin 1956 dhe Çekosllovakisë në vitin 1968.

Për shtatëdhjetë vjet, shteti sovjetik kishte ndërtuar një rrjet të ndërlikuar të aleancave dhe marrëdhënieve që e mbronin atë nga fqinjët armiqësorë dhe nga fuqitë e huaja. I shkatërruar nga pushtimi gjerman i vitit 1941, rrjeti i mbrojtjes u konsolidua me nënshkrimin e Paktit të Varshavës, duke i dhënë shtetit sovjetik tridhjetë e pesë vjet të siguri së tensionuar. Dobësuar së pari nga Lëvizja e Solidaritetit dhe zgjedhjet e lira të mundshme në Poloni; rënia e Murit të Berlinit në vitin 1989; depozitimi i Partisë Komuniste Çekoslloake dhe i udhëheqësit komunist bullgar Todor Zhivkov; dhe rënien e përgjakshme të Nicolae Ceaucescu në Rumani; rrjeti i marrëdhënieve ndërkombëtare thjesht nuk ekzistonte më.

Në vitin 1989, si rezultat i pakënaqësive të thella popullore civile dhe politike u përmbysën pjesa më e madhe e qeverive komuniste të vendeve të Traktatit të Varshavës. Lëvizjet antisovjetike dhe antikomuniste në Evropën Lindore kishin filluar ta gërryenin Traktatin e Varshavës. Në vitin 1990, Gjermania Lindore e braktisi paktin për t'u përgatitur për bashkim me Gjermaninë Perëndimore. Udhëheqësit politikë polakë dhe Çekosllovakë, gjithashtu e shprehën dëshirën e tyre për t'u tërhequr. Shpërbërja e Traktatit të Varshavës ishte e pashmangshme.

I bllokuar nga aq shumë republika sovjetike që kërkonin të drejtën për t'u ndarë dhe duke u shfaqur gjithnjë e më armiqësore, Rusia qëndronte e vetme. Përballë këtij realiteti të ri dhe si pasojë e gjendjes së pafavorshme ekonomike, situatës së

paqëndrueshme politike në vend si dhe barra e rëndë e shpenzimeve të tepërta ushtarake, Kremlin u detyrua të dorëzohet.

Nga viti 1989 deri në 1991, qeveritë komuniste u përmbysën në Shqipëri, Poloni, Hungari, Çekosllovakia, Gjermani Lindore, Rumani, Bullgari dhe Bashkimin Sovjetik.

Më 25 shkurt 1991, Pakti i Varshavës u shpërbë në një takim të ministrave të mbrojtjes dhe të ministrave të jashtëm nga vendet e mbetura të Paktit që u mbajt në Hungari. Më 1 korrik 1991, në Pragë, Presidenti i Çekosllovakit Václav Havel formalisht i dha fund Organizatës së Traktatit të Miqësisë, Bashkëpunimit dhe Ndihmës së Ndërsjellë. BRSS u shpërbë në dhjetor të vitit 1991.

ROLI I NATO-s PAS NDRYSHIMEVE NË EVROPËN QENDRORE DHE JUGLINDORE

NATO si fuqi e vetme dhe determinuese pas shkatërrimit të Paktit të Varshavës

Me përfundimin e Luftës së Ftohtë, me shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik dhe të Paktit të Varshavës, dhe me përfundimin e antagonizmave të blloqeve Perëndimore e Lindore, arsyet për të cilat NATO ishte krijuar u duk se nuk ekzistonin më. Natyra e sfidave bashkëkohore të sigurisë ndryshoi, gjithashtu, në mënyrë rrënjësore. Pavarësisht prej skepticizmit në lidhje me të ardhmen e NATO-s, megjithatë, NATO si aleancë ushtarake jo vetëm vazhdoi të qëndrojë edhe pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, por ajo dëshmoi se ishte njëra prej organizatave ndërkombëtare moderne më të frytshme në fushën e sigurisë, anëtarët e partnerët e së cilës vazhdimisht shtoheshin në numër.

Vitet 1990 u shënuan nga një varg ngjarjesh të rëndësishme. Në vitin 1990, për herë të parë, NATO-ja i ofroi bashkëpunim Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të tjera europiane që nuk ishin anëtarë. Kjo ndodhi gjatë sesionit të Këshillit të Atlantikut Verior, në qershor, në Turnburry të Skocisë, në kohën kur Ministrat e Punëve të Jashtme të shteteve anëtare shpallën të ashtuquajturin Mesazh prej Turnburry-it. Në këtë takim, mes tjerash u tha:

“Ne, ministrat e jashtëm të Aleancës, shprehim vendosmërinë tonë për të shfrytëzuar mundësitë historike që rezultojnë nga ndryshimet rrënjësore në Evropë për të ndihmuar në ndërtimin e një rendi paqësor të ri në Europë, të bazuar në vlerat e lirisë, drejtësisë dhe të demokracisë. Në këtë kontekst, ne shtrijmë dorën e miqësisë dhe të bashkëpunimit ndaj Bashkimit Sovjetik si dhe ndaj të gjitha vendeve të tjera të Evropës.

Siguria e vërtetë në Evropë më së miri do të garantohet përmes njohjes reciproke të interesave legjitime të sigurisë së të gjitha vendeve. Ne jemi të gatshëm për të kontribuar në mënyrë aktive në ndërtimin e mirëbesimit dhe lidhjeve më të afërta ndërmjet të gjitha vendeve evropiane, përfshi këtu edhe anëtarët e dy aleancave”.

Një muaj më vonë, në Londër, Kryetarët e Shteteve dhe udhëheqja e NATO-s nënshkruan Deklaratën e Londrës, në të cilën aleatët shfaqën vullnet e vendosmëri për shndërrimin e Aleancës. Kjo deklaratë përbëhej nga propozime të ndryshëm për krijimin e një bashkëpunimi të gjerë me vendet e Evropës Qendrore e lindore në fushat politike e ushtarake, si dhe për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike zyrtare.

Në një pjesë të kësaj deklarate thuhet:

“Evropa sapo ka hyrë në një epokë të premtuese. Evropa Qendrore dhe Lindore është duke u çliruar. Bashkimi Sovjetik është duke ecur në një udhëtim të gjatë drejt një shoqërie të lirë. Muret që dikur i kanë mbyllur njerëzit dhe idetë, tani janë duke rënë. Vendet e Evropës po vendosin vetë për fatin e tyre. Ata po e zgjedhin lirinë, lirinë ekonomike dhe paqen. Ata po zgjedhin një Evropë të lirë. Për shkak të kësaj, kjo Aleancë duhet dhe do të adaptohet.”

Një vit më pas, në fillim të nëntorit, Kryetarët e Shteteve dhe udhëheqja e NATO-s shpallën Deklaratën e Romës për Paqe e Bashkëpunim, e cila propozonte

institucionalizimin e marrëdhënieve e të bashkëpunimit me ish Bashkimin Sovjetik dhe vendet e Evropës Qendrore e Lindore në lidhje me çështjet politike e të sigurisë. Kjo Deklaratë hidhte edhe themelet e krijimit të Këshillit të Bashkëpunimit të Atlantikut Verior (NACC).

Mbledhja e parë e Këshillit të Bashkëpunimit të Atlantikut Verior u zhvillua në dhjetor 1991. Arritje e rëndësishme e këtij sesiioni ishte miratimi i Deklaratës për Dialogun, Partneritetin dhe Bashkëpunimin. Mbledhja e Nivelit të lartë e Brukselit, në fillim të vitit 1994, shënoi marrjen e nismës për rritjen e sigurisë e të qëndrueshmërisë në të gjithë Evropën, të njohur si 12 Partneriteti për Paqe (PfP). Vendet partnerë të Këshillit të Bashkëpunimit të Atlantikut Verior dhe shtetet e Konferencës për Siguri e Bashkëpunim në Evropë, të organizatës që në të ardhmen do të bëhej OSBE, u ftuan që të bëheshin pjesëtarë të PfP-së.

Në vitin 1997, në Sintra të Portugalisë, NACC-i u zëvendësua nga Këshilli i Partneritetit Euroatlantik, qëllimi kryesor i të cilit ishte që të hapte një faze të re për bashkëpunimin transatlantik. Në Mbledhjen e Nivelit të lartë të Madridit, të mbajtur në të njëjtin vit, udhëheqësit njoftuan kalimin në një periudhë të re të zhvillimit të NATO-s. Republika Çeke, Hungaria e Polonia u ftuan për të filluar bisedimet zyrtare për anëtarësim në NATO. U ripërcaktuan marrëdhëniet me Rusinë dhe u krijuan zyrtarisht themelet për partneritetin me Ukrainën.

Në prill të vitit 1999, Uashingtoni u bë vendi pritës i Mbledhjes së Nivelit të lartë të 15 të NATO-s, e cila shënonte edhe përvjetorin e 50 të Aleancës. Në këtë sesion, Republika Çeke, Hungaria e Polonia u mirëpritën si anëtare të NATO-s. Kjo mbledhje mori nisma të reja me rëndësi strategjike të tilla si, Plani i Veprimit për Anëtarësim, që synonte të ndihmonte vendet që dëshironin të bëheshin anëtare. Kjo Mbledhje ka qenë e shquar edhe për përcaktimin e Konceptit të Ri Strategjik të NATO-s, i cili përshkruante mjedisin e sigurisë që po ndryshonte dhe ideonte rolin e ri të NATO-s në sigurinë botërore të shekullit XXI.

Mbledhja tjetër e Nivelit të Lartë të NATO-s u zhvillua në Pragë, në nëntor të vitit 2002. Në këtë Mbledhje, Bullgaria, Estonia, Letonia, Lituania, Rumania, Sllovakia e Sllovenia u ftuan zyrtarisht që të fillojnë bisedimet për anëtarësimin e tyre në NATO.

Mbledhja më e fundit e Nivelit të Lartë të NATO-s e cila kishte rëndësi strategjike u zhvillua në Stamboll, në qershor të vitit 2004. Në këtë sesion Aleanca mirëpriti si anëtare të reja shtatë vende: Bullgaria, Estonia, Letonia, Lituania, Rumania, Sllovakia dhe Sllovenia. Kështu, numri i përgjithshëm i shteteve anëtarë të NATO-s arriti në 26.

Përveç procesit të zgjerimit, Aleanca u përqendrua edhe në përparimin me partneritete në rajone parësore si Kaukazi i Jugut dhe Azia Qendrore. Njëkohësisht, kjo Mbledhje mori vendime në lidhje me rritjen e Dialogut me 7 vendet partnere mesdhetare si dhe mori një nismën të re me shtete prej të ashtuquajturës Lindje e Mesme e zgjeruar.

Sot, NATO është një organizatë që ndryshon shumë prej asaj që u krijua në vitin 1949. Aleanca tani nuk është as ajo që garanto mbrojtjen e Evropës Perëndimore për më shumë se katër dekada gjatë Luftës së Ftohtë, as ajo që vëzhgonte proceset e tranzicionit në Evropë në fillim të viteve 1990.

NATO nuk është vetëm një aleancë për mbrojtje të përbashkët, por edhe një tërësi vlerash të përbashkëta. Duke mbajtur parasysh natyrën e ndryshueshme të kërcënimeve botërore të sigurisë, për të gjithë shtetet anëtare, vlerat e demokracisë, respektimit të të drejtave të njeriut dhe sundimi i ligjit janë provuar si të besueshme. Gjithashtu, NATO është garantues i realizueshmërisë së përmasës transatlantike të përpjekjeve për t'u përballur me sfidat botërore të sigurisë. Aleanca lidh Evropën me Amerikën e Veriut dhe shërben si themel për baraspeshën ndërmjet interesave të ndryshme kombëtare në emër të paqes e qëndrueshmërisë së përbashkët.¹³

Struktura organizative e NATO-s

Selia e Shtabit Kryesor të Aleancës së Atlantikut të Veriut është në Bruksel të Belgjikës, andaj aty është edhe qendra kryesore politike e Aleancës. Po ashtu, aty është edhe rezidenca e delegacioneve kombëtare të vendeve anëtare dhe zyra ndërlidhëse ose e misioneve diplomatike të vendeve anëtare.

¹³ Euro Atlantic Education Initiative, *NATO in Brief*, Sofia, f. 11

Brenda shtabit kryesor të NATO-s kryejnë punët e tyre delegacionet e misioneve të cilat mbështeten nga Shtabi ndërkombëtar dhe nga Shtabi ushtarak ndërkombëtar që po ashtu janë të vendosur në shtabin e Aleancës.

Në rastet kur vendimet që merren nga vendet anëtare mund të kenë konsekuenca ushtarake, NATO-ja e ka të gatshme infrastrukturën ushtarake si dhe aftësitë teknike për t'iu përgjigjur sfidave që dalin.¹⁴

Institucionet kryesore drejtuese të NATO-s, të cilat formësojnë politikën e strategjinë e Aleancës në të gjitha veprimtaritë e saj, janë:

- Këshilli i Atlantikut Verior (NAC),
- Komiteti i Planifikimit të Mbrojtjes (DPC) dhe
- Grupi i Planifikimit Bërthamor (NPG).

Këshilli i Atlantikut Verior është një prej organeve që ka autoritet të lartë dhe fuqi vendimmarrëse. Strukturën e tij udhëheqëse e përbëjnë përfaqësuesit e përhershëm nga të gjitha vendet anëtare. Këshilli mbledhet të paktën një herë në javë. Gjithashtu Këshilli mbledhet edhe në nivele më të larta me pjesëmarrjen e ministrave të jashtëm, të ministrave të mbrojtjes ose të kryetarëve të shteteve apo qeverive.

Komiteti i Planifikimit të Mbrojtjes (DPC) – përbëhet nga përfaqësues të përhershëm kurse mbledhjet në nivel të ministrave të mbrojtjes i mbajnë të paktën dy herë në vit. Detyrë e këtij komiteti është trajtimi i pjesës më të madhe të çështjeve që kanë të bëjnë me sigurinë dhe mbrojtjen si dhe të çështjeve që kanë të bëjnë me planifikimin e mbrojtjes së përbashkët.

Grupi i Planifikimit Bërthamor – ministrat e mbrojtjes të vendeve anëtare që marrin pjesë në këtë organ, mbajnë takime të rregullta në Grupin e Planifikimit Bërthamor (NPG). Në këto takime shqyrtohen çështje të veçanta politike lidhur me forcat bërthamore. Shqyrtimet mbulojnë një fushë të gjerë të çështjeve të politikës bërthamore siç janë ruajtja, siguria, sistemet e informacionit e të ndërlidhjes, çështjet e grupimit të forcave si dhe çështja e kontrollit dhe e përhapjes së armëve bërthamore.

¹⁴ Nusret Pllana, *Intervenimi i NATO-s në Kosovë*, Radio Kosova e Lirë, Prishtinë, f. 107

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s është një zyrtar ndërkombëtar i nivelit të lartë, që emërohet nga vendet anëtare. Ai ka tri funksione kryesore. Së pari është Kryetar i Këshillit të Atlantikut të Veriut nën urdhrat e të cilit janë:

- Komiteti i Planifikimit të Mbrojtjes dhe
- Grupit të Planifikimit Bërthamor.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s është gjithashtu edhe kryetar i Këshillit të Partneritetit të Aleancës Veri-Atlantike, i Këshillit NATO-Rusi, i Komisionit NATO-Ukrainë dhe i Grupit të Bashkëpunimit Mesdhetar.

Së dyti, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s është zëdhënës kryesor i Aleancës dhe përfaqëson Aleancën në marrëdhëniet e saj me publikun në emër të vendeve anëtare duke pasqyruar qëndrimin e tyre të përbashkët për çështjet politike.

Së treti, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s është zyrtari më i lartë ekzekutiv për Shtabin Ndërkombëtar të NATO-s, përgjegjës për realizimin e takimeve në Shtab dhe për mbikëqyrjen e punës së Shtabit.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s emërohet nga qeveritë e vendeve anëtare me një mandate katërvjeçar. Atë e ndihmon në kryerjen e funksioneve të tij si dhe e zëvendëson zëvendës-sekretari i përgjithshëm, i cili është edhe kryetar i një numri komitetesh të larta.

Shtabi Ndërkombëtar

Shtabi Ndërkombëtar është krijuar në vitin 1951. Ky organ ofron mbështetje dhe asistencë Këshillit të Atlantikut Verior dhe gjatë ushtrimit të detyrave të tij, i nënshtrohet komiteteve. Anëtarët e tij janë përfaqësues të shteteve anëtare, të punësuar nga NATO ose të emëruar nga autoriteti kombëtar përgjegjës për një periudhë 3-4 vjet.

Anëtarët e Shtabit Ndërkombëtar i nënshtrohen drejtpërsëdrejti Sekretarit të Përgjithshëm. Qysh prej krijimit në vitin 1951, struktura e Shtabit ndërkombëtar ka ndryshuar shumë here dhe si rrjedhojë ky institucion tani përfshin Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm, Zyrën e NATO-s për Sigurinë dhe gjashtë drejtori, secila e kryesuar nga një Ndihmës Sekretar i Përgjithshëm.

Komiteti Ushtarak

Komiteti Ushtarak është organ më i lartë ushtarak në NATO dhe vepron nën autoritetin e përgjithshëm politik të Këshillit të Atlantikut të Veriut, Komitetit të Planifikimit të Mbrojtjes ose të Grupit të Planifikimit Bërthamor. Prandaj, për të mund të thuhet se është pjesë përbërëse e aparatit politik dhe vendimmarrës i Aleancës.

Në mbledhjet e nivelit të lartë, në këtë organ marrin pjesë Shefat e Shtabeve të Përgjithshëm, kurse në mbledhjet e përditshme marrin pjesë përfaqësuesit ushtarakë të vendeve anëtare. Detyra e këtij organi është që, strukturave politike të NATO-s t'u japë udhëzime në lidhje me strategjinë ushtarake si dhe të kryejë zbatimin e përgjithshëm të veprimtarive ushtarake të Aleancës.

Kryetari i Komitetit Ushtarak (CMC) zgjidhet nga Shefat e Shtabeve dhe caktohet për një periudhë trevjeçare. Ai vepron vetëm në cilësinë e tij si përfaqësues ndërkombëtar dhe autoriteti i tij buron nga Komiteti ushtarak, ndaj të cilit ai është përgjegjës për kryerjen e detyrave të veta.

Komandat Ushtarake të NATO-s

Operacionet ushtarake të NATO-s drejtohen nga Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s dhe janë të ndara në dy Komanda Strategjike. Komandantët Strategjikë i përgjigjen Komitetit Ushtarak të NATO-s për drejtimin e përgjithshëm dhe shqyrtimin e çështjeve ushtarake të Aleancës brenda rrethit të tyre komandues.

Janë dy komanda ushtarake të NATO-s të cilat kanë rëndësi strategjike. Njëra është Komanda Supreme e Aleatëve për Evropën (SACEUR), me seli në Mons të Belgjikës. Tjetra është Komanda Supreme e Aleatëve për Transformim (SACT) me seli në Norfolk, të Virginia të Sh.B.A.-së.

SACEUR është kreu i Komandës së Aleatëve për Operacionet (ACO) e cila mbikëqyr zhvendosjen e forcave nga aleatët. SACEUR ka për detyrë të kujdeset për të gjithë operacionet tokësore të NATO-s, pavarësisht prej vendit se ku vendosen ato dhe ajo është edhe Kryesuese e Komandës Evropiane të Sh.B.A.-së.

Roli i SACT-it është kryesisht veprues. Si kryesues i Komandës së Aleatëve për Shndërrimin (ACT), ai ka për detyrë të kujdeset për forcimin e kontrollin e procesit të vazhdueshëm të shndërrimit të aftësive ushtarake të Aleancës. Ai ka një përgjegjësi të dyfishtë, meqenëse është edhe Komandë e forcave të bashkuara të Sh.B.A.-së.

Forcat e Armatosura

Forcat ushtarake të NATO-s nuk janë të pavarura. Forcën e saj e përbëjnë trupat që i vihen në dispozicion nga vendet anëtare për operacione ushtarake.

Si rregull, pjesa më madhe e forcave të NATO-s qëndrojnë nën komandën e tyre kombëtare gjatë gjithë kohës që kryejnë detyrat e caktuara nga NATO në përputhje me kërkesat e një operacioni të caktuar. Përjashtime të vetme nga ky parim janë Shefat e Shtabit të Integruar dhe forcat operacionale të tilla si Forcat e Paralajmërimit të Hershëm, Kontrolli Ajror dhe Forcat Detare të Përherhme.



Baza e NATO-s në Inçirlik

Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, numri i përgjithshëm i forcave të armatosura u pakësua shumë. Në mënyrë më të veçantë, qysh prej fillimit të viteve 1990, personeli i forcave tokësore të shteteve anëtare që ndodhet në zotërim të NATO-s u shkurtua me 35%; numri i anijeve të forcës detare me 30% kurse skuadrat e luftimit të forcave ajrore me rreth 4%. Pjesa më e madhe e forcave nuk janë më në gjendje gatishmërie të lartë dhe janë ristrukturuar me synim që të rritet aftësia, zhërvjellësia, lëvizshmëria e ndërveprueshmëria e tyre.

Asambleja Parlamentare

E themeluar në vitin 1955, Asambleja Parlamentare e NATO-s (para vitit 1999, është quajtur Asambleja e Atlantikut Verior), shërben si një organizatë këshilluese ndërparlamentare e NATO-s dhe si lidhëse ndërmjet NATO-s dhe parlamenteve të vendeve anëtare të saj. Në të njëjtën kohë, kjo organizatë kontribuon në njohjen e çështjeve kryesore të sigurisë dhe në rritjen e transparencës për politikat e NATO-s.

Që nga përfundimi i Luftës së Ftohtë, Asambleja Parlamentare ka marrë rol të ri duke integruar në punën e saj deputetët e vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore dhe përtej, të cilat dëshirojnë të kenë më shumë afërsi me NATO-n. Ky integrim ka siguruar asistencë politike dhe praktike dhe ka kontribuar në forcimin e demokracisë parlamentare në rajonin Euro-Atlantik.

Misionet paqeruajtëse të NATO-s

Gjatë Luftës së Ftohtë, NATO nuk pati rastin të ndërmarrë asnjë operacion ushtarak. Të gjitha operacionet ushtarake të NATO-s u zhvilluan pas përfundimit të Luftës së Ftohtë kur ndikimi i NATO-s u rrit ndjeshëm, veçanërisht në përpjekjet e Aleancës për dhënien fund trazirave në Bosnjë. Kjo kulminoi me fushatën e parë ajrore të NATO-s në vitin 1995 kundër Ushtrisë së Republikës Serbe, pas së cilës erdhi deri te nënshkrimi i Marrëveshjes së Dejtonit.

NATO tani luan rol themelor në Afganistan pas sulmeve të 11 Shtatorit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ky sulm terrorist aktivizoi nenin 5 të Traktatit të Atlantikut të Veriut që parasheh idenë e mbrojtjes kolektive të anëtarëve të Aleancës në rast të ndonjë sulmi të jashtëm.¹⁵

Përveç rolit në Afganistan, NATO është përfshirë edhe në ofrimin e ndihmave humanitare, luftimin e piraterisë, në zbatimin e bllokadave detare etj.

Që nga operacioni i saj i parë i madh në Ballkan, në vitet e hershme të 90-ta, ritmi dhe shumëllojshmëria e operacioneve të NATO-s u zmadhuan. NATO është e angazhuar në misionet të cilat mbulojnë të gjithë spektrin e menaxhimit të krizave – nga misionet paqësore e luftarake, trajnimet dhe përkrahja logjistike, deri tek mbikëqyrja dhe ndihmat humanitare.¹⁶

¹⁵ www.nato.int/docu/pub-form.htm

¹⁶ <http://morm.gov.mk>

Sot në misionet e NATO-s në botë janë të angazhuar rreth 110.000 personel ushtarak, ku me sukses menaxhojnë operacione komplekse tokësore, ajrore, ujore dhe të gjitha llojet e operacioneve në ambientin jetësor.

Këto forca momentalisht janë duke punuar në Afganistan, në Kosovë, në Afrikë (Afrikën veri-lindore, ndonjëherë edhe në gadishullin somalez) dhe në Somali. Për shembull, në dhjetor të vitit 1992 ministrat e jashtëm të vendeve anëtare të NATO-s theksuan se janë të gatshëm të mbështesin misionet paqësore të kryesuara nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, i cili mban përgjegjësinë primare për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.

Ministrat rishikuan masat e ndërmarra nga ana e vendeve anëtare të NATO-s në raport me misionet paqësore, sanksionet dhe embargon, qofshin ato masa individuale të vendeve apo bashkësi të Aleancës, me çka mbështetën rezolutën e Kombeve të Bashkuara që i referohej konflikteve në ish Jugosllavi.

Misioni i NATO-s në Afganistan

Prania e forcave ushtarake të NATO-s në Afganistan paraqet përkushtimin dhe kontributin më të rëndësishëm të Aleancës deri më ditën e sotme. Të lidhura me mandatin e OKB-së në vitin 2001, Forcat ndërkombëtare të sigurisë për ndihmë – ISAF (International Security Assistance Force – ISAF) janë nën kryesimin e NATO-s nga gushti i vitit 2003.

Ky mision i NATO-s për momentin përbëhet nga rreth 102.000 ushtarë, pjesëtarë të 50 vendeve të ndryshme të vendosura në Afganistan. Misioni ISAF paraqet zgjerimin e rolit qeveritar qendror në Afganistan me qëllim që të krijohet një ambient normal për funksionimin e institucioneve demokratike si dhe për sundimin e ligjit.

Gjithashtu, misioni ka për qëllim të parandalojë që Afganistani përsëri të jetë fole e terrorizmit. Krahës kësaj, ISAF ka për qëllim vënien e Forcave profesionale të sigurisë-Afghan National Security Forces (ANSF), ku afganëve do të ju mundësohet që ta marrin përgjegjësinë mbi sigurinë në vendin e tyre.

Aktualisht, përkrahja e NATO-s në Afganistan fokusohet në dhënien e trajnimit, këshilla, ndihmë dhe kontribut për të mbajtur në nivel Forcat e Sigurisë Kombëtare afgane.

Deti Mesdhe

Operacionet e NATO-s nuk janë të kufizuara vetëm në zonat e konfliktit. Pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit të vitit 2001, NATO filloi të ndërmarrë masa për t'iu përgjigjur kërcënimeve nga terrorizmi ndërkombëtar. Me vënien e operacionit detar për mbikëqyrje të ashtuquajtur Përpjekje Aktive (Active Endeavour) në tetor të vitit 2001, NATO vuri edhe një dimension në luftën globale kundër terrorizmit. Ky operacion është operacion detar i Aleancës, që operoi në Detin Mesdhe për të parandaluar lëvizjet e terroristëve dhe të armëve të shkatërrimit në masë.

Operacioni “Mburoja e Oqeanit” (Ocean Shield)

Operacioni Mburoja e Oqeanit ishte kontributi i NATO-s në operacionin Enduring Freedom, një iniciativë kundër piraterisë në Oqeanin Indian, Gjirin e Adenit dhe në Detin Arabik. Ky operacion u përqendrua në mbrojtjen e anijeve të cilat transportonin furnizime ndihmëse si pjesë e misionit të Programit Botëror të Ushqimit në rajon.

Kontribuuesi më i madh i anijeve në këtë operacion ishte marina amerikane, e pasuar nga marina e Indisë.

Operacioni “Maritime Guard”

Operacioni “Maritime Guard” përfaqësonte bllokadën detare të NATO-s në ujërat ndërkombëtare të Adriatikut kundër ish Jugosllavisë. Ky operacion filloi më datë 22 nëntor 1992. Aleanca vepronte në mbështetje të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Në këtë operacion, NATO ishte e autorizuar për të përdorur forcë, përfshi këtu edhe ndalimin, inspektimin dhe kthimin prapa të anijeve që drejtoheshin drejt brigjeve të shtetit jugosllav.

Me mbështetjen e Turqisë, Holandës dhe të Gjermanisë, operacioni u përforcua akoma më shumë për t'iu mundësuar avionëve të NATO-s për të rrëzuar avionët e tjerë që e cenonin bllokadën.

Misioni paqeruajtës i NATO-s në Bosnjë dhe Hercegovinë

Me shpërbërjen e Jugosllavisë në prill të vitit 1992, filloj konflikti i përgjakshëm. Aleanca u përgjigj me vënien e embargos për armë nga ana e OKB-së dhe me vënien e ndalesës për fluturime ajrore, gjithashtu e vënë nga Këshilli i Sigurimit. NATO angazhoi forcat e veta ajrore në operacione luftarake për herë të parë në historinë e vet.

Qenë kryer dy operacione: operacioni “Deadeye” i cili filloi më 30 gusht dhe ishte i orientuar kundër forcave ajrore të serbëve të Bosnjës. Ky operacion nuk rezultoi me largimin e forcave serbe ndaj dhe pasoi edhe operacioni i dytë “Deliberate Force” i cili qe orientuar ndaj komandës dhe kontrollit të instalimit të armëve.

Kjo kampanjë ajrore ishte faktor kyç për të ulur palët në tavolinën e bisedimeve dhe shpiu në nënshkrimin e Marrëveshjes së Dejtonit që u nënshkrua në dhjetor të vitit 1995. NATO menjëherë vendosi 60.000 ushtarë në të ashtuquajturën Implementation Force (IFOR).

Në dhjetor të vitit 1996 erdhi deri te vendosja e 32.000 pjesëtarë të forcave për stabilizim SFOR- Stabilization Force (SFOR). Edhe pse misioni drejtohej nga NATO, shumë vende që nuk ishin vende anëtare të Aleancës, dërguan trupat e vetë për të stabilizuar dhe qetësuar situatën si p.sh. Argjentina, Australia, Austria, Egjipti, Finlanda, Rusia, Suedia, Ukraina, Malajzia, Zelanda e Re, Marokja.

Roli i NATO-s në mbrojtjen e stabilitetit dhe të paqes në Ballkan

Bosnja dhe Hercegovina

Lufta në Bosnjë ishte një konflikt i armatosur që u zhvillua në Bosnjë dhe Hercegovinë në periudhën ndërmjet viteve 1992 dhe 1995. Palët ndërluftuese ishin forcat

e Republikës së Bosnjës dhe Hercegovinës, Republika Serbe (entiteti serb) dhe Herceg-Bosnja (entiteti kroat). Lufta ishte pasojë e shthurjes së Jugosllavisë. Pas shkëputjes së Sllovenisë dhe të Kroacisë nga Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë në vitin 1991, Republika Socialiste e Bosnjës dhe Hercegovinës që ishte vend multietnik i banuar kryesisht nga boshnjakë myslimanë (44%), serbë ortodoksë (33%) dhe kroatë katolikë (17%) votuan në referendum për pavarësi më 29 shkurt 1992. Referendumi u hodh poshtë nga përfaqësuesit e serbëve të Bosnjës të cilët e bojkotuan atë.

Nga ky moment, tensionet në Bosnjë dita-ditës rriteshin. Konflikti shpërtheu më 1 mars 1992, në një lagje me shumicë myslimane. Kjo ishte shkëndija që i vuri zjarrin Bosnjë-Hercegovinës.

Komuniteti Evropian e njohu pavarësinë e Bosnjë e Hercegovinës më 6 prill 1992. Njohja e pavarësisë së Bosnjë-Hercegovinës, e vuri Armatën jugosllave para faktit të kryer, si një forcë e huaj brenda territorit të saj.

Mirëpo, në Bosnjë-Hercegovinë, serbët e kishin formuar parlamentin e tyre dhe Republikën Serbe, në krye me Radovan Karaxhiqin dhe Banja Luka u shpall kryeqendra e Republikës Serbe në Bosnjë-Hercegovinë. Ndërsa, Armata jugosllave e stacionuar në Bosnjë-Hercegovinë u vu nën komandën e gjeneralit Ratko Mlladiq¹⁷. Ushtria e tij gjatë vitit 1992/93 arriti që të zotërojë rreth 70 % të territorit të Bosnjë-Hercegovinës.

Mirëpo përveç forcave të Republikës Serbe të Bosnjës, aty luftonte edhe Këshilli Kroat i Mbrojtjes (HVO), si krah i Franjo Tuxhmanit dhe që mbante nën kontroll shumë territore.

Më 5 qershor 1992, kroatët e Bosnjë-Hercegovinës, ngjashëm sikurse serbët e shpallën Republikën e Pavarur të Herceg-Bosnjës. Ushtria e Bosnjë-Hercegovinës që luftonte për një shtet të bashkuar, ishte nën komandën e presidentit të Bosnjë-Hercegovinës, Alia Izetbegoviqit. Përpjekja për ta armatosur këtë forcë ushtarake, në vitet 1992/93, minohej nga embargoja e armëve, sidomos nga fakti se të gjitha rrugët, prej nga mund të kalonin armatimet e rënda, duhej të kalonin përmes Kroacisë.

¹⁷ Jasmina Udovički dhe James Ridgeway, Makthi etnik i Jugosllavisë, New York, 1998, 149.

Involvimi i Uashingtonit për të zgjidhur çështjen e Bosnjë-Hercegovinës nëpërmjet ndihmëssekretarit amerikan Richard C. Holbrooke në fillim rezultoi i pasuksesshëm.

Lufta në Bosnjë e Hercegovinë filloi të merrte përmasa të gjera. Trupat serbe filluan të depërtonin në enklavën e sigurt myslimane të Srebrenicës.



Lufta në Bosnjë

Ata hynë në qytet në mbrëmjen e së martës, më 11 korrik 1995, dhe kryen krimin më të madh të luftës së Bosnjës, masakrimin e rreth 8.000 myslimanëve të paarmatosur. Disa ditë më pas Mlladiqi i ktheu tytat e armëve kundër zonës tjetër të sigurt, Zhepës. Edhe ky qytet ra. Mirëpo, në objektivin e tretë në Gorazhde, Mlladiqi u ndal për shkak të rrezikut të goditjeve nga ajri prej forcave të NATO-s.

Më 30 gusht të vitit 1995, NATO-ja filloi të kryente një seri bombardimesh kundër pozicioneve të serbëve të Bosnjës, të cilat arritën kulmin me lëshimin e 13 raketave “Tomahawk” mbi selinë e komandës dhe qendrës së kontrollit të ushtrisë të serbëve të Bosnjës pranë Banja Lukës.

Për pasojë, mbrojta e serbëve në Bosnjën perëndimore u shpartallua dhe ushtria myslimane e kroate mbushën zbrazëtinë e krijuar.¹⁸ Kjo luftë përfundoi me ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare me Marrëveshjen e Dejtonit.

Marrëveshja e Dejtonit

Marrëveshja e Paqes së Dejtonit (MD), e nisur në Dejton, Ohajo të SHBA-ve, më 21 nëntor 1995 dhe e nënshkruar në Paris, më 1 dhjetor të po atij viti, midis udhëheqësve të grupeve etnike Myslimane, Serbe dhe Kroate, i dha fund zyrtarisht luftës tre vjeçare në Bosnjë- Hercegovinë (BH).

Marrëveshja u hartua me qëllim garantimin e një paqeje afatgjate dhe hedhjen e bazave për riintegrimin e komuniteteve të përçara etnike në vend. Marrëveshja e Dejtonit përbehet nga dispozita ushtarake, politike dhe civile.

Në aspektin e saj ushtarak, marrëveshja detyroi armëpushimin mes palëve ndërluftuese në Bosnjë- Hercegovinë dhe mundësoi angazhimin e forcave të NATO-s nën një mandat të papërcaktuar, në zbatimin e marrëveshjes (forca IFOR) dhe më pas stabilizimin e situatës në vend (forca SFOR).

Nga pikëpamja politike, marrëveshja siguroi unitetin shtetëror të BH-së (Bosnjë- Hercegovinë), të përbërë prej dy etniteteve – Federata Myslimano-Kroate (zyr. Federata e BH-së), e cila do të administronte 51% të territorit të BH-së dhe Republika Serbe (Republika Sërpska), e krijuar nga serbët e Bosnjës, e cila do të kontrollonte pjesën tjetër prej 49%.

Në aspektin civil, marrëveshja përmbante dispozita në lidhje me ndihmën humanitare, rindërtimin ekonomik dhe nxitjen e të drejtave të njeriut. Si pjesë e këtyre dispozitave, të gjithë qytetarët, parashikohet të kenë të drejtën e lëvizjes së lirë në të gjithë vendin, refugjatët të drejtën për t'u kthyer në shtëpitë e tyre dhe subjektet politike të angazhoheshin të bashkëpunonin me Gjykatën Kriminale për ish-Jugosllavinë, për vënien para drejtësisë të të akuzuarve për krime lufte. OKB-ja caktoi një përfaqësues të posaçëm për të lehtësuar zbatimin e aspektit civil të kësaj marrëveshjeje.

¹⁸ Misha Glenny, Histori e Ballkanit 1804-1999 Botimet Toena f.651

Në aspektin politik zbatimi i marrëveshjes lë shumë për të dëshiruar.

Me gjithë presionin ndërkombëtar për ndërprerje të ndihmave ekonomike dhe mosmbështetje të mëtejshme të vendit në përmbushjen e prioritetëve në politikën ndërkombëtare, partitë ultra nacionaliste kanë ruajtur pozitat e tyre në pushtet, duke arritur në përgjithësi rezultate të mira në zgjedhje në krahasim me partitë e tjera të përfaqësimit liberal, multietnik, apo demokratik.

Dominimi i faktorit politik nacionalist në vend konsiderohet gjithashtu si një potencial i rrezikshëm pasojash për stabilitetin e vetë rajonit.

Mënyra si janë përvijuar hartat, që përcaktojnë territoret në dorë të serbëve, kroatëve e myslimanëve, nuk i jep dorë zhvillimit ekonomik të tri bashkësive, kurse rregullimi politik nuk nxit bashkëpunimin ndërmjet tyre. Çështja boshnjake mbetet në shkallë të madhe e pazgjidhur.

Maqedonia

Maqedonia ishte më i brishti nga shtetet e rinj, që dolën prej ish Jugosllavisë, madje më pak i sigurt edhe se Bosnja e Hercegovina.

Kjo për arsye se 65 përqind e 2 milion banorëve të saj janë sllavë, të cilët njihen nga të gjithë, përveç bullgarëve e grekëve, si maqedonas. Qeveria bullgare nuk pranonte të njoh identitetin e sotëm të maqedonasve, duke qëndruar te pikëpamja se ata janë bullgarë perëndimorë.

Me kushtetutën e vitit 1991, Republika e Maqedonisë definohej si shtet me sistem parlamentar të qeverisjes të bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve. Sipas kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, vendi nuk ka pretendime territoriale ndaj asnjë vendi fqinj dhe sa i takon kësaj çështjeje, ajo nuk pati asnjë konflikt me shtetet fqinje rreth kufijve.

Megjithatë fqinji i saj jugor - Greqia do të bëhet një pengesë e vazhdueshme rreth pranimet të saj në OKB, edhe pse Komisioni i Badenterit të BE-së bënte thirrje për njohjen e shtetit ndërkombëtarisht¹⁹

¹⁹ Shkariq S. "Parliamentarian elections in the Republic of Macedonia in 1990 and 1994, 1

Kur Maqedonia u bë shtet i pavarur më 1992, qeveria greke mëtoi se vet emri Maqedoni kishte prejardhje helene, që datonte nga koha e Aleksandrit të Madh.

Grekët paralajmëruan se maqedonasit ushqenin aspirata territoriale ndaj Maqedonisë së Egjeut dhe Selanikut .

Problem më i madh se ermi i shtetit të Maqedonisë ishte çështja shqiptare. Shqiptarët llogariteshin të ishin mbi 25 përqind e popullsisë së përgjithshme të Maqedonisë. Duke jetuar në një territor kompakt në pjesën perëndimore të Maqedonisë dhe në Shkup, shqiptarët e Maqedonisë kishin vuajtur nga trajtimi prej autoriteteve komuniste të Maqedonisë në vitet '70 e '80 më shumë se shqiptarët e Kosovës e cila në atë kohë kishte status autonom, por si pjesë përbërëse e Serbisë në kuadër të federatës.

Edhe pse në rrethana shumë të rënda politike, shqiptarët do të përqafojnë pluralizmin politik, që në thelb nënkupton lirinë e plotë politike dhe pavarësinë për të krijuar e anëtarësuar në parti të ndryshme politike.

Shteti maqedonas në ato vite nuk ishte aspak i disponuar që shqiptarëve t'u jep hapësirë për të formuar parti politike. Ai në fillim do të mundohet t'i bind shqiptarët që ata të inkorporohen në partitë maqedonase. Krahas kësaj kërkesë të pushtetarëve maqedonas nuk do të ndalet edhe dhuna që ushtrohej me vite dhe që do të vazhdojë me të njëjtin intensitet edhe në të ardhmen.

Mjafton të përmendet vetëm moslejimi i themelimit të partive shqiptare, ndonëse në Maqedoni ishte miratuar ligji për partitë politike. Pushteti maqedonas nuk do të lejojë formimin e tyre, rast ky që nuk ndodhte as në Kosovë e cila ndodhej nën një pushtim klasik. E ndeshur përballë shovinizmit sllavo-maqedonas, partia e parë shqiptare Partia për Prosperitet Demokratik (PPD) do të jetë e detyruar që ta mbajë Kuvendin themelues të partisë në fshatin Poroj e rrethuar nga të gjitha anët me polici maqedonase. Kjo pra ishte “demokracia” e proklamuar për shqiptarët nga pala sllavo-maqedonase.

Për fat të keq të popullit shqiptar, partitë politike duke u mbështetur gjithmonë në faktorin e jashtëm të cilët dëshironin të ruanin status-quon në Ballkan, do të zgjedhin opsionin e parë që mendonin se do të jetë opsioni më i lehtë për ta bërë.

Liderët shqiptarë nuk kthyen kokën pas t'i shohin sukseset e udhëheqësve të popujve tjerë sllav të Jugosllavisë. Përderisa ata e bashkuan popullin për të arritur aktin final si Tugjmani te kroatët, Gligorovi te maqedonasit, Izetbegoviqi te boshnjakët, këtë bashkim nuk e bëri pala shqiptare. Udhëheqësit shqiptarë kishin iluzione se çështja jonë kombëtare do të zgjidhet pa kurrfarë sakrificash, duke e lënë punën që ta zgjedh bashkësia ndërkombëtare.

Por, edhe pse u zgjodh opsioni më i lehtë ai i zgjedhjes së problemit veç e veç, përsëri rruga deri në ato zgjedhje gjysmake do të jetë tepër e vështirë. Kosovës tani do t'i lihet vetë të sendërtojë ardhmërinë e vet, si republikë në vete, kurse shqiptarët e tjerë jashtë Kosovës do të duhet ta ndihmojnë e të mos e pengojnë.

Kësisoj shqiptarët në Maqedoni duhet të punojnë për arritjen e statusit për barazi të plotë me maqedonasit dhe njëkohësisht duhet me sa munden ta ndihmojnë Kosovën.

Vullneti politik i shqiptarëve, që të jenë qytetarë të barabartë në Maqedoni, u keqpërdor nga faktori politik maqedonas dhe ai shqiptar. Politikanët maqedonas, çdo kërkesë të shqiptarëve për të drejta politike, ekonomike, sociale i vishej atributi se këto kërkesa janë “radikale”, “maksimaliste” etj.

Në fillim të vitit 2001, si pasojë e pakënaqësisë së shqiptarëve që buronte nga statusi i tyre politiko-juridik i pabarabartë me palën sllavo-maqedonase, në Maqedoni do të shpërthejë konflikti i armatosur ndërmjet Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare dhe forcave të armatosura të Republikës së Maqedonisë.

Jehona e UÇK-së u përhap shpejt dhe u shndërrua në kryengritje e cila u shtri nga Tanusha, e deri në fshatrat e malësisë së Shkupit, të Likovës, të Kumanovës e të Tetovës.

Komuniteti ndërkombëtar në fillim të luftës do të jetë shumë i papërgatitur për të menaxhuar këtë krizë të re që i paraqitej.

Si në çdo luftë edhe në këtë, ndërkombëtarët synojnë që palët në konflikt t'i sjellin në tryezën e bisedimeve. Edhe pse me të madhe trumbetohej nga ana e tyre se nuk do të ketë bisedime me “terroristët”, ata që në fillim do të vrapojnë pas tyre që të mësojnë më tepër se çka duan ata. Pavarësisht nga rrethanat e disfavorshme në arenën ndërkombëtare, UÇK falë mençurisë së udhëheqësve të saj, dhe strukturave ushtarake të organizuara dhe

të disiplinuar mirë, më shpejtë u bë forcë dinamike dhe përshpejtuese e proceseve dhe ndryshimeve strukturale. Ajo mundësoi që çështja shqiptare në Maqedoni të del në rend të ditës për t'u diskutuar. Kësaj çështje i kontribuoi para së gjithash fitorja e UÇK-së në të gjitha fushëbetejat me forcat policore, ushtarake e paramilitare maqedonase.

Rrethanat që u krijuan në Maqedoni, paraqesin momentin e konfrontimit mes dy koncepteve, atij lindor, anti-Nato, anti-evropian që përfaqësohet nga elita maqedonase dhe mbarë shtypi maqedonas dhe koncepti perëndimor që përfaqësohet nga ajo shqiptare, që e sheh NATO-n si faktor stabiliteti që pretendon kultivimin e vlerave evropiane, respektimin e dallimeve politike, kulturore, racore, gjinore etj.

Partitë politike shqiptare në Maqedoni u gjetën të befasuara nga paraqitja e UÇK-së dhe sukseset e saj. Nga ana tjetër, ata ishin të shtrënguar nga faktori ndërkombëtar që të bëjnë çmos të ndalojnë përhapjen e luftës. Si rast vendimtar do të jetë Marrëveshja e Prizrenit mes dy liderëve politikë dhe atij ushtarak të shqiptarëve në Maqedoni. Në këtë takim, mes liderëve politikë shqiptarë dhe komandës së lartë të UÇK-së, ndihmesë më të madhe do të jap i dërguari i posaçëm i Organizatës për Sigurim dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE) në Maqedoni, Robert Frovik. Aktiviteti i tij rezultoi me nënshkrimin e Marrëveshjes së Prizrenit mes tre liderëve politikë dhe ushtarakë të shqiptarëve (liderin e PPD-së – z. Ymeri, liderin e PDSH-së – z. Xhaferi dhe përfaqësuesin politik të UÇK-së Ali Ahmeti).

Këtu u mbyllën të gjitha kalkulimet e palës maqedonase, sepse shkaqet e konfliktit tanimë marrin adresën e saktë e ato janë raporte ndëretnike të pazgjidhura me dekada në Maqedoni.

Pas Marrëveshjes së Prizrenit 22 maj 2001, në mes Xhaferit, Ymerit dhe Ahmetit, UÇK më 14 qershor 2001, paraqiti edhe projektin për dhënien fund të luftës në Maqedoni. Në fillim të këtij projekti thuhet se UÇK është për ndërprerjen e luftës dhe sigurimin e paqes, për krijimin e një shteti multietnik si dhe për plotësimin e kërkesave të saj. UÇK thekson se për të realizuar këtë, nevojitet një zgjidhje diplomatike dhe një gatishmëri për t'u dhënë fund aksioneve ushtarake ndaj forcave militare maqedonase. Ky projekt shpjegon fushat, se ku duhet të konsistojë marrëveshja, e ato janë tri: rrafshi ushtarak, diplomatik dhe ai politik.

Këto veprime Ushtria Çlirimtare Kombëtare do t'i propozojë duke u përcaktuar për paqe dhe me qëllim të ndërprerjes së luftës në Maqedoni, duke dashur të kontribuojë në stabilitetin dhe sigurinë e përgjithshme rajonale, t'i hap rrugë zgjidhjes diplomatike dhe duke dashur që të promovojë një model të shtetit multi-etnik të Maqedonisë në kufijtë e saj ekzistues. Bashkësia ndërkombëtare përmes përfaqësuesit të Unionit Evropian Fransua Leotar dhe atij amerikan Xhejms Perdju, do të del më 17 korrik 2001, me versionin e vet për zgjidhjen e krizës në Maqedoni, i cili dokument do të jetë i bazuar nga prezantimi i dokumentit të Robert Badinterit më 28 qershor 2001.

Dokumenti i quajtur “Versioni i Draft Dokumentit Kornizë” do t'u dorëzohet liderëve të katër partive kryesore politike, si dhe vet kryetarit Trajkovski.

Këtë marrëveshje partitë politike shqiptare si dhe UÇK, nuk e përkrahën ngase aty nuk u përfshinë dy kërkesat jetike të palës shqiptare: njohjen e popullit shqiptar si popull shtetformues, si dhe gjuha shqipe të jetë gjuhë zyrtare në të gjitha nivelet shtetërore, dhe jo vetëm në ato lokale.

Pas intervenimit të përfaqësuesve ndërkombëtarë dhe të faktorit të brendshëm politik, do të arrihet një Marrëveshje Kornizë e cila do të nënshkruhet më 13 gusht 2001 në Ohër. Kjo marrëveshje u nënshkrua nga kryetari i Republikës së Maqedonisë, Boris Trajkovski, lideri i VMRO-DPMNE dhe kryeministër Lupço Georgievski, lideri LSDM-së Branko Crvenkovski, ai i PPD-së Ymer Ymeri dhe lideri i PDSH-së Arben Xhaferi. Gjithashtu, nënshkrime në dokument si dëshmitarë zyrtarë do të vënë edhe lehtësuesit ndërkombëtarë në dialog Fransua Leotar dhe Xhejms Perdju.

Kjo marrëveshje i dha fund konfliktit të armatosur në Maqedoni. Më pas do të pasojë demobilizimi dhe dorëzimi i armëve nga ana e luftëtarëve të UÇK-së, e cila filloi më 27 gusht 2001. Edhe pse ky konflikt i armatosur mori fund, megjithatë, pozita politike, ekonomike, sociale e shqiptarëve të Maqedonisë mbetet në shkallë të madhe e pazgjidhur.

Kosova dhe intervenimi i NATOS-s

Marrëveshja e Dejtonit e cila u mbajt në fund të vitit 1995 erdhi si rezultat i veprimit të SHBA-së dhe NATO-s, për ta ndaluar agresionin serb në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Por situata në Kosovë nuk ishte në favor të shqiptarëve. Kjo për arsye se Millosheviçi kishte përkrahje nga faktori ndërkombëtar për mbajtjen e paqes në Bosnjë e Hercegovinë.

Në Kosovë, pakënaqësia e shqiptarëve vinte duke u rritur. Shqiptarët po bënin veprime që tregonin se nuk ishin të gatshëm t'u nënshtroheshin politikave të këtilla të bashkësisë ndërkombëtare, e cila nuk i kishte fare në konsideratë.

Organizimet e para të rezistencës së armatosur ndaj forcave shoviniste Serbo-Jugosllave fillojë në Drenicë në vitin 1991, ku për ta përballuar sulmin në kullën e familjes Jashari, ishte angazhuar edhe formacioni ushtarak i Adem Jasharit.²⁰

Në rezistencën ndaj shovinizmit Serbo-Jugosllav, po dilte një forcë e re ushtarake që do ta mbronte jetën e shqiptarëve. Kjo forcë ishte Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK-ja) e cila e bëri edhe sulmin e parë mbi policinë jugosllave në vitin 1996.

Mjetet e informimit dhe propaganda e Beogradit në skenën ndërkombëtare e etiketuan Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës si një grupacion terrorist, fundamentalist islamik (edhe pse dihej se në Kosovë kurrë nuk ka pasur fundamentalistë islamikë) madje duke shkuar deri në atë masë sa e quajnë edhe bandë e trafikantëve të drogës.

²⁰ Kراسиќи, Јакуп. Ктһеса е маdһе (Ushtria Çlirimtare e Kosovës). Prishtinë, 2006 fq. 20

Marrëzja e Beogradit sigurisht nuk kishte fund. Propaganda shfrenuese ndaj UÇK-së shkonte deri atje sa u alarmoheshin në media të caktuara të vendeve të ndryshme evropiane dhe botërore se gjoja në Kosovë po bëhej gjenocid ndaj serbëve.

Kjo fushatë propaganduese mund të hetohet nga të gjithë ata që ndiqnin, qoftë edhe pjesërisht, televizionet e Beogradit, ku fare lehtë mund të vërtetoheshin gënjeshttrat tipike Serbo-Jugosllave²¹

Konferenca e Dejtonit, përveç këtyre çështjeve që dolën në sipërfaqe nxori edhe një problem të madh, me pasoja të rënda për të ardhmen jo vetëm të Bosnjës e Hercegovinës, por edhe të mbarë rajonit. Konferenca kishte njohur kufijtë e rinj të asaj që quhet Republika Srpska, dhe kjo për shqiptarët ishte moment i fundit për ta kuptuar, se komuniteti ndërkombëtar udhëhiqej dhe zgjidhte problemet nga gjendja e ngjarjeve faktike në terren, dhe jo nga parimet humanitare. Pra vepronte argumenti i forcës dhe jo e kundërta, forca e argumentit.

Në prill të vitit 1996 në Kosovë ishte shtuar dhuna. Slobodan Millosheviç nuk mund të duronte që brenda Kosovës të vegjetonte një pushtet tjetër. Ai shfrytëzoi veprimet e UÇK-së si alibi për të bërë represion ndaj shqiptarëve të Kosovës, vrasje, tortura, rrahje nëpër rrugë e nëpër vende publike, sulme të organizuara kundër veprimtarëve politikë shqiptarë dhe hakmarrje arbitrare ndaj sulmeve të UÇK-së.

Më vonë, nën pretekstin se po luftonte terroristët, filloi bombardimet e fshatrave, djegiet, vrasjet, duke detyruar mijëra kosovarë të largoheshin nga vendbanimet e tyre. Në mars të viti 1998, në Prekaz, pas luftimesh të ashpra, në familjen Jashari u vranë rreth 50 veta, midis të cilëve dhe Adem Jashari, drejtues i UÇK-së.

Popullit shqiptarë të Kosovës iu imponua lufta. Për vetëmbrojtje shqiptarët u bashkuan rreth UÇK-së. Kur faktori ndërkombëtar e ndjeu se konflikti kishte rrezik të përshkallëzohej jashtë kufirit të Kosovës, qoftë nga pala jugosllave (serbe) ashtu dhe nga shqiptarët, ai u angazhua për t'i ndërprerë luftimet dhe për të realizuar dialogun.

Në një varg takimesh e konferencash, ndërkombëtarët insistuan në tezën tradicionale në ruajtjen e integritetit të Jugosllavisë së mbetur, në statusin e minoritetit ose

²¹ Schëartz, Stephen. *Kosova- prejardhja e një lufte*. Prishtinë 2006, fq 145-146

të komunitetit etnik për shqiptarët e Kosovës, në restaurimin e një autonomie për Kosovën. Pra problemi i Kosovës u neglizhua tërësisht, “as status quo” as pavarësi, por vetëqeverisje të zgjeruar brenda RF të Jugosllavisë.²²

Sugjerimet dhe qëndrimet e faktorit ndërkombëtar për kompromis u keqpërdorën nga Slobodan Millosheviçi. Ai e përdori dialogun si një shfaqje politike dhe klimën e tij pozitive si fasadë, pas së cilës zhvilloi me intensitet luftën kundër shqiptarëve të Kosovës.

Ibrahim Rugova e kuptoi lojën e Millosheviçit dhe e ndërpreu dialogun e nisur me të në vitin 1998. Ndërkohë Millosheviçi përdori ushtrinë dhe armatimet e saj për të shpërngulur me forcë mijëra fshatarë e qytetarë të Kosovës, shumë prej të cilëve u fshehën në pyje, ku gdiheshin e ngryseshin në qiell të hapur.

Sipas qendrës së informimit të Kosovës, vetëm në vitin 1998, nga 945 fshatra, që ka Kosova, u bombarduan e u dëmtuan 398 dhe 23.044 shtëpi, u vranë 1.215 veta e u plagosën qindra të tjerë. Represioni ushtarak jugosllav (serb) arriti kulmin me masakrën e Reçakut, në janar të vitit 1999, ku u vranë dhe u futën në një gropë të përbashkët me qindra veta.

Shqiptarët me durimin e tyre mbajtën mbi vete aq shumë dhunë sa ajo u kthye në diskredituese për Beogradin.

Karvanët e popullsisë civile, si një rrezik i një katastrofe humanitare dhe i prishjes së ekuilibrit në Ballkan e zhvendosën përfundimisht zgjidhjen e problemit të Kosovës në duart e faktorit ndërkombëtar.

Për herë të parë në histori, çështja e Kosovës nuk u globalizua në kuadër të zgjidhjes së problemeve të tjera e, për rrjedhojë nuk e humbi rëndësinë e saj. Zhvillimi i ngjarjeve ndihmoi faktorin ndërkombëtar për të kuptuar natyrën e vërtetë të konfliktit në Kosovë, faktin që shqiptarët nuk janë terroristë, por viktimat e agresionit jugosllav dhe zhvillojnë një luftë vetëmbrojtëse çlirimtare.

Prej 6 deri më 23 shkurt të vitit 1999, në Rambuje (Francë) dhe me 15 deri më 19 mars në Paris, me nismën e faktorit ndërkombëtar u organizua një konferencë, që synonte të arrinte një marrëveshje paqësore midis serbëve dhe shqiptarëve për Kosovën.

²² Misha Glenny. *Histori e Ballkanit*. Botimet Toena Tiranë fq.654

Konferenca miratoi Marrëveshjen, që sanksiononte dhunën në Kosovë, zgjedhje të lira e demokratike nën mbikëqyrjen e OSBE, zgjidhjen e problemeve përmes dialogut, ruajtjen e sovranitetit dhe integritetit të Jugosllavisë së mbetur, vetëqeverisje substanciale të Kosovës, mbrojtjen e të drejtave të të gjitha bashkësive kombëtare në Kosovë, një periudhë tre vjeçare për zgjidhjen përfundimtare të çështjes së Kosovës dhe pjesëmarrje ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara në zbatim të marrëveshjes.

Nga ana tjetër, delegacioni i Kosovës duke marrë parasysh interpretimin juridik të ekspertëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë që e ndihmonin gjatë konferencës, pranoi marrëveshjen me kusht njohjen e qartë të së drejtës për referendum.²³

Po ashtu, delegacioni kosovar ishte i vetëdijshëm edhe për konsekuencat e mundshme në rast të mospranimi të marrëveshjes.

Përveç tjerash, këto konsekuenca u ishte bërë e qartë të dyja palëve përmes Sekretares së Shtetit, Madeleine Albright . Aty, midis të tjerash, zonja Albright tha : *Në qoftë se delegacioni i Kosovës nuk e pranon Marrëveshjen e Rambujesë, do të ballafaqohet me izolim ndërkombëtar, ndërkaq, në qoftë se delegacioni i Beogradit nuk e pranon Marrëveshjen do të bombardohet nga NATO-ja*”.

Më 22 shkurt 1999 i ofrohet mundësia që pjesa e Delegacionit të UÇK-së, të ketë takim me Komandantin e Forcave të NATO-s për Evropë, Gjeneralin Uelsi Klark. Natyrisht që kjo ofertë pranohet me kënaqësi dhe shpresë për mundësinë e bërjes më shumë për ardhmërinë e UÇK-së dhe për Kosovën.

Ai në këtë takim do t'i drejtohet disa herë Delegacionit të UÇK – së me fjalët: *„Nëse serbët nuk do ta nënshkruajnë Marrëveshjen unë do t'i godas forcat e Millosheviçit në Kosovë, për këtë të jeni të sigurt.*“²⁴

Delegacioni i Kosovës në Konferencën ndërkombëtare për Kosovën në Rambuje, në mbledhjen e vet të mbajtur më 7 shkurt 1999 vendosi:

- Kryesia e Delegacionit të Kosovës të përbëhet nga Hashim Thaçi, Dr. Ibrahim Rugova dhe Akademik Rexhep Qosja.

²³ Tahiri, Edita. Konferenca e Rambujesë. Pejë, 2001, fq, 71

²⁴ Krasiqi, Jakup. Kthesa e madhe faq 56

- Anëtarët e Kryesisë së Delegacionit të vendosin vetë se kush do të jetë Kryesues i delegacionit.
- Vendimet të merren me konsensus.
- Formimin e Sekretarisë së Delegacionit.
- Emërimin e ekspertëve shqiptarë.
- Emërimin e ekspertëve ndërkombëtarë
- Delegacioni u përcaktua me konsensus rreth synimeve strategjike të Kosovës në këtë Konferencë Ndërkombëtare.
- Synimet strategjike të Delegacionit:
- Vendosja e Kosovës nën mbikëqyrjen e NATO-s;
- Mbajtja Referendumit për Statusin final të Kosovës nën mbikëqyrjen ndërkombëtare në përfundim të fazës kalimtare.
- Ruajtja e subjektivitetit të UÇK-së gjatë dhe pas periudhës kalimtare.
- Ruajtja e integritetit territorial të Kosovës.
- Statusi kalimtar në kuptimin e një vetadministrimi demokratik dhe të pavarur, i tillë që nuk e paragjykon statusin final të Kosovës.
- Tërheqja e të gjitha forcave serbe nga Kosova...etj.²⁵

Delegacioni i Kosovës hartoi edhe platformën orientuese. Përmbajtja e saj ishte me sa vijon:

- Tërheqja nga Kosova e të gjitha forcave ushtarake, policore dhe paramilitare të Serbisë.
- Mospranimi i integritetit territorial të „Republikës Federative të Jugosllavisë”.
- Vendosja e trupave të NATO – s sipas modelit të mandatit të IFOR/SFOR gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes kalimtare.
- Transformimi i UÇK – së në një force mbrojtëse me aftësi të kufizuara në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare.
- Miratimi i Kushtetutës kalimtare trevjeçare, e cila mundëson themelimin e një qeverie demokratike dhe të efektshme në Kosovë, të përkrahur nga mandati i popullit në zgjedhjet sa më të hershme.

²⁵ Jakup Krasniqi, *Kthesa e madhe (Ushtria Çlirimtare e Kosovës)*. Prishtinë, 2006 fq 113

- Pas skadimit të Marrëveshjes Kalimtare (tri vjet nga data e nënshkrimit të saj), populli i Kosovës do të organizoj Referendum për të përcaktuar statusin përfundimtar të Kosovës, në bashkëpunim me Bashkësinë Ndërkombëtare.
- Krijimi i kushteve të nevojshme për të promovuar zhvillimin ekonomik të Kosovës, duke përfshirë këtu Bankën Qendrore të Kosovës dhe kompetencat e institucioneve të Kosovës, për të rregulluar mekanizmat për çështjet ekonomike financiare.
- Riafirmimi i paprekshmërisë së kufijve ekzistues të Kosovës.
- Zgjidhja e vazhdueshme e konfliktit përmes mjeteve ndërkombëtare duke përfshirë mbikëqyrjen e zgjedhjeve nga OSBE – ja, dhe pranimin e Kosovës si entitet i definuar territorial, politik dhe juridik. Një marrëveshje e të gjitha palëve për bashkëpunim të menjëhershëm dhe të plotë me Tribunal Ndërkombëtar për krime të luftës në ish- Jugosllavi.
- Garantimi i Marrëveshjes nga ShBA – të, Unioni Evropian, NATO – ja, vendet anëtare të Grupi të Kontaktit dhe OSBE – ja. Identifikimi i Marrëveshjes si traktat ndërkombëtar dhe regjistrimi i saj në OKB.²⁶

Marrëveshje e ndërmjetme (përkohshme, kalimtare) për paqen dhe vetëqeverisjen në Kosovë (Interim Agreement of Peace and self-Government in Kosovo) ishte dokumenti më i rëndësishëm që u prezantua dhe u diskutua në Rambuje, dhe ishte marrëveshja që do të nënshkruhej nga palët pjesëmarrëse. Kjo projekt marrëveshje përbëhej nga dy pjesë:

- Pjesa Politike dhe
- Pjesën e sigurisë ose instrumentet e detyrimit.

Pjesa politike e kësaj marrëveshje ishte përbërë nga 8 kapituj:

- a) Kushtetuta e Përkohshme e Kosovës.
- b) Sigurimi Politik dhe Civil.
- c) Zhvillimi dhe Mbikëqyrja e zgjedhjeve.

²⁶ Jakup Krasniqi, *Kthesa e madhe (Ushtria Çlirimtare e Kosovës)*. Prishtinë, 2006 fq 97

- d) Çështjet ekonomike-ndihma humanitare/rekonstruktimi dhe zhvillimi ekonomik.
- e) Implementimi - Ombduspersoni.
- f) Implementimi – Dispozitat përfundimtare.

Njëra nga çështjet mbi të cilat nuk mund të kapërcente Delegacioni i Kosovës dhe assesi nuk mund të pranonte atë që ishte përvijuar në tekstin e Marrëveshjes, qoftë edhe në pjesën e panegociushme, siç ishte rasti me aneksin ushtarak, ishte fati i së ardhmes së UÇK-së, dhe çmilitarizimi i saj.

Kjo do të duhej të ndodhte katër muaj pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Rambujesë.

Insistimi i Delegacionit Kosovar ishte që UÇK-ja të pranohej si forcë e përhershme e armatosur, qoftë edhe duke reduktuar dhe vënë nën kontroll dhe trajnim të përhershëm të NATO-s.²⁷

Delegacioni serb, paraqiti qëndrimin e tij në lidhje me pjesën politike të projektit, ndërsa për pjesën ushtarake të tij, ata as që kishin pranuar të bisedonin ndonjëherë, sepse për ta ishte e papranueshme.

Ndërsa shqiptarët, të indinjuar thellë për këtë mungesë respekti nga ana e serbëve për angazhimin tepër konstruktiv të tyre, e bënë të njohur qëndrimin e tyre, duke u ankuar me të drejtë se bashkëpunimi i tyre ishte i keqpërdorur, duke u shpërblyer palës serbe.

Dy ditë para mbylljes së Konferencës, ishte e qartë se bisedimet gjendeshin në një rrugë qorre. Ende nuk ishte arritur asnjë marrëveshje për pikat qendrore dhe as që bëhej fjalë për një zgjidhje të përgjithshme.

Për shqiptarët e Kosovës, Referendumi për Pavarësi dhe çmilitarizimi i UÇK-së ishin dy çështje që nuk vihehin në diskutim. Për Republikën Federative të Jugosllavisë-Serbinë, një forcë ushtarake nën drejtim të NATO-s, nuk mund të pranohej në asnjë rrethanë në territorin e saj.

²⁷ Krasiqi, Jakup. Kthesa e madhe. 98

Delegacioni kosovar edhe pse në fillim kishte divergjenca rreth asaj se a duhet të nënshkruhej marrëveshja menjëherë, apo duhej mbështetur ideja e përfaqësuesve të UÇK-së për një shtyrje dyjavore të nënshkrimit (derisa të konsultohesh populli), në fund arriti konsensus dhe me anë të dy shkresave njoftoi Kryeorganizatorët dhe zj. Medline Albright.

Këto dy shkresa, në esencë, përmbanin atë se: delegacioni i Kosovës në parim pranon Marrëveshjen, që nënshkrimi të bëhej pas dy javësh, mirëpritje të garancioneve amerikane për UÇK-në dhe garancinë për Referendumin.

Shtyrja për dy javë, ishte veprimi më racional që mund të bëhej për të shpëtuar dështimin e pa-alternativë të Konferencës së Rambujesë. Për në Paris, Delegacioni i Kosovës, u nis pas dy jave, në pasditen e 13 marsit 1999.

Dallimi tani ishte se, së bashku me Delegacionin udhëtonte edhe Kryesuesi i Delegacionit të Kosovës, z. Hashim Thaçi. Vazhdimi i Konferencës së Rambujesë nuk zgjati shumë: nga 14 gjer më 19 mars 1999.

Marrëveshja u nënshkrua nga pala shqiptare dhe ajo ndërkombëtare në ditën e 18 marsit 1999.

Pala serbe-jugosllave i mbeti besnike obstrukcionit, mospërfilljes dhe mosbashkëpunimit me ndërkombëtarët, dhe nuk e nënshkruajti marrëveshjen, duke marrë mbi supe të gjitha pasojat e mundshme që do të prodhonte ky veprim aspak i mençur politik e dështak në rrafshin diplomatik.

Ajo Marrëveshje e linte shtegun e hapur, për të kaluar nga një qeverisje substanciale në pavarësi të Kosovës. Kjo ishte pika më neuralgjike për serbët, që e kuptonin se Kosova po rrëshqiste nga duart e po afrohej drejt pavarësisë.

Por sigurisht serbët nuk mendonin ta lëshonin Kosovën aq paqësisht. Ata mendonin se konflikti në Kosovë mund të zgjidhej vetëm me luftë.

Përpyekjet e fundit për ta bindur kreun e së keqes, Millosheviqin, për të bërë kthesë në mendësinë e tij gjenocidale dhe për t'i thënë po Marrëveshjes, u bënë përmes Riçard

Holbrukut, i cili do të kthehej me duar bosh, dhe me bindjen se nuk ka rrugë tjetër përveç intervenimit me anë të forcës.

Milloseviqi nxiti ndjenjat e nacionalizmit të populli serb duke e konsideruar përballimin e sulmeve të NATO-së si qëndresë kombëtare.

Më 24 mars 1999 pasi nuk kishte mbetur asnjë alternativë tjetër për të detyruar Milloseviqin të ndërpriste brutalitetin dhe represionin kundër popullsisë civile që e vazhdonte me shkatërrime të mëdha të çdo gjëje që është shqiptare, forcat ajrore të NATO-së rreth orës 18: 15 filluan sulmet kundër Jugosllavisë me objektiva mbrojtjen ajrore, radarët, qendrat ushtarake të komandimit, aeroportet ushtarake



Bombardimet e NATO-s ndaj Serbisë

Me rastin e fillimit të sulmit, Presidenti amerikan Bill Clinton në një fjalim drejtuar popullit amerikan argumentoi shkaqet e ndërhyrjes së NATO-së:” *Arsyet që ne sulmuam Serbinë janë: humanitare, të perspektivës dhe strategjike*²⁸

Gjithashtu presidenti amerikan potencoi se Milloseviqi zgjodhi agresionin në vend të paqes dhe sulmi u ndërmor pas përpjekjeve të shumta dhe të përsëritura për të gjetur zgjidhjen paqësore për Kosovën. Kryeministri i Britanisë së Madhe, Toni Blair bëri të njohur po atë mbrëmje kombit të tij se pasi Milloseviqi nuk pranoi të ndalë dhunën e

²⁸ Shyqyri Hysi, Historia e trojeve dhe e diaspores shqiptare, f, 168.

tmerrshme e të pranonte përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar për zgjidhjen paqësore të përkohshme të çështjes së Kosovës bota e qytetëruar nuk mund të lejojë akte të tilla dhune dhe agresioni në zemër të Evropë²⁹

Që nga fillimi i sulmeve të NATO-së deri më 26 mars 1999, arritën 260 mijë të zhvendosur me forcë nga Kosova në Shqipëri, Malin e Zi, Maqedoni, Bosnje, Bullgari, Turqi etj.

Këtë katastrofë të madhe Serbia e bëri për ti frenuar sulmet e NATO-së. Millosheviçi u dha amnisti terroristëve që të bashkohen me bandat e Arkanit, Mladiqit e Sheshelit për të zbatuar eliminimin e listave të zeza, duke arrestuar dhe eliminuar personalitetet e njohura shqiptare.

Bombardimet ajrore zgjaten plotë 78 ditë nga 24 mars 1999 e deri më 9 qershor të vitit 1999 kur në Kumanovë u nënshkrua marrëveshja midis përfaqësuesve të NATO-së dhe gjeneralëve të Serbisë. Forcat serbe vranë dhe masakruan mbi 10.000 civil shqiptar dogjën mbi 100.000 shtëpi, shkatërruan dhe plaçkitën pasurin e shqiptarëve dhe morën si peng dhe rob të luftës një numër të madh të shqiptarëve dhe në mënyrë flagrante shkelën Konventat e Gjenevës të cilat përcaktojnë të drejtën e luftës.

Me marrëveshjen e Kumanovës u arrite që Brenda 11 ditëve të tërhiqen të gjitha forcat e armatosura jugosllave nga Kosova dhe të hynë trupat e NATO-së më 10 qershor 1999. Trupat e NATO-së (KFOR-it), në Kosovë u vunë nën komandën e gjeneralit të NATO-së, M. Xheksanit ndërsa si përfaqësues i OKB-së u emërua diplomati francez, B. Kushner.³⁰

Nënshkrimi i Marrëveshjes tekniko-ushtarake midis ushtrisë jugosllave dhe NATO-s, të cilën e përfaqësonte gjenerali Majk Xhekson shënoi fundin e bombardimeve ajrore të NATO-s dhe pranimin e kushteve që ajo i parashtroi Serbisë për njohje të kapitullimit dhe për tërheqjen e forcave të saja nga territori i Kosovës.

Marrëveshja e Kumanovës përcakton modalitete tekniko-ushtarake të tërheqjes së forcave serbe nga territori i Kosovës dhe hyrja e forcave ndërkombëtare të sigurisë. Pas hyrjes se

²⁹ Shyqyri Hysi, Historia e trojeve dhe e diaspores shqiptare, f, 168.

³⁰ Hysi Shyqyri, Historia e trojeve dhe e diaspores shqiptare, f, 169

Forcave të NATO-së në Kosovë, Këshilli i Sigurimit më 10 qershor 1999, miratoi Rezolutën 1244 me të cilën edhe formalisht vendosi Kosovën nën administrimin e Kombeve të Bashkuara dhe hapi rrugën për vendosjen e prezencës ndërkombëtare civile dhe ushtarake në territorin e Kosovës

Më 10 qershor 1999 pas miratimit të Rezolutës 1244 Këshilli i Aleancës së Atlantikut autorizoi hyrjen në Kosovë të trupave të KFOR-it, më 12 qershor 1999 në operacionin e quajtur “ Mbrojtësi i Përbashkët”, kjo rezolutë i lejonte secilit shtet anëtar e OKB-së të vendos trupa në Kosovë praktikisht nënkuptohej që KFOR-i , ishte e vetmja forcë ndërkombëtare e pranishme.

Vlen të përmendet se ende pa hyrë forcat e NATO-së disa forca ruse të dislokuar në Bosnjë që ishin pjesë përbërëse e misionit SFOR, me shpejtësi zbarkuan në aeroportin e Prishtinës duke rrezikuar kështu shpërthimin e një lufte botërore, falë marrëveshjes se nënshkruar në Helsink më 18 qershor u përcaktuan kriteret e pjesëmarrjes së rusëve në operacionet e KFOR-it, kontingjenti rus do të ketë 2.850 trupa dhe 750 trupa të tjera në aeroport si baza logjistike, këto njësi do të vepronin në kuadër të sektorit gjerman, amerikan dhe francez.³¹

Duhet përmendur se Konferenca e Rambujesë dhe marrëveshja e saj, edhe pse dështake, dhe si e tillë ajo pati mundësi të ndikojë seriozisht, duke i shtyrë diplomatët dhe hartuesit e dokumenteve të ndryshme ndërkombëtare, pasuese të saj, të reflektojnë me rezonin që karakterizonte këtë Marrëveshje të parealizuar duke i dhënë asaj përmasat, karakterin dhe rëndësinë, që në fakt nuk e kishte

Refleksione të tilla sollën Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, me të cilën administrohet Kosova e pasluftës, e vënë nën mbikëqyrje dhe kujdestari ndërkombëtare.

Inkuadrimi në NATO i vendeve të Ballkanit Perëndimor

Koncepti strategjik i NATO-s, i miratuar në Samitin e Lisbonës në nëntor të vitit 2010, vërteton përkushtimin e aleatëve se dera e NATO-s mbetet e hapur për secilin shtet evropian i cili është në pozicion të marrë detyrimet e anëtarësimit dhe të kontribuojë për

³¹ Shala Xhavit, Ballkani Gjeopolitika dhe Siguria, f, 280.

sigurinë e rajonit euroatlantik. Që nga vitit 1949, anëtarësimi në NATO është rritur nga 12 shtete në 29 shtete.

Integrimi i plotë i vendeve të Ballkanit Perëndimor të mbetura jashtë NATO-s është rruga për stabilizimin jo vetëm të Ballkanit por dhe vetë Evropës. Sot hartës së NATO-s në Ballkanin Perëndimor i mungojnë Bosnjë Hercegovina, Serbia, Kosova dhe Maqedonia.

Shqipëria dhe Kroacia morën ftesën për anëtarësim në NATO-s në Samitin e Bukureshtit në prill të vitit 2008 zyrtarisht u bënë anëtare kur procesi i qasjes përfundoi me 1 prill të vitit 2009. Duhet përmendur se edhe Republika e Maqedonisë kishte ftesë për anëtarësim por për shkak të kontestit me Greqinë në lidhje me emrin, vendi nuk u anëtarësua por udhëheqësit e Aleancës ranë dakord për të ftuar Maqedoninë për t'u bërë anëtare menjëherë sapo të arrihet një zgjidhje e pranueshme reciprokisht mbi emrin e vendit me Greqinë, ndërsa Mali i Zi zyrtarisht është bërë anëtar i 29-të i NATO-s me 5 qershor 2017.

Duhet përmendur që kriteret për pranim në NATO janë më pak të ashpra se ato për pranim në BE, megjithatë kandidatët e NATO-s duhet të jenë vende demokratike, dhe të kenë kontroll civil të ushtrive të tyre.

Megjithatë, forcat e armatosura duhet t'i përgjigjen standardeve të Aleancës. Për këto standarde janë duke punuar tani Bosnje-Hercegovina, dhe Maqedonia. Edhe pse ky i fundit i ka përmbushur kriteret, pranimi i vendit në NATO është bllokuar nga pala greke.

Sa i takon Serbisë, NATO zhvilloi luftë me ta , për të mbrojtur njerëzit që jetonin në Kosovë. Si pasojë e kësaj, marrëdhëniet midis NATO-s dhe Serbisë janë të ftohta. Ndryshe nga fqinjët e saj në Ballkan, Serbia nuk dëshiron të hyjë në Aleancën ushtarake, por edhe në rast se ajo vendos për inkuadrim në Aleancën Veriatlantike, procesi i pranimit do të shkojë gjatë sepse NATO i jep vlera të veçanta kushtit që të pranojë vetëm shtete që nuk janë të përziera në konflikte territoriale. Kështu duhet bërë një herë pastrimi i konfliktit midis Serbisë dhe Kosovës.

Në kohën e paqartësive dhe një situatë gjithnjë e më të pasigurt në rajonin e Ballkanit Perëndimor, Kosova ka mbetur nën hijen e këtyre zhvillimeve dhe proceseve

rajonale, veçanërisht nga dialogu me Serbinë dhe pengesat për anëtarësim në organizata rajonale e ndërkombëtare.

Megjithatë, një dritë në fund të tunelit u vërejt në fund të vitit 2016 sa u përket marrëdhënieve komplekse të Kosovës me NATO-n. Ani pse pa u vënë re, mund të thuhet se Kosova shënoi një progres sado të vogël, meqë nga viti 2017 Kosova do të mund të marrë pjesë në disa prej programeve të NATO-s.

Kjo erdhi pas kërkesës së Qeverisë së Kosovës, e cila në vitin 2015, ndër të tjera, i kishte kërkuar NATO-s vendosjen e marrëdhënieve zyrtare e politike me Kosovën për t'i hapur rrugë integritit të Kosovës në NATO.

Megjithatë, përgjigja e NATO-s drejtuar institucioneve kosovare në dhjetor të vitit 2016 dëshmon se Kosova gjendet larg nga vendosja e marrëdhënieve kontraktuale e politike me NATO-n.

Pavarësisht kësaj, pengesat politike në NATO janë shmangur sa për t'i mundësuar institucioneve të Kosovës të hyjnë në një bashkëpunim minimal. Me një gjuhë tepër të kujdesshme, NATO-ja i ka ofruar Kosovës bashkëpunim në formën e “ndërveprimit”, por duke mos e trajtuar Kosovën si shtet, vend partner i NATO-s dhe as duke mos i dhënë dritë të gjelbër nisjes së dialogut politik Kosovë-NATO.

Duke marrë parasysh vendimmarrjen e strukturave të NATO-s, duket që rruga e Kosovës drejt anëtarësimit në programin e Partneritetit për Paqe dhe në NATO do të marrë më shumë kohë se që është menduar. Kjo po ndodh për shkak se katër vende anëtare të NATO-s nuk e kanë njohur Kosovën dhe për më tepër bllokojnë vendosjen e marrëdhënieve zyrtare me Kosovën. Si njëri nga zërat më kritikë shquhet Spanja, e cila vazhdon të kundërshtojë fuqishëm avancimin e raporteve të Kosovës me NATO-n në nivel politik, duke bllokuar kështu integrimin në NATO .

Por, Qeveria e Kosovës duhet të shfrytëzojë dobitë që do të sjell ky bashkëpunim i ri, duke kërkuar përfshirje aktive dhe të plotë të institucioneve të vendit në programet e NATO-s me qëllim të avancimit të marrëdhënieve dhe thellimit të raporteve të ndërsjella. Kjo padyshim duhet të pasohet me një angazhim më konkret e serioz të qeverisë kosovare

që në bashkëpunim me vendet përkrahëse në NATO të bëhen përpjekje për zbutjen e qëndrimeve të katër vendeve anëtare të NATO-s ndaj Kosovës.

Duet përmendur se në Kosovë veprojnë forcat paqeruajtëse ndërkombëtare të udhëhequra nga Aleanca, me qëllim të ruajtjes së rendit dhe paqes. Mandati i saj rrjedh nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit që ka për qëllim:

- Krijimin e një mjedisi të sigurt për kthimin e refugjatëve pas luftës;
- Garantimi i sigurisë publike;
- Mbikëqyrja e çminimit të terreneve të minuara;
- Përkrahja e pranisë ndërkombëtare civile;
- Vëzhgimi i kufijve;
- Garantimi i lirisë së lëvizjes.³²

Me kalimin e kohës, me formimin e agjencive të ndryshme të sigurisë, shumë kompetenca kalonin në organet e qeverisjes së Kosovës, andaj mund të thuhet se KFOR-it i kanë mbetur edhe tri detyra dhe përgjegjësi kryesore si:

- Mbrojtja e jashtme, pra e kufijve të Kosovës;
- Mbrojtja e enklavave serbe dhe monumenteve fetare;
- Ndihma që i jepet shërbimit policor, në rast se ai nuk është në gjendje t'u përgjigjet sfidave të sigurisë së brendshme në mënyrë të duhur.

Sigurisht hyrja potenciale e Kosovës në NATO do të ketë një ndikim pozitiv jo vetëm mbi Kosovën por edhe më gjerë. Për më tepër kjo do t'i jepte Kosovës mundësinë unike për të shndërruar veten nga një konsumator i sigurisë në një ofrues të sigurisë. Duke qenë një vend pritës për misionin e KFOR-it, Kosova me siguri do të ketë shumë përvojë dhe do të dijë të ndajnë atë përmes misionëve të ndryshme paqeruajtëse ndërkombëtare.

Perspektiva e mëtutjeshme e NATO-s si fuqi politiko-ushtarake dhe paqeruajtëse

³² Nusret Pllana, *Intervenimi i NATO-s në Kosovë*, Radio Kosova e Lirë, Prishtinë, fq. 296

Marrëveshja për themelimin e Paktit veriatlantik u nënshkrua më 4 prill të vitit 1949 në Uashington. Prej vitit 1949 e deri më sot, bota kaloi nëpër ndryshime thelbësore, politike dhe sociale, si dhe zhvillim ekonomik dhe teknologjik.

Sot qarqet liberale, majtistët ekstrem dhe izolacionistët e rinj” nga Evropa kërkojnë heqjen e Aleancës. Sigurisht në fillim NATO u krijua si kundërpeshë e përhapjes globale të ideologjisë komuniste dhe si mjet për kufizim të fuqisë ushtarake të Bashkimit të atëhershëm sovjetik.

Por sot qëllimi themelor i Aleancës Veri-Atlantike është që të ofroj mbrojtjen e lirisë dhe sigurisë të të gjitha vendeve anëtare në Evropë dhe në Amerikën Veriore në përputhje me parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara. Për të realizuar këtë, Aleanca zhvillon dhe shfrytëzon si ndikim politik ashtu edhe kapacitetet e veta ushtarake, varësisht nga natyra e kanosjeve ndaj sigurisë, me të cilat përballen shtetet anëtare të Aleancës.

Ashtu siç ndryshoi ambienti strategjik përreth, ashtu ndryshoi edhe mënyra me të cilën Aleanca reagon në këto sfida ndaj sigurisë. Ajo vazhdon të ruaj stabilitetin anekënd rajonit euroatlantik dhe transformohet për tu bërë ballë me sukses kanosjeve të reja siç janë terrorizmi dhe sfidat e tjera ndaj sigurisë, që tejkalojnë larg sferën e saj të përgjegjësisë.³³

Përveç me vendet anëtare NATO gjithashtu ka zhvilluar edhe marrëdhënie të veçanta me dy vende partnere, Rusinë dhe Ukrainën. Këto marrëdhënie datojnë që nga viti 1997 me nënshkrimin e Aktit të Themelimit NATO-Rusi për Marrëdhënie Reciproke, Bashkëpunim dhe Siguri dhe Kartën NATO-Ukrainë për një Partneritet të Veçantë.

Që nga ajo kohë, marrëdhëniet me Rusinë janë intensifikuar me krijimin Këshillit NATO-Rusi, në vitin 2002, në të cilin aleatët dhe Rusia takohen si të barabartë. Në nëntor të vitit 2002 u ndërmorën disa hapa për të thelluar dhe zgjeruar marrëdhëniet NATO-Ukrainë, me zbatimin e Planit të Veprimit NATO-Ukrainë, i cili mbështet përpjekjet e Ukrainës për reforma, në rrugën për integrimin e plotë në strukturat e sigurisë së Euro-Atlantikut.

³³ <https://www.nato.int>

Me ndërhyrjen ushtarake të Rusisë në Ukrainë, NATO pezulloi të gjithë bashkëpunimin praktik me Rusinë në vitin 2014, si përgjigje për aneksimin e Krimesë nga Moska. Aleatët e NATO-s mbeten të palëkundur në qëndrimin e tyre se s'do të ketë rikthim të bashkëpunimit praktik nëse Rusia vazhdon të mos respektojë ligjin ndërkombëtar.³⁴

Politika të cilën e kanë miratuar vendet anëtare të NATO-s ka evoluar pa ndërprerë në frymën e ndryshimeve të ambientit strategjik përreth. Që nga përfundimi i luftës së ftohtë, politika e aleancës dhe struktura e saj kanë pësuar ndryshime rrënjësore, në përputhje me një mori të tërë ndryshimesh në ambientin politik dhe ushtarak të Evropës, si dhe shfaqjes së kanosjeve të reja për siguri. Përveç kësaj, është zgjeruar edhe koncepti i mbrojtjes, në mënyrë që të përfshijë edhe dialogun dhe bashkëpunimin praktik me vendet e tjera jashtë aleancës, si njërën nga format më të mira të forcimit të sigurisë euro-atlantike.³⁵

Aleanca ka miratuar programin strategjik pas luftës së ftohtë, duke aplikuar një përkufizim më të gjer të sigurisë dhe duke iniciuar mbi një bazë të gjerë strategjinë e partneritetit dhe të bashkëpunimit në mbarë rajonin euro-atlantik, e cila tani konsiderohet si njëra nga detyrat themelore të sigurisë së NATO-s. Ky proces filloi në vitin 1990 kur liderët e vendeve aleate ofruan dorën e miqësisë në zonën e ndarë lindje-perëndim, duke propozuar marrëdhënie të reja bashkëpunimi me vendet e Evropës Qendrore dhe asaj Lindore si dhe me ish republikat sovjetike.

Programi “Partneriteti për Paqe” është iniciativa më e rëndësishme e NATO-s e orientuar në forcimin e besimit dhe të bashkëpunimit në mes vendeve anëtare të aleancës dhe vendeve partnere, me qëllim të zhvillimit dhe forcimit të stabilitetit dhe sigurisë në rajonin euroatlantik.

Mbështetur në bashkëpunimin praktik dhe në përkushtimin ndaj parimeve demokratike, që janë themel i vetë Aleancës, qëllim i Partneritetit për Paqe është të rrisë stabilitetin, të zvogëlojë kërcënimet ndaj paqes dhe të ndërtojë marrëdhënie të forta në

³⁴ Art, Robert J. (1998). "Creating a Disaster: NATO's Open Door Policy". *Political Science Quarterly*. **113** (3): 383–403

³⁵ <https://www.ngo-horizonti.org/Nato>

sferën e sigurisë ndërmjet vendeve anëtare (në veçanti) dhe NATO-s., si dhe me vendet e tjera partnere.



Partnership for Peace (PfP)

Aleanca gjithashtu reagon edhe në situatë të jashtëzakonshme dhe fatkeqësi, përfshirë derdhjen e lëndëve kimike apo toksike, ortekët, vërshimet dhe tërmetet apo me qëllim të mënjanimi të pasojave të sulmeve terroriste.

Reagimet efektive ndaj katastrofave kërkojnë një koordinim në sferën e transportit, të resurseve mjekësore, të komunikimit dhe burimeve tjera njerëzore, si dhe aftësi për të reaguar në situatat e jashtëzakonshme. NATO ka luajtur dhe luan rol vendimtar në harmonizimin e planifikimit mes vendeve anëtare të saj, duke bërë të mundur që planet të funksionojnë mirë kur të jetë e nevojshme dhe duke bërë të mundur që resurset nga të cilët varet zbatimi i planeve, t'u vihen të gjithëve në dispozicion.³⁶

Sot, përvojat e NATO-s dhe ekspertizat në fushën e planifikimit në rast situatash të jashtëzakonshme janë në dispozicion për të gjithë, por njëkohësisht shfrytëzojnë njohuritë dhe mundësitë e vendeve të tjera që marrin pjesë në punën e Këshillit të partneritetit euro-atlantik.

³⁶ National Defense University (1997). Allied command structures in the new NATO

Sfidat ndaj sigurisë së Euro-Atlantikut janë duke ndryshuar. Kërcënimet e herëpashershme, lufta kundër terrorizmit, fatkeqësitë e ndryshme, bënë që NATO të shërbejë si katalizator i transformimeve jo vetëm në vendet anëtare por edhe më gjerë duke i shërbyer sigurisë ndërkombëtare në një shkallë historike të paparë ndonjëherë. NATO gjithmonë ka qenë në qendër të misionëve. Ajo u ka shërbyer jo vetëm aleatëve, partnerëve por edhe demokracisë dhe paqes.

Karta e Veri-Atlantikut e vë theksin tek parimet e demokracisë, lirisë individuale dhe sundimit të ligjit. Andaj, si përfundim, mund të themi se NATO është diçka më shumë sesa tërësia e kapaciteteve të përbashkëta ushtarake. NATO është një familje që ndan vlera të përbashkëta dhe dëshirë që të njëjtat t'i mbrojë.



Selia e NATO-s në Bruksel

E ardhmja e NATO-s

Kur anëtarët themelues të NATO-s nënshkruan Traktatin e Atlantikut të Veriut më 4 prill 1949, ata deklaruan se janë të vendosur për të bashkuar përpjekjet e tyre për mbrojtje kolektive dhe për ruajtjen e paqes dhe sigurisë.

Kërcënimi më i madh ndaj këtyre objektivave ishte një sulm ushtarak nga një shtet armiqësor, një perspektivë që çoi në dispozitën më të famshme të traktatit, Nenin V, i cili thotë, "Palët bien dakord që një sulm i armatosur kundër një anëtari të NATO-s do të konsiderohet një sulm kundër të gjithë anëtarëve. "

Sot, pas 70 viteve, kërcënimet me të cilat përballen anëtarët e aleancës kanë ndryshuar shumë. Një sulm në Amerikën e Veriut apo në Evropë ndaj një shteti anëtar të Aleancës, nga ushtria e rregullt e një shteti të jashtëm, nuk ka shumë gjasa. Në vend të kësaj, aleanca duhet të përballlet me një sërë sfidash më të përhapura, duke filluar nga terrorizmi dhe rreziku i përhapjes së armëve bërthamore , sulmet kibernetike dhe ndërprerja e furnizimeve me energji.

NATO sot është një organizatë ndërkombëtare që ka vlerë si për Shtetet e Bashkuara ashtu edhe për Evropën. Megjithatë NATO duhet të zgjerojë vizionin e saj të mbrojtjes kolektive, në mënyrë që të mbetet relevante dhe efektive. Ajo duhet të zgjerojë bashkëpunimin e saj me demokracitë joevropiane, si Australia dhe Japonia, si dhe duhet përmirësuar marrëdhëniet e NATO-s me Rusinë dhe të ketë një bashkëpunim më të gjerë me Bashkimin Evropian.

Së fundi, për çështjen e zgjerimit, NATO duhet mbajtur derën hapur si ndaj Gjeorgjisë ashtu dhe ndaj Ukrainës, shtete këto të cilat ballafaqohen me sfida të sigurisë. Sigurisht, NATO duhet të jetë e hapur edhe ndaj anëtarëve të tjerë të rinj që duan të jenë pjesë e Traktatit Veri Atlantik.

Rekomandime

Qëllimi kryesor i lëndës është të marrim njohuri për funksionimin dhe rolin e NATO-s në parandalimin e krizave, menaxhimin e konflikteve dhe bashkëpunimin e ngushtë me partnerë ndërkombëtarë si p.sh. me OKB-në dhe BE-në.

Roli dhe qëllimi primar i NATO-s është mbrojtja e lirisë dhe e sigurisë e të gjitha shteteve anëtare me mjete politike dhe ushtarake në përputhje me Marrëveshjen Atlantike-Veriore dhe me parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara.

NATO-ja synon të arrijë vendosje të rendit të drejtë dhe të qëndrueshëm të paqes në Evropë , bazuar në vlerat e të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit.

Edhe pse bota ndryshon, misioni i NATO-s dhe koncepti i saj do të mbetet po i njëjtë. Aleanca garanton të mbetet një komunitet i pashembullt i lirisë, paqes, sigurisë dhe vlerave të përbashkëta.

NATO-ja është organizatë ndërqeveritare ku shtetet anëtare e ruajnë në tërësi pavarësinë dhe sovranitetin e vet. Të gjitha shtetet anëtare të NATO-s gëzojnë siguri të barabartë, pa marrë parasysh dallimet sa i takon kapaciteteve dhe mundësive të tyre shtetërore, ushtarake, ekonomike, gjeografike, demografike, e kështu me radhë, duke kontribuar në stabilitetin e botës euroatlantike.

NATO do të vijojë që si qëllim afatgjatë të ketë mbrojtjen e lirisë, të sigurisë dhe të integritetit territorial të të gjithë anëtarëve të saj me mjete politike dhe ushtarake, duke dëshmuar në mënyrë konzistente se është në shërbim të paqes.

Konkluzion

NATO u themelua në vitin 1949 për të t'iu kundërvënë ekspansionit (zgjerimit) sovjetik në Evropën Perëndimore. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Bashkimi Sovjetik e konsolidoi ndikimin e vet në Evropën Lindore. Themelimi i NATO-s ishte përgjigje e drejtpërdrejtë të ngritjes së asaj që Uinston Çërçill e përshkroi si “Perde e Hekurt”.

Në atë kohë, politikanët në ShBA dhe në Evropën Perëndimore konsideronin se, nëse do të shpërthente lufta ndërmjet Perëndimit dhe Bashkimit Sovjetik, ishte e logjikshme se ajo do të zhvillohej në Evropë. Megjithatë, për shkak të posedimit të armëve bërthamore, të dyja palët i shmangën konfrontimit të drejtpërdrejtë ushtarak.

Misioni strategjik i NATO-s ishte parandalimi i shkatërrimit të Aleancës me anë të forcës ushtarake. Që kjo strategji të kishte sukses, qenësore ishin katër objektiva: NATO të ketë superioritet ajror ndaj sovjetikëve, t'i mbajë të hapura linjat e komunikimit detar drejt Amerikës së Veriut, ta ruajë integritetin territorial të Gjermanisë Perëndimore dhe të shmangët përdorimi i armëve bërthamore. Sikur NATO të humbiste vetëm njëren nga këto objektiva, lufta kundër Bashkimit Sovjetik do të konsiderohej si e humbur.

Që prej përfundimit të Luftës së Ftohtë, sot, roli i NATO-s është më i rëndësishëm se kurrë më parë, sidomos po të merren parasysh veprimet dhe retorika gjithnjë e më agresive e Rusisë. Një pohim i këtillë është i pakontestueshëm sidomos pas aneksimit në vitin 2014 të Krimesë nga Rusia si dhe kontrollimi i Ukrainës Lindore nga forcat proruse.

Pjesa më e madhe e anëtarëve të NATO-s ndajnë vlera të njëjta dhe kanë interesa të përbashkëta. Gjithashtu, interes i tyre është ruajtja e lirisë, demokracisë, paqes, stabilitetit, sigurisë si dhe përforcimi i bashkëpunimit transatlantik.

NATO nxit vlerat demokratike dhe është e angazhuar për zgjidhjen në mënyrë paqësore të mosmarrëveshjeve politike. Në qoftë se përpjekjet diplomatike dështojnë, ajo ka kapacitetin ushtarak të nevojshëm për të ndërmarrë administrimin e krizës dhe

operacionet për ruajtjen e paqes, vetëm ose në bashkëpunim me vendet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare.

Bibliografi

- Donald Shena, *Lidershipi global i Shteteve të Bashkuara (në shekujt XX dhe XXI)*
- Jack Donnelly dhe David P. Forsythe, *Human Rights në International Realition*
- Nato.int/docu/pub-form.htm
- Fatmir Toçi, *Historia e popullit shqiptar IV gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj 1939-1990*
- Lory, Bernard. *Evropa ballkanike nga viti 1945 deri në ditët tona*
- Misha Glenny. *Histori e BALLkanit 1804-1999*
- Nusret Pllana, *Intervenimi i NATO-s në Kosovë*
- Euro Atlantic Education Initiative, *NATO in Brief*
- *Morm.gov.mk*
- Jasmina Udovički dhe James Ridgeway, *Makthi etnik i Jugosllavisë*
- Shkariq S. "Parlamentarian elections in the Republic of Macedonia
- Schëartz, Stephen. *Kosova- prejardhja e një lufte*
- Krasiqi, Jakup. *Kthesa e madhe (Ushtria Çlirimtare e Kosovës)*
- Tahiri, Edita. *Konferenca e Rambujesë. Pejë, 2001*
- Shyqyri Hysi, *Historia e trojeve dhe e diaspores shqiptare*
- Shala Xhavit, *Ballkani Gjeopolitika dhe Siguria*
- Györkei, J.; Kirov, A.; Horvath, M. (1999). *Soviet Military Intervention in Hungary, 1956. New York: Central European University Press*
- Györkei, J.; Kirov, A.; Horvath, M. (1999). *Soviet Military Intervention in Hungary, 1956. New York: Central European University Press.*
- Rootes, Christopher. "1968 and the Environmental Movement in Europe."
- Art, Robert J. (1998). "Creating a Disaster: NATO's Open Door Policy". *Political Science Quarterly*. **113** (3): 383–403
- Behrman, Greg (2007). *The Most Noble Adventure: The Marshall Plan and the Time When America Helped Save Europe*. Simon & Schuster
- National Defense University (1997). *Allied command structures in the new NATO*